Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 10 (90). TETOR 2013. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



Market KEN

Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

AKTUALITET

Të mbrojmë Radikën!

Nga **BARDHYL MARKU** - FAQE 7

VËZHGIM

Mos e prishni qytetin!

Nga **SHAQIR SKARRA** - FAQE 6

PORTRET

Trashëgimia natyrore, burim i pashfrytëzuar

Nga **FATBARDH CENA** - FAQE 12-13

INTERVISTË

Qytetet tona duhet të jenë galeri arti

Nga **REXHEP TORTE** - FAQE 15

Ç'kemi asaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Shumë miq të mi, sidomos ata që jetojnë në Perëndim, herë pas here më shkruajnë një mesazh në Facebook: Përshëndetje! Ç'kemi ndonjë të re asaj Dibre?

Unë nuk kam mundësi t'u përgjigjem të gjithëve një për një, por këtë radhë po u shkruaj të gjithëve...

Asaj Dibre dhe kësaj Tiranë kemi të reja..

Në Universitetin e Peshkopisë ka nisur mësimi. Studentë plot, pedagogë hiç! Në FB kanë nisur debatet; ca ankohen për cilësinë, ca për nivelin e studentëve, ca të tjerë godinat dhe ndonjë për sekretaret. Asnjëri nuk shkruan se Dibra e ka universitetin e vet, dhe s'ka nevojë për degë të Universitetit të Durrësit? A nuk krenohemi ne se "Mendja ka fjet në Dibër"? Atëhere ç'na duhet universiteti?

Në Bulqizë 4 minatorëve janë pushuar nga puna. Pa të drejtë, ankohen ata dhe kërkojnë ndihmën e Sindikatës së Minatorëve. Kryesindikalisti shkon në Bulqizë dhe thyen derën e Pallatit të Kulturës për të marrë 4 zyra, sepse janë pronë e sindikatës...

A keni dëgjuar për një shef policie që bënte debat me politikanët në media! Me siguri keni dëgjuar, se ju atje i ndiqni lajmet mbi Shqipërinë më mirë se unë, sidomos këto punët e policisë dhe sigurimit. E transferuan në Dibër si zëvendësdrejtor i policisë, pastaj për një javë e bënë polic të thjeshtë! Dhe që kur është bërë polic i thjeshtë, krimi në Peshkopi është strukur maleve.

Në një fshat mes maleve, afër Korabit, një fëmijë do rriten pa nënë. Një tjetër pa baba. Një grua do mbetet e ve. Një burri që ishte nisur për kurbet i vranë gruan në shtëpi për një fjalë goje... Ose më mirë për "llafe grash"...

Ndërsa një vajzë 18 vjeçare, studente, u vra nga i fejuari. Mediat shkruan se e vrau pas shpine. Pastaj shkruan se kur e kapën vrasësin, ai ishte strukur si lepur? A vret lepuri?

(Vijon në faqen 6)

Organizohet në Peshkopi panairi i prodhimeve bujqësore e blegtorale "Festa e të Vjelave"

Blini **bio,** blini **në Dibër!**













Njëra nga mënyrat për ta ndihmuar dhe për të kontribuar për Dibrën është edhe që të kemi sa më shumë në tavolinat tona të ngrënies produkte të Dibrës. Kështu që, në qoftë se ju pëlqejnë mollët dhe dardhët, shumë të shijshme dhe shumë të pashme në shumëllojshmëri varietetesh; nëse ju pëlqen mjalti, sidomos ajo luga e parë e mëngjesit kur niseni për në punë; nëse që ju pëlqen djathi, i shumëllojshëm dhe shumë i mirë, edhe me forma të ndryshme që mund të zbukurojë tavolinat tuaja festive; nëse ju pëlqejnë kompostot e ftoit, qershisë apo kumbullës, nëse ..., atëherë shkoni në Dibër! Çdo mik i juaji në Dibër e ka për ta shitur një nga prodhimet bio të vjeshtës! Blijani, sepse kështu ushqeheni më mirë dhe ndihmoni sadopak ekonominë e vogël të fermerëve. Blini produkte bio! Blini në Dibër!

Reportazh në faqet 2-3



PETICIONI / OPINIONE

Rruga që bashkon vlerat kombëtare

Rruga e Arbrit mbërrin në Indi

Gazetari C. M. Paul i bën jehonë peticionit në mediat indiane: ***Rruga që afron vendlindjen e Nënë Terezës***

Speciale në faqe 4-5

cyan magenta yellow black 1


Organizohet në Peshkopi panairi i prodhimeve bujqësore e blegtorale
"Festa e të Vjelave"

Posta e
Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 10 (90). 1 - 30 Tetor 2013

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë: Haki Përnezha, Mustafa Tola, Destan Rama, Dali Tërshalla, Zabit Lleshi, se shkrimet e tyre janë në redaksi dhe do të shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



KËSHILLI BOTUES:

Musa Riçku
Mentor Hoxha
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:
Hajri SHEHU
Bardhyl MARKU
Selman MËZIU
Sulejman TOMÇINI
Alma MILE
Fatbardh CENA
Mustafa TOLA
Abdurahim ASHIKU
Rexhep TORTE
Ali.R.BERISHA
Mevlud BUCI
Qenan HASANI
Shaqir SKARRA
Hysen LIKDISHA
Rezehana HYSA
Mentor HOXHA
Destan RAMA

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Blini bio, blini në Dibër!

Nga **BUJAR KAROSHI**





Miqtë e mi, Besnik Alku dhe Dali Horeshka më kishin njoftuar për Panairin e të Vjelave. Por ajo që ma kujtonte çdo ditë sapo hyja në zyrë, ishte një njoftim i një forumi në Facebook për panairin. "Të gjithë dibranët që jetojnë e punojnë jashtë Peshkopisë apo edhe jashtë Dibrës, le të ftojnë fqinjët, miqtë, shokët, të afërmit e tyre të marrin pjesë në panair. Kjo duhet të jetë ngjarja më e madhe për Dibrën, deri në momentin që po flasim, pasi asgjë nuk mund të ketë interes të shumëfishtë më shumë sesa panairi", shkruante ftesa në FB e grupit "Qyteti i Peshkopisë".

Më 5 tetor në orën 10.30 isha në Peshkopi. Bulevardi ishte mbushur plot me njerëz dhe makina. Tregtarët ambulantë të përhershëm ishin aty në qendër, ndërsa sot bashkë me ta është edhe Eagle Mobile. Të parët shesin produkte të ndryshme për "bukën e gojës", ndërsa të dytët po bëjnë promocion për telefoninë 3.5 G. Pas stendës ku shiten numra telefoni, dhjetëra të rinj, të gjithë djem, presin të hyjnë në festën e "Eagle party"!

Para Pallatit të Kulturës janë vendosur stendat e panairit të "Festës së të Vjelave". Bie menjëherë në sy, sepse dendësia e njerëzve është më e madhe. Shumë hyjnë mes për mes stendave me duar në xhepa dhe dalin po me duar në xhepa. Ata e kanë këtë lëvizje si ritual të përditshëm, por sot ka ndryshuar bulevardi. Diku stenda, dikur tavolina në formë stendash dhe janë vendosur produkte bujqësore me radhë: dardha, ftonj, rrush, patate, arra, kunguj, presh, jufka, lakra, qepë, gështenja, lajthi, mjaltë, djathë, gjizë, çaj mali, djathë kaçkavall, gjalpë, turshi, komposto, fasule, misër, qeleshe, sheqerpare etj., por shumicën e stendave e zënë mollët dhe arrat.

Telefonin e parë ia bëj Dali Horeshkës, ekspert i Ekonomisë Bujqësore. Kur vjen puna për ndonjë informacion për bujqësinë dhe agrokulturën, ai më vjen shpesh në ndihmë. Ndërsa vjen, unë nxitoj të blej ca arra. "Janë arra të mira, janë arra Trebishti, - thotë shitësi, ndërsa unë nxitoj të blej ato që kam bërë në plan". Një mik më tërheq nga pas dhe më këshillon të mos blej asgjë në panair. "E kanë çmimin shumë nalt, ma shtranjt se n'pazar". Unë këmbëngul se do t'i blej ca



arra, se e kam vendosur. "Janë me 500 lek k'tu, nesër të gjej unë arra të majra me 250 lek kilen". Në fakt, unë i bleva 4 kg. Shitësi i tyre, ndërsa i peshonte, po më mbushte mendjen se si këto arra s'do kisha mundësi të blija më në Peshkopi, se janë të fundit dhe janë shumë të mira. Në fakt, miku im gjeti të nesërmen arra më të mira dhe me çmim më të lirë.

ORGANIZIMI DHE QËLLIMI

Panairi i prodhimeve dibrane "Festa e te vjelave" ose siç quhet ndryshe "Panairi i produkteve tipike dibrane" organizohet këtë vit nga ALCDF - Fondacioni Shqiptar i Zhvillimit të Kapaciteteve Lokale. Besnik Alku, përfaqësues i ALCDF, thotë se panairi është mbështetur financiarisht nga projektet e Komunitetit Europian, në kuadër të fondeve IPA të bashkëpunimit ndërkufitar me Maqedoninë, që ka në fokus promovimin e vlerave turistike të rajonit të Dibrës, projekti i zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në zonën e vargmalit të Deshatit, zbatuar nga ANTTARC si dhe projekti "Jeto shëndetshëm në zonën rurale", zbatuar nga KASH.

"Festa e të Vjelave" organizohet rregullisht që nga viti 2007, - thotë Besniku. Panairi nisi si një iniciativë e SNV-së, në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë në Dibër, për të promovuar dhe nxitur prodhuesit në fushën e bujqësisë dhe agro-përpunimit. Me kalimin e viteve vazhdoi drejt një përmirësimi të cilësisë së produkteve dhe me një numër më të madh të pjesëmarrësve jo vetëm nga sektori bujqësor, por dhe nga prodhues të artizanatit dhe punimeve tradicionale dibrane. Kulmin e tij e arriti vitin e kaluar, ku ALCDF mbështeti panairin që të bëhej në të njëjtën kohë me Odën Dibrane, duke i dhënë atmosferën e vërtetë një feste, si dhe me tenda dhe pajisje më cilësore. Panairi i këtij viti solli dhe pjesëmarrës nga Dibra e Madhe dhe Gostivari, duke shënuar edhe një risi për këtë viti", - thotë Alku.

Ndërsa Dali Horeshka, i cili gjen kohë të na shoqërojë gjatë vizitës në stendat e panairit, thotë se "këtë vit regjistrohet një numër më i madh pjesëmarrësish si fermerë, vizitorë, por edhe numër kontratash apo marrëdhëniesh të krijuara. E veçanta e këtij viti ishte se mjaft fermerë kanë ardhur me iniciativën e tyre si dhe gatishmëria për të marrë pjesë edhe me pagesë. Në këtë këndvështrim, unë nuk shoh thjesht si vazhdimësi e organizimit të përvitshëm, por edhe si sinjal për të ndryshuar pronësinë e organizimit te organizatat e fermerëve apo kompani private". "Nga ana tjetër, - thotë Horeshka, - në ditët që vijnë, panairi ia vlen të analizohet në prani të përfaqësuesve të Ministrisë së Bujqësisë për të siguruar mbështetje për këtë lloj aktiviteti me kaq rëndësi".

"Panairi ka si qëllim të promovojë dhe reklamojë produktet e prodhuesve dibranë. Emrin "Festa e të vjelave" e ka marrë në përputhje me kohën e vjeshtës, e cila është sezoni i të vjelave dhe te ne në Dibër ka atmosferën e festës së gëzimit dhe me bereqet, prandaj po të pyesësh kudo në fshatra, thuhet: "Jemi në kohë të vjelash". Nga kjo e morëm nxitjen në fillim dhe ia lamë emrin "Festa e të Vjelave", - shpjegon Besnik Alku.

Për sa i përket qëllimit të organizatorëve, Besniku sqaron se "organizatori kryesor, ALCDF, ka si qëllim që të organizohet panairi për promovimin e prodhuesve dibranë. Ne kërkojmë që në këtë event të bashkojmë dhe të fusim dhe aktorë të tjerë, të cilët kanë të njëjtat qëllime. Kështu, na janë bashkangjitur shumë herë, Drejtoria e Bujqësisë, e cila e ka dhe si një nga shërbimet e saj për prodhuesit bujqësore; "Agritravizion" - një organizatë që mbështet grupet e grave prodhuese për jufkat, punët e dorës, turshitë etj., dhe CNVP që mbështet prodhuesit e arrorëve: arrat, gështenjat, lajthitë. Në këtë mënyrë bëhet një grup i gjerë të interesuarish dhe që bashkëpunojnë për këtë veprimtari. Ne si ALCDF marrim rolin e koordinatorit të grupit", - thotë Alku. "Një bashkëpunim shumë të mirë kemi me Bashkinë e Peshkopisë dhe me Qarkun. Bashkia është mikpritësi dhe kujdeset për lejen, vendin dhe dekorin. Ne përpiqemi të gjejmë dhe ndonjë donator për panairin, siç bëmë këtë vit që gjetëm projektin e EU, organizatat që



kanë projekt të tillë me fermerët dhe me Zhvillimin e Turizmit, që projekti të bëhet më i plotë dhe nga ky aspekt, ANNTRC kishte një projekt për turizmin në vargmalin e Deshatit dhe kërkonte të promovonte produktet tipike dibrane, ndërsa KASH kishte një projekt që nxit jetesën e mirë në zonat rurale. Ne bashkëpunuam me ta bëmë të mundur organizimin për këtë vit", - thotë Besnik Alku.

PJESËMARRËSIT

Vehip Salkurti është një ndër prodhuesit më të mëdhenj të mollëve. Stenda e tij është në hyrje të panairit dhe produktet që tregton, mollët dhe dardhët, janë shumë cilësore. Disa shporta me mollë janë paketuar bukur dhe tërheqin vëmendjen e vizitorëve. Një kilogram mollë ose dardhë në këtë stendë kushton 100 lekë. Mollët e tij kanë fituar çmim në një panair të ngjashëm në Francë. Vehipi ka prodhuar këtë vit mbi 860 kuintalë mollë. Gjithashtu, ai disponon një frigorifer për ruajtjen e tyre në kapacitet rreth 500 ton. Vehipi ka aplikuar për një linjë moderne për përpunimin e lëngut të mollës, por akoma nuk e ka marrë përgjigjen. Aktualisht prodhon lëng molle në një sasi të kufizuar, me porosi, ndërsa për të gjithë mollët e tij e ka gjetur tregun. Njëherë tjetër ndoshta do të shkruajmë më gjatë për të, pasi është jo vetëm një rast i suksesshëm, por edhe një model për t'u ndjekur.

Përballë tij është një stendë shumë interesante, ndoshta më e bukura e panairit. Është stenda e Fabrikës së Përpunimit të Frutave dhe Perimeve "Selxhaferi". Kavanozat dhe shishet me komposto dhe lëngje frutash janë vendosur bukur. Ato tërheqin vëmendjen e vizitorëve, por blerjet janë shumë pak. Në fund të fundit, gjërat e bukura a nuk janë për t'u parë?!

Izet Selxhaferi, pronarin e fabrikës, e vizitojnë shumë njerëz, por vetëm me një tregtar nga Shkodra ka këmbyer telefonat. Ai shkon gjithmonë në panaire brenda vendit. "Është një rast i mirë, - thotë ai, - jo vetëm për t'i ekspozuar produktet, por edhe për të shitur". Ai është pesimist për produktet e tij, pasi megjithëse janë të kërkuara në treg, nuk është në gjendje ta mbajë tregun të furnizuar gjatë gjithë vitit. Fabrika e tij e përpunimit të frutave ka një kapacitet vjetor prej 500 tonësh. "Më gjej kavanozët për komposto dhe brenda ditës mbledh 100 kuintal ftonj, - thotë ai. Produktet e fabrikës sonë janë mjaft të kërkuara". Selxhaferit ka çuar produkte edhe për ekspozim në Turqi, Belgjikë, Itali, Zvicër, por nuk ka mundur dot të jetë pjesëmarrës në panairet bujqësore dhe të agropërpunimit në këto vende. "Organizatorët e atyre panaireve e kanë pëlqyer cilësinë e produkteve tona, por ne nuk përmbushim dot standardet e paketimit. I duan me paketim më të vogël dhe me etiketa" - thota Izeti. Shishes së lëngut të thanës që sapo ka prodhuar, i ka ngjitur një etiketë të thjeshtë: "Lëng Thane Selxhaferi". Etiketa nuk shënon përmbajtjen e produktit, kohën e prodhimit dhe datën e skadencës. "Nuk kisha kohë, i bëmë shpejt e shpejt ca etiketa sa për prezantim". Ai ka qenë në Bullgari për të marrë produkte të ambalazhimit, por për një porosi duhen të paktën 50 000 mijë euro, të cilat ai nuk i ka. Në vitin 2009 ai ka marrë një kredi shtetërore prej 12 milionë lekësh dhe ka blerë tre makineri. Tani ka filluar të paguajë vetë interesat dhe po ndjen vështirësi.

reportazh







Shumë produkte i ka të shpërndara në treg dhe për të marrë pagesën për to, i duhet shumë kohë, ndërsa nuk ka buxhet të blejë lëndën e parë. Në fabrikën e tij shumica e të punësuarve janë sezonalë, që ka pasur raste që arrijnë edhe ne 60 të punësuar.

Një nga fermerët për të cilët Daliu flet me shumë pasion është Haxhi Mani. Ai është një kultivues fidanëve të sherebeles. Daliu ka përgatitur për të një poster prezantues të thjeshtë, ku shpjegohen disa të dhëna për sherebelen, që nga mbjellja deri të fitimi për fermerët. Haxhiu orëve të panairit ka lidhur kontrata gojore për shitjen e rreth 20 mijë fidanëve të sherebeles, por suksesin më të madh ai thotë se e ka arritur me shitjen e mjaltit.

Në panair ka bërë një xhiro prej 100 mijë lekësh, por ka shkëmbyer telefonat me qytetarë të zakonshëm dhe së shpejti shpreson të shesë rreth 100 kg mjaltë.

Haxhiu është nga Muhurri dhe thotë se mjalti i tij është nga bjeshka e Runjës dhe nuk ka lëndë të huaj. Ai ka marrë një subvencion shtetëror për bletët në shumën e 500 dollarëve para 5 vitesh, ndërsa sot numëron rreth 108 koshere. Haxhiu nuk ka të punësuar. Shërbimet për rritjen e fidanëve të sherebeles edhe bletëve e kryen me familjarë. Kur ka nevojë merr punëtorë ditorë që i paguan me 1000 lekë.

Për sa i përket sherebeles, një bimë mjekësore që po gjen shtrirje të gjerë në rrethin e Dibrës, Haxhiu thotë se ka një kapacitet prej 300 mijë fidanësh, por shitjet janë të pakta. Një subvencion shtetëror për mbjelljen e sherebeles në rrethin e Dibrës përcakton si kufi minimal 5 dynymë tokë, por Haxhiu thotë se ky kriter duhet të ulet. “Do të ishte me interes shumëpalësh, - thotë Haxhiu, - sikur subvencioni shtetëror të jetë edhe për sipërfaqe më të vogla, p.sh., deri në 3 dynymë. Kështu do të rritej hapësira e subvencionit dhe shumë familje do të tregonin interes për sherebelen. “Sherebela është me interes ekonomik. Ajo ka jetëgjatësi 6-10 vjeçare dhe nuk kërkon shumë shërbime. Fidanët për mbjelljen e 1 dynym sherebele kushtojnë 25 000 lekë, pa përfshirë punimin e tokës dhe shërbimet ndihmëse. Haxhiu ka mbledhë sherebele natyrale nga Çidhna dhe Reçi dhe po eksperimenton fidanë autoktonë në fidanishten e tij. Ai ka aplikuar pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe pret që së shpejti fidanët e tij të certifikohen sipas standardeve.

Sipas Daliut, mbjellja e sherebeles është me shumë interes për fermerët. Shpenzime mesatare vjetore janë nga 8 mijë deri në 10 mijë lekë, ndërsa të ardhurat bruto janë nga 80 000 mijë deri në 120 mijë. Në Dibër deri më tani janë mbjellë 30 ha me sherebele, ndërkohë që po futen në strukturën e kultivimit edhe 6-7 bimë të tjera mjekësore, me synimin që brenda 10 viteve të ardhshme të arrijmë të kultivojmë rreth 20 bimë mjekësore.

Mes stendave të zënë sytë disa gra të shoqatës “Agritravizion”, një organizatë joqeveritare që mbështet grupet e grave prodhuese për jufkat, punët e dorës, turshitë, etj. Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë më kishte thënë para ca ditësh se jufkat e Vakufit ishin pëlqyer shumë në një panair të Kroaci të zhvilluar muajin e kaluar.

Pas orës një të drekës disa stenda fillojnë të rrallohen. Mes tyre të bie në sy një djalë i ri. Është i veshur me bluzë të bardhë dhe mban një kapele të bardhë në kokë, të shkruar greqisht. Daliu më thotë se quhet Luan Shehi. Ka qenë në emigracion në Greqi dhe ka ardhur dhe ka hapur një baxho për përpunimin e djathit. “A je i këngur nga panairi?”, - i them Luanit. “Çka. Unë kam shitur sot gjysmën e produkteve që kam marrë, por vetëm shitje kam realizuar, nuk kam bërë ndonjë marrëveshje për shitje gjatë vitit”. Luani shpjegon se shkrimi greqisht në kapele është një firmë e njohur greke e përpunimit të bulmetit dhe që kur ka vendosur të kthehet kishte synim hapjen e një biznesi të vogël për përpunimin. Është pëlqyer shumë sot djathi kaçkavall dhe zbukurimet që ka bërë ai me llojet e djathit janë shumë interesante për zbukurimin e tavolinave të ngrënies.

Me ne në këtë xhiro bashkohet edhe Asllan Xhani,veteriner i Autoriteti Kombëtar të Ushqimit. Ai njëkohësisht është edhe kryetar i Shoqatës së Bletarisë, e cila kohët e fundit po rritet ndjeshëm në qarkun e Dibrës. Ai ka dëshirë të hapë një rubrikë në gazetë për bletarinë, por e ka pak me përtesë. Pyetjes se sa është kosto e një kg mjaltë, e ka të vështirë t’i përgjigjet, por thotë se mjalti është shumë fitimprurës. Një kg mjaltë i mirë kushton 1500 lekë. Në fakt, mjalti nuk është vetëm fitimprurës, është dhe i ëmbël. Madje, ndonjëherë më i ëmbël se sheqeri... Po aq i ëmbël është mjalti, edhe kur etiketat shkruhen në gjuhën maqedonase.

Disa patate në panair më bënë shumë përshtypje. Ishin shumë të mëdh. Nuk kisha parë kurrë patate kaq të mëdha, përveç në foto nga interneti. “Sa janë produktet bujqësore në Dibër bio? A është i kontrolluar prodhimi bujqësor në Dibër? - ishte pyetja për Burhan Shehin, drejtor i Autoriteti Kombëtar të Ushqimit në Dibër. “Është e vështirë të kontrollosh një treg kaq të hapur, - thotë ai, - por për ndërmarrje dhe subjekte të përqendruara, ne ushtrojmë vazhdimisht kontrolle dhe i certifikojmë produktet e tyre. Në lidhje me frutikulturën, ne udhëzojmë specialistët tanë për mënyrën dhe kohën kur duhet të spërkaten nga sëmundje të ndryshme. Në shumicën e rasteve, produktet blegtorale dhe agrokulturës janë bio, me një përdorim të agjentëve të jashtëm sipas standardeve europiane, - shprehet ai.

Në një Atlas të Botës, botuar në Shtetet e bashkuara të Amerikës në vitin 1997 flitet edhe për Shqipërinë. Në një faqe të hartës së Shqipërisë, Maqedonisë dhe Greqisë, është ilustruar edhe një vizatim i disa grave që merren me përzgjedhjen dhe paketimin e mollëve. Në 36 fjalët që përshkruhet Shqipëria, theksohet se “Mollët janë të renditura dhe të paketuara në arka në këtë fabrikë në Peshkopi, në lindje të Shqipërisë”. Sipas statistikave zyrtare, në vitet ‘80, Dibra kishte rreth 1 milionë e pesëqind mijë pemë frutore dhe më shumë se gjysma e tyre ishte në prodhim. Statistikat e kohës thonë se ishin në prodhim mbi 140 mijë rrënjë arra, mbi 400 mijë rrënjë mollë, mbi 400 mijë rrënjë kumbulla, mbi 100 mijë rrënjë qershi, etj. Pas viteve ‘90 shumë ferma u shkatërruan. Sot ka shumë pak rrënjë nga ato ferma, ndërsa shumë të tjera po ringrihen si rezultat i kthimit të interesit.

Ndërsa ora shkon dy, panairi po mbyllet. Stendat po çmontohen dhe tavolinat e marra nga ndonjë shkollë afër, por merren masat për t’u rikthyer. Mbi bulevard duken shenja mbeturinash, kunguj e qepë të kalbura, mbeturina mollësh e dardhash. Tek-tuk është në trotuar edhe ndonjëri që nuk i ka shitur akoma produktet dhe pret klientin e fundit... E shtuna e 5 tetorit po mbyllet për të pritur të nesërmen e pazarit...



PAS PANAIRIT

Teknologjia na ndihmon për shkrimin tona. Disa pyetje me email dhe përgjigjet të vijnë në vend, dhe unë shfrytëzoj rastin për të pyetur faqen në FB <Qyteti i Peshkopisë>, Besnikun dhe Daliun, për panairin.

Pyetjes se pse morën përsipër të ftojnë publikun të marrë pjesë ne festën e të vjelave, administratori anonim i <Qyteti i Peshkopisë> shkruan: “Faqja “Qyteti i Peshkopise” është një grup intelektualesh dibranë dhe aktivistë të shoqërisë civile që duam të bëjmë një punë paralele me atë që na siguron të ardhurat materiale. Ideja është që shumica nuk jetojmë në Peshkopi, por jemi në kontakt të vazhdueshëm me vëllezërit dhe motrat tona atje. Asnjëherë dhe për asnjë arsye nuk pretendojmë të jemi ndonjë lëvizje politike fetare, apo të bëjmë ndonjë mision të paracaktuar. Misioni apo të themi qëllimi ynë madhor është që të bëjmë detyrën si dibran. Nuk na janë mbyllur rrugët e jetës këtej nga jetojmë e punojmë, por pavarësisht kësaj, duam që një ditë të kthehemi në Peshkopi, si qytetarë të denjë të saj. Nëse nuk dimë, nëse nuk veprojmë, nëse nuk orientojmë ne qytetarët, të paktën bëjmë me racion, dhe duhet theksuar me pasion dhe vullnet, disa publikime. Është një mision i gjatë që ne e kemi prioritet për vitin e ardhshëm, sepse nëse ne nuk e bënim atë hap këtë vit, pra atë sensibilizim deri diku të pasjellshëm dhe të padrejtë për disa palë, duhet që t’i paraprijmë diçkaje sipas vetë emërtimit të kësaj ngjarjeje”.

Ndërsa administratorët e faqes së Peshkopisë shkruajnë me shumë pathos dhe entuziazëm, Besniku dhe Daliu janë me këmbë në tokë. Në përgjigjet e tyre ata herë bashkohen dhe herë ndahen, por kjo ka edhe arsyet e tyre objektive.

Besniku thotë se në këtë panair morën pjesë më shumë 260 fermerë. Gjithashtu, e veçanta e këtij viti ishte se në morën pjesë edhe 15 fermerë nga Dibra e Madhe dhe 2 nga Gostivari.

Pyetjes së sa vizitorë ishin në panairin e këtij viti, Besniku thotë se “ne mendojmë se kanë qenë rreth 7500 vizitorë”, ndërsa për Daliun kanë qenë mbi 5000. “Nga 1500 pushues që kanë qenë në llixha, 1000 prej tyre e kanë vizituar panairin, argumenton Besniku. Ndërkohë, Peshkopia ka rreth 6000 familje, së paku 1 person për shtëpi, mbi 80 vetë kanë qenë nga Dibra e madhe, plus të ardhur nga Tirana dhe fshatrat përreth Peshkopisë. Prandaj themi se 7500 vizitorë kanë qenë në panair”

A MENDONI SE PANAIRI I TË VJELAVE IA ARRITI QËLLIMIT?

“Panairi besoj se ia ka arritur plotësisht qëllimit, - shkruan Besnik Alku. Për ne si ALCDF, ka rëndësi që të vazhdojë tradita dhe panairi të bëhet. Edhe aktorët e tjerë ishin të kënaqur, sepse arritën pritshmëritë të tyre. Arritjet e Panairit i tregojnë disa të dhëna, si p.sh. “ndërsa më parë ne paguanim nga 1000 lekë çdo pjesëmarrës, këtë vit erdhën vetë pa i paguar, madje erdhën më shumë se sa kishim ftuar. Një tregues tjetër janë shitjet e mëdha që u bënë në panair. Pothuajse arrat dhe lajthitë u shitën të gjitha. Ndërsa një shitës bulmeti bëri një xhiro prej 400 mijë lekësh. Gjithashtu, këtë herë ishin pjesëmarrës në panair shumë tregtarë shumice nga Lezha, Tirana, Fushë-Kruja që shikonin prodhimet dhe bënin kontrata me ata që kishin mollë dhe patate, për t’ia shitur gjithë prodhimin, pra, kishte dhe kontraktime dhe me ato tregtarë që kanë frigoriferë etj. Një arritje tjetër e panairit ishte prezantimi i punimeve me dorë, që janë një nxitje tjetër për artizanët dhe në të ardhmen mund të jetë një zë i rëndësishëm për turizmin. Por arritja më e madhe, - citon Besniku, - është se panairi solli shumë produkte, duke treguar se dibranët janë punëtorë dhe se kanë prodhimet mjaft cilësore. Për mollët jemi kampionë, por po konkurrojmë edhe me djathin mocarele. Agro-përpunimi është shtuar shumë, sidomos bulmeti, kompostot, reçelrat etj.

“U ekspozua prodhimi me mbështetje të Drejtorisë së Bujqësisë, duke krijuar mjaft marrëdhënie të reja me tregun dhe konsumatorët si dhe u rrit niveli i kuptimit të tregut nga fermerët pjesëmarrës, thotë Dali Horeshka. Fermerët që unë njoh dolën të kënaqur. Një pjesë të mirë të tyre unë e kam takuar dhe ata i ndaj me dysh: me eksperiencë dhe pa shumë eksperiencë. Pjesa e parë ka qenë mjaft e kënaqur, duke shitur 50% të prodhimit dhe duke krijuar kontrata që garantojnë shitjen e mbi 50% të prodhimit. Sakip Ngota, prodhuesi më i madh i djathit, kur u pyet si ja kalove, tha se isha në Amerikë pasi shita 5 kv djathë. Ky vlerësim vjen nga ata që e shikojnë bujqësinë si burim kryesor të ardhurash”, - thotë Daliu.



Çfarë do të donit të ishte më ndryshe në këtë panair, i shkruaj Besnikut dhe Daliut. “Nga pikëpamja e organizimit ne kemi vështirësi të mëdha, që do të doja që në të ardhmen t’i zgjidhnim me kohë. Problem më i madh janë baza materiale me stendat. KASH që ka stendat na i jep me çmim shumë të shtrenjtë dhe në momentin e fundit, nga 200 stenda që kishim porositur, na dërguan vetëm 100. Pastaj fillojnë andrallat me drejtoritë e shkollave, ku të gjesh ndonjë tavolinë. Duhet të telefonosh deri në ministri për të kërkuar leje për të marrë disa tavolina në shkollë. Gjithashtu, duhet një bashkërendim më i mirë i punëve mes institucioneve të pushtetit qendror dhe drejtuesve të bujqësisë në rreth. Pra, nëse do kishim një bazë materiale tonën për panairin (çadrat, stendat, tavolinat), do ishte më bukur dhe më mirë”.

Ndërsa Daliu rendit disa problematika që në të ardhmen do ta zgjeronin gamën e panairit dhe do ta rrisnin cilësisht atë. Së pari, thekson ai, duhet të organizohen konkurse për cilësinë e produkteve. Gjithashtu, duhet organizuar i një tavoline e rrumbullaket ku të diskutohet midis aktoreve për problemet dhe zgjidhjet e bujqësisë dhe biznesit bujqësor. Panairi duhet të organizohet për produkte të veçanta si dhe duhet një pjesëmarrje më e madhe e politikanëve, strukturave vendimmarrëse në nivel kombëtar dhe lokal. Do ishte shumë gjë e mirë që Festa e te Vjelave të kombinohet me koncerte apo Odën Dibrane, thekson Horeshka. Sipas tij, ky aktivitet duhet bërë pjesë e një debati lokal e kombëtar.

Kombinimin me Odën Dibrane e mbështet si ide edhe Besniku. “Nëse arrin që Oda Dibrane të bëhet në të njëjtën kohë me panairin do ishte diçka më e bukur, tamam festë. Oda Dibrane atëherë është më e larmishme”. Besniku është i mendimit se panaire të tilla mund të bëhen edhe në rajone të tjera të Dibrës.

Për përmirësimin e panairit në vitet që vijnë, Besniku mendon se duhet të bëhet një përzgjedhje paraprake e produkteve që prezantohen si dhe të zgjatet panairi më shumë se 1 ditë.

“Panairi duhet shndërruar në një debat të shumë niveleve, për faktin se rëndësia e kësaj çështje është kuptuar jo vetëm nga fermerët, por edhe nga organizatat e donatorëve. Unë insistoj në nevojën e organizimit të këtij debati apo diskutimi, - thotë Horeshka, pasi sa herë ka pasur nxitje, bashkëpunimi dhe mbështetja nuk ka munguar. Mendimi im final mbetet që të mbështetet biznesi që e organizon atë në mënyrë private dhe në mënyrë të kontraktuar. Ia vlen të kushtosh kohë dhe para për këtë aktivitet”.

BLI BIO!

Nuk e di nëse vetëm unë e kam këtë përshtypje, por kam idenë se ne dibranët, ndryshe nga sa na njohin, secili veçmas bën shumë për Dibrën: për kulturën, historinë, ekonominë, por së bashku duket se kemi më shumë fjalë. Njëra nga mënyrat për ta ndihmuar dhe për të kontribuar për Dibrën është edhe që të kemi sa më shumë në tavolinat tona të ngrënies produkte të Dibrës. Kështu që, në qoftë se ju pëlqejnë mollët dhe dardhët, shumë të shijshme dhe shumë të pashme në shumëllojshmëri varietetesh i ka Vehip Salkurti dhe atij mund t’i telefononi në numrin 069 20 72 408. Nëse ju pëlqen mjalti, sidomos ajo luga e parë e mëngjesit kur niseni për në punë, Haxhi Mani ju siguron se e ka nga më të mirin. Porosisni ca bidona te numri 0686469360. Kujdes, mos e ngatërroni me sherebelen :) Atyre që ju pëlqen djathi, i shumëllojshëm dhe shumë i mirë, Luan Shehi ua përgatit edhe me forma të ndryshme që mund të zbukurojë tavolinat tuaja festive. Ruajeni telefonin e tij 068 63 74 334 dhe porosisni ndonjëherë kur t’u kalojë rruga për Peshkopi. Ose në qoftë se ju pëlqen kompostot e ftoit, qershisë apo kumbullës, bëjini një zile Izet Selxhaferit në numrin 068 35 87 876 dhe ai do ju tregojë vendin se ku shiten në Tiranë. Ah, se harrova, për ju që pini rakinë, Izeti jua shoqëron me turshi ekstra. Shumë të mira!

Por jo vetëm këta, por çdo mik i juaji në Dibër e ka një gjë bio! Blijani, sepse kështu ushqeheni më mirë dhe ndihmoni sadopak ekonominë e vogël të fermerëve.


Dibranë kudo që jeni, blini produkte bio! Blini në Dibër!

Rruga e Arbërit nr. 90

Shqipëria duhet të jetë një vend i zhvilluar i gjithi dhe kjo bëhet vetëm nëpërmjet infrastrukturës.

opinione

Rruga që bashkon vlerat kombëtare


Foto© B.Karoshi

Kujtim Çashku
Unë e konsideroj shumë të rëndësishme ndërtimin e rrugës së Arbrit sepse të gjithë do të dallojmë jo vetëm sesa e rëndësishme do të jetë rruga vetë, por edhe qielli, shpirti dhe mendja do të jenë më të pasur, më të shëndetshëm e më human.

Mikel Zavalani, TIRANE, ALBANIA: Rruga e arbrit është arteria e dytë më e rëndësishme për popullin shqiptar dhe lidhjen me Maqedoninë në mënyrë që të forcohet rajoni dhe të marrë zhvillim ekonomik të mëtejshëm hapësira e rajonit të trevave shqipare.

Valmira Llorja, Tirana, Albania, Sepse unë kam pjesën tjetër të familjes time atje, dhe për t'i vizituar ata më duhet të harxhoj shumv kohë udhëtim.

Zamira Gjeleshi, PESHKOPI, ALBANIA: Arterie e trojeve etnike iliro-shqiptare.

Ardit Mane, LUSHNJË, ALBANIA: Që të ndërtohet.

Fabio Zeneli, ITALY: Është tepër e rëndësishme për dibranët, Shqipërinë, madje dhe për Bashkimin Europian! Bëhet fjalë për zhvillimin komercial të Shqipërisë, rritje të shpejtësisë me të cilën do të ofrohen shërbime nga jashtë për në Shqipëri dhe anasjelltas. Le të përfundojë sa më shpejt, duke shpresuar që administrata publike të punojë me pastërti dhe me standarde, duke vënë në punë dhe qindarkën e fundit, sepse janë PARA PUBLIKE! Të derdhura nga vet qytetarët, dhe është i detyrueshëm për Shqipërinë investimi i këtij fondi, që e përsëris, nuk janë gjë tjetër veç se parat publike të derdhura nga qytetarët, që në këmbim kërkojnë investime dhe shpërblime prej administratës shtetërore! Go ahead!

Erjona Lala, TIRANA, ALBANIA: Dibra është vendlindja ime.

Elvis Bushi, TIRANE, ALBANIA: Është vendlindja ime dhe sepse janë sakrifikuar mijëra jetë duke punuar shumë për Shqipërinë.

Dionis Xhafa, TIRANA, ALBANIA: Që të ndërtohet rruga e Arbrit.

Ergys Jera, ITALY: Është e rëndësishme për gjithë Shqipërinë. Për zhvillimin e ekonomisë, turizmit dhe një hallkë e zhvillimeve pozitive për kulturën e shoqërisë jo vetëm në Shqipëri por për gjithë Ballkanin.

Elda Hasa, PESHKOPI, ALBANIA: Është një rrugë që duhet ndërtuar patjetër sepse ka rëndësi kombëtare dhe është mjaft e dobishme sepse shkurton mjaft distancën.

Paul Math, KOLKATA, INDIA: Nevojë urgjente për zhvillim dhe përparimin e popullsisë lokale.

Endri Xhepa, TIRANA, ALBANIA: Jetoj këtu, ndaj.

Hamit Rexhepi, TIRANA, ALBANIA: Është vendlindja ime dhe e meriton si një vend i rëndësishëm për shtetin shqiptar.

Leandro Leka, TIRANA, ALBANIA: Rruga që bashkon shqiptarët anë e mbanë.

Valbera Nasja, SHKODER, ALBANIA: Për një Shqiptari të bashkuar pa kufij.

Arlend Lela, TIRANA, ALBANIA: Jam lindur në Dibër.

Evis Bakiu, TIRANA, ALBANIA: Rrugët sjellin zhvillim, kjo rrugë është e një rëndësie të veçantë për vetë faktin se banorët e kësaj zone janë pothuajse të izoluar. Rruga aktuale nuk është rregulluar asnjëherë me idenë se do të ndërtohej rruga e Arbrit dhe sot rruga për Peshkopi mund të jetë një ndër rrugët më të këqijat në të gjithë Evropën. Shpresojmë që punimet që kanë filluar në lindje të Tiranës të vazhdojnë dhe të përfundojë ky makth për të gjithë banorët e asaj zone.

Fisnik Papraniku, DEBAR, MACEDONIA: Për të udhëtuar në Shqipëri.

Qemal Isufi, TIRANA, ALBANIA: Rruga e Arbrit është e domosdoshme sepse na lejon të komunikojmë dhe të kontribuojmë për zhvillimin e të dyja Dibrave.

Abdulla Osmani, TETOVO, MACEDONIA: Sepse lehtëson rrugën për në kryeqytetin e Shqipërisë.

Taulant Capa, TIRANA, ALBANIA: Rruga e Arbrit ka luajtur një rol të rëndësishëm që në kohët e hershme si një nga segmentet më të rëndësishme të veprimtarisë tonë kombëtare. Sot Rruga e Arbrit është po aq e rëndësishme duke u përshtatur në kohët e modernitetit, komoditetit, strategjive politike, ekonomike sociale etj. Rruga e Arbrit jo vetëm që afron krahinën e Dibrës me kryeqendrën e shqiptarëve Tiranën, por ajo afron akoma me shkurt te shqiptarët në Maqedoni me Tiranën, pra kryeqytetin tonë të të gjithëve. Po ashtu ajo luan një rol të rëndësishëm në sferën e transportit, ekonomisë dhe shoqërisë duke e bërë më të lehtë rrugëtimin horizontal të Ballkanit qendror me atë perëndimor. Uroj që ky segment të përfundojë sa më shpejt në bazë të së cilës dhe efektiviteti i saj pozitiv të konkretizohet më së miri në aspektin kombëtar e rajonal në lëvizjen dhe njohjen e njerëzve, mallrave dhe zhvillimeve të përgjithshme. Me respekt për Dibrën dhe dibranët, dibrani juaj Taulant Capa, aktivist i shoqërisë civile / Kryetar i Këshillit Mbarëshqiptar.

Igli Ferati, TIRANA, ALBANIA: Rruga e Arbrit është një ndër rrugët kryesore që duhej të ishin përfunduar në Shqipëri! Është një rrugë që zgjeron ekonominë e vendit duke i dhënë mundësi banorëve të fillojnë bizneset e tyre. Është lënë shumë mbas dore si rrugë dhe me ndërrimin e qeverive asgjë nuk po arrihet. Kam kaluar në pjesët e bëra në rrugët e Arbrit dhe lënë për të dëshiruar kur shikon që ato pjesë që sipas politikanëve quhen autostradë janë kthyer në rrugë interurbane për arsye se janë konsumuar dhe nuk i plotësojnë dhe parametrat e një autostrade. Shpresoj që diçka e mirë të ndodhë me atë rrugë dhe pastaj Dibra do marrë zhvillimin që i takon dhe të gjithë të kenë mundësitë të kalojnë më kollaj! Sepse udhëtoj shpesh për në Dibër sepse është vendi im i origjinës. Dua të ndërtohet dhe të jetë një rrugë shumë e mirë!

Neki Meda, TIRANA, ALBANIA: Për afrimin e kësaj zone më afër Tiranës.

Dashamir Dani, SHUPENZë, ALBANIA: Është jetike për vendin tonë. Përse duhet të jemi krahina më e prapambetur në vend? Kemi kontribuar me shumë se sa disa krahina të tjera për Shqipërinë. Vetëm kromi i Bulqizës do ta kishte shtruar me dhjetëra herë rrugën e Arbrit.

Gerti Meziu, TIRANA, ALBANIA: Një rrugë më e shpejtë për në vendlindje.

Shkelzen Qylhanxhiu, TIRANA, ALBANIA: Sepse nuk i bihet nga Kina, ne dibranët e kemi qejf me i bo disa gjëra me qark të shkurtër.

Mimoza Kaliqi, TIRANA, ALBANIA: Sepse është nga rrugët më të hershme në Shqipëri, por më të pamirëmbajtura (të lëna pas dore). Dhe sepse është një zonë e shumë populluar e për më tepër duhet të rregullohet në respekt të atyre banorëve që jetojnë e punojnë në atë zonë pa menduar të braktisin vendin dhe tokat e tyre.

Lisander Jella, TIRANA, ALBANIA: Për zhvillimin ekonomik dhe social, kosto të ulët për transportin ndërkombëtar drejt Maqedonisë etj.

Redi Ruta, BULQIZË, ALBANIA: Është perspektivë për të ardhmen e Dibrës.

Olti Cani, PESHKOPI, ALBANIA: Shumë e rëndësishme për biznesin

Albjon Jolie, MAQELLARE, ALBANIA: Dibra është zgjimi i vërtetë i Shqipërisë .

Jona Rexha, TIRANA, ALBANIA: Për të zhvilluar Dibrën dhe Tiranën gjithashtu.

Nikolin Dodaj, TIRANA, ALBANIA: Është shumë e rëndësishme se e shkurton rrugën me pesë orë dhe kur është kështu është budallëk që të humbasim jetën në rrugë kur mund ta kalojmë me njerëzit tonë ose duke fjetur gjumë ose duke bërë ndonjë punë tjetër.

Renato Hasani, JESI, ITALY: Lidh shqiptarët e Shqipërisë me ata të Maqedonisë në një kohë më të shkurtër

Nikos Skarra, GERMANY: Për jetën

Alma Dervishi, TIRANA, ALBANIA: Është e rëndësishme sepse është vendlindja ime e dashur dhe po të bëhej rruga e ARBËRIT do kthehesha atje.

Behar Mera, TIRANE, ALBANIA: "Rruga e Arbrit" , një mundësi më shumë për zhvillimin ekonomik , tregtar, kulturor si dhe një shans për të mundësuar njohjen e shqiptarëve dhe më gjerë me traditat, kulturën dhe gjithçka të mirë që përfaqëson Dibra dhe dibranët.

Viola Kaca, HAMILTON, CANADA: Është e domosdoshme që kjo rrugë të mbarohet për banorët e Shqipërisë

Marsida Kurti, ITALY: Kur të shkoj të vizitoj prindërit e mi në Dibër, të kem mundësi të shkoj pa mu prishur gomat e makinës rrugës. E madje zona mund të jetë një zonë turistike më shumë se sa mendohet!!

Gerald Saraci, PESHKOPI, ALBANIA: Jetoj aty dhe e pëlqej vendin tim.

Artur Tirana, CAIRO MONTENOTTE, ITALY: Dëshiroj që të ketë më shumë rrugë komunikimi në Shqipëri, që do të thotë zhvillim.

Yllka Rudi, ROMA, ITALY: Sepse Shqipëria duhet të jetë një vend i zhvilluar i gjithi dhe kjo bëhet vetëm nëpërmjet infrastrukturës.

Ardit Rustani, DIBER, ALBANIA: Të bëhet rruga e Arbrit. Është me rëndësi për gjithë Shqipërinë, jo vetëm për dibrën, sepse është rrugë lidhëse mes Europes lindore me kryeqytetin.

Renaldo Teferici, ITALY: Për të mirën dhe sigurinë e të gjithë atyre që udhëtojnë në Shqipëri. Mjaft të vdekur kemi nëpër rrugë!

Eglantin Macka, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse rruga që është aktuale është e keqe dhe shumë e lodhshme.

Marina Zefi, TIRANA, ALBANIA: Dibra është një nga zonat më pak të zhvilluara të Shqipërisë. Rruga e Arbrit do të lidhë Dibrën me pjesën tjetër të vendit dhe do ti japë hovin e nevojshëm për ekonominë lokale. Rruga gjithashtu do të jetë një rrugë e shkelur që lidh Tiranën me Maqedoninë duke përmirësuar kështu ndjeshëm infrastrukturën në këtë pjesë të Ballkanit.

Elona Rama, ITALY: Sepse vendi ynë duhet të bëhet më i mirë

Deliana Veliaj, ITALY: Përpara Shqipëri…

Jetmir Piraj, ITALY: Këtë verë kalova nga kjo rrugë dhe punimet ishin në vazhdim shpresoj që të mbarojnë sa më shpejt.

Rruga për të cilën po lobojmë do të përmirësojë ndjeshëm infrastrukturën e transportit mes vendlindjes së Nënë Terezës, Shkupit dhe Tiranës, thotë Gëzim Alpion, profesor i Sociologjisë në Universitetin e Birmingamit.

Behar Mera
"Rruga e Arbrit" , një mundësi më shumë për zhvillimin ekonomik , tregtar, kulturor si dhe një shans për të mundësuar njohjen e shqiptarëve dhe më gjerë me traditat, kulturën dhe gjithçka të mirë që përfaqëson Dibra dhe dibranët.

Giuseppe Musacchia, SANTA CRISTINA GELA, ITALY: Sepse jam me origjinë nga Shqipëria.

Evis Hepaj, ITALY: lidh Shqipërinë me vendet jashtë

Besiana Canaj, ITALY: Si shqiptare që jam e duke vizituar shpesh Shqipërinë, dalloj mungesën e rrugëve dhe mjeteve të përshtatshme për të lidhur qytetet e ndryshme; është e nevojshme të lidhen më shpejt zonat e banuara dhe të përmirësohet jeta e banorëve. Duhet shtuar që rrugët më të mira sjellin si rrjedhim më shumë turizëm, e për më tepër, turizëm me nivel më të mirë sesa ai aktuali.

Ermal Rica, ITALY: Ndërtimi i rrugës së Arbrit është një detyrim që kemi të gjithë si popull ndaj historisë dhe ndaj njëri-tjetrit, për t'u afruar më afër me vëllezërit tanë dibranë, për të thyer paragjykimet, për t'i dhënë frymë turizmit dhe zhvillimit ekonomik të zonës.

Sadete Qosja, ITALY: E rëndësishme për shqiptarët.

Anatol Gjata, LUSHNJE, ALBANIA: Pa rrugë nuk ka zhvillim.

Arens Fishta, LEGNAGO, ITALY: Zhvillimi i Shqipërisë me intereson. Forca Shqipëria!

Sokol Suparaku, ITALY: Është e rëndësishme për jetën ekonomike të atij komuniteti, si të gjitha "arteriet" rrugore anë e mbanë Shqipërisë.

Agim Danaj, CASERTA, ITALY: Sepse më intereson zhvillimi i vendeve kufitare.

Alban Florida, VERONA, ITALY: Për zhvillimin e vendit tonë, duam autostradë me nivel europian

Petrit Zyka, AUSTRALIA: Ka përfitim shumë domethënës për zhvillimin e njerëzve që banojnë në atë zonë.

Kujtim Çashku, TIRANË, ALBANIA: Unë e konsideroj shumë të rëndësishme ndërtimin e rrugës së Arbrit sepse të gjithë do të dallojmë jo vetëm sesa e rëndësishme do të jetë rruga vetë, por edhe qielli, shpirti dhe mendja do të jenë më të pasur, më të shëndetshëm e më human.

John Braidwood, OULU, FINLAND: Sepse Shqipëria ka rëndësi.

Mevlan Xhurxhi, TIRANA, ALBANIA: Sepse jam nga Dibra.

Hajdin Abazi, FERIZAJ, SERBIA: Për lidhjen më të shkurtër, komunikimin më të shpejtë, afrimin gjeografik real.

Rahim Agushi, AL AIN, UNITED ARAB EMIRATES: Kjo është si të pyesësh të verbrin a do sy.

Enkeleda Halili, CONNECTICUT, NY: Ndërtimi rrugës së Arbrit për të mirën e gjithë krahinave që i përkasin asaj ane.

Kamberi Belgzim, PRESHEVA, SERBIA: Lidhja Shqipëri-Maqedoni-Luginë e Preshevës.

Asan Asani, KICHEVO, MACEDONIA: Dibra është një nga zonat më pak të zhvilluara të Shqipërisë. Rruga e Arbrit do të lidhë Dibrën me pjesën tjetër të vendit dhe do ti japë hovin e nevojshëm për ekonominë lokale. Rruga gjithashtu do të jetë një rrugë e shkelur që lidh Tiranën me Maqedoninë duke përmirësuar kështu ndjeshëm infrastrukturën në këtë pjesë të Ballkanit.

Franc Jakova, WINDSOR, CANADA: Në rast se nuk ke ndërmend të bësh një gjë mos gënje se do ta bësh.

Valentin Sema, DUBAI, UNITED ARAB EMIRATES: Është e rëndësishme për të gjithë shqiptarët, e jo vetëm për mua.

Enkel Demi, TIRANA, ALBANIA: Sepse është!

Lizander Lila, BULQIZË, ALBANIA: I vjen në ndihmë komunitetit tonë....

Ola Lombardi, PITTSBURGH, PA: Është e rëndësishme për zhvillimin e të gjithë vendit dhe për rajonet afër fqinje.

Ildo Nelollari, TIRANA, ALBANIA: Na ndihmon shumë.

Harbi Aliaj, TIRANA, ALBANIA: Sepse do shkurtojë rrugën për në Klos.

Rob Edge, BIRMINGHAM, UNITED KINGDOM: Për integrimin në Europë dhe për lidhje më të mira në rajon.

Lindita Tahiri, PRISHTINA, ALBANIA: Një nevojë urgjente për komunikim normal mes shqiptarëve.

Manjola Zogu, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse është qyteti im.

Vladimir Skënderi, TIRANA, ALBANIA: Sepse jam lindur në Dibër.

Edison Hysa, PESHKOPI, ALBANIA: Shkurton rrugën dhe sjell zhvillim.

Brahim Halimi, SKËNDERAJ - DRENICË, KS: Çdo veprim që ka si synim dhe qëllim përparimin dhe zhvillimin e mirëqenies së popullit shqiptar është për mua i një rëndësie të veçantë prandaj dhe duhet përkrahur ... E kjo vlen edhe për Rrugën e Arbrit ...!

Mediar Fazlija, Tetove, Norway: Rruga i bashkon vlerat kombëtare.

Carolyn Telha, BERRIEDALE, AUSTRALIA: Familja ime jeton në Shqipëri.

Bardhyl Maliqi, SARANDË, ALBANIA: I shërben kombit.

Shaha Bytyqi, GERMANY: Sepse të gjitha këto vende kanë nevojë të takohen e të jetojnë më njëri-tjetrin.

Enida Çela, TIRANA, ALBANIA: Sepse është vendlindja ime.

Elliott Moglica, TORONTO, ONTARIO, CANADA: Ka shumë arsye për të përfunduar ndërtimin e Rrugës së Arbrit: lidh periferinë e Ballkanit me zemrën e tij; Do të jetë një investim afatgjatë jo vetëm për Dibrën e Shqipërinë, por për të gjithë Ballkanin; Shqipëria duhet të ketë rrugë të mira për të përfituar nga tregjet Europiane; Kjo rrugë do t'ju sjellë më shumë liri banorëve të të gjithë rajonit; një rrugë kryesore do të reduktojë gazrat që shkarkohen nga rrugë dytësore. Ndaj, çdo përpjekje për të përfunduar këtë rrugë do të mundësojë zhvillim ekonomik dhe do të jetë një vegël që do të sjellë përparim në vetvete.

Nait Buxhaku, BIBIONE, ITALY: Sepse kemi nevojë shumë për këtë rrugë, ndaj!

Çlirim Vorfi, PESHKOPI, ALBANIA: Duam rrugën e Arbrit!

Kim Ceka, ITALY: Duhet të mobilizohemi që me çdo kusht të hapim edhe këtë arterie të rëndësishme jo vetëm për Matin e Dibrën, por për kombin e më gjerë... Sepse kjo arterie do të bënte më funksionale një pjesë të konsiderueshme të kombit. Kur të gjithë muskujt funksionojnë mirë, i gjithë trupi funksionon mirë. Le të mos harrojmë që muskujt e krahut verilindor i janë dashur gjithmonë kombit tonë.

Liman Spahiu, PESHKOPI, ALBANIA: Për të udhëtuar më shpejt.

Natasha Gjoka, BULQIZË, ALBANIA: Bashkohem me mendimin për vazhdimin e ndërtimit të Rrugës së Arbrit.

Adriatik Topalli, WATERBURY, CT: Jam lindur në Dibër dhe kam familjen ende atje! Kjo rrugë është e rëndësishme për mua edhe për të gjithë ata që jetojnë andej.

Serxho Kurti, SHUPENZË, ALBANIA: Kjo rrugë është e rëndësishme për ne sepse e kemi ëndërruar e shpresojmë që një ditë do të jetë e mbaruar e do të ecim në të... Kjo është arsyeja.

Shemsi Bajraktari, PESHKOPI, ALBANIA: Që të jemi afër me qytetet e tjera.

Sivi Marku, TIRANA, ALBANIA: Është e nevojshme për të gjithë Shqipërinë, lidh trojet shqiptare.

Shyqiri Cenga, FRANCE: Është shumë e rëndësishme për gjithë dibranët dhe për të gjithë shqiptarët.

Anisa Kolgjini, TIRANA, ALBANIA: Jam nga Dibra. Është e rëndësishme për të gjithë ne.

Ervis Marku, TIRANA, ALBANIA: Është e rëndësishme sepse mund të vizitojmë më shpesh vendin tonë të lindjes, pastaj edhe vetë Dibra do ketë një zhvillim shumë të madh, është në të mirë të gjithë shqiptarëve, edhe shqiptarët e Maqedonisë mund të vijnë shumë herë më shpejt në Shqipëri :)

Tea Jashari, PESHKOPI, ALBANIA: Kur dikush ma bën këtë pyetje 'Pse na duhet "Rruga e Arbrit"' ndjej se kam shumë për të folur. Rruga e Arbrit do të thoja se do ishte "shpëtim" për ne dibranët.

Tirana është kryeqyteti dhe lëvizja jonë drejt këtij qyteti është e madhe. Lëvizje qoftë migruese apo transportuese apo mbase edhe turistike. Për të transportuar mallra do ishte më e favorshme që rruga të ishte më e shkurtër prandaj na duhet "Rruga e Arbrit" me standarde, për t'u shpërngulur shumica e njerëzve marrin mobilje me vete për në shtëpinë e re por për këtë gjë duhet "Rruga e Arbrit" me standarde të larta. Turistët nuk duan të bëjnë rrugë të gjata e të lodhshme po duan rrugë të qeta e normale prandaj duhet "Rruga e Arbrit" e standardeve të larta. Janë ca gjëra që vazhdojnë të na shqetësojnë. Duam të hymë në Europë, por pa rrugët më të rëndësishme të papërfunduara s'besoj të presim të hymë se siç e dimë në BE të gjithë rrugët më të rëndësishme dhe jo vetëm janë të përfunduara. Atëherë duhet të nxitojmë se koha nuk pret. "Rruga e Arbrit" po na therret. :)

Përktheu dhe përgatiti për botim:
Afrim Karoshi

Mbi modalitetet e nënshkrimit të peticionit online për Rrugën e Arbërit

Dëshirojmë të njoftojmë gjithë lexuesit se peticioni onlinë për Rrugën e Arbrit do të vazhdojë të firmoset dhe ai do të mbyllet vetëm kur të përurohet rruga Tiranë-Dibër.

Shumë qytetarë në Shqipëri dhe në vende të tjera kanë komunikuar me redaksinë e gazetës "Rruga e Arbërit" dhe hartuesin e peticionit për të konfirmuar se e kanë nënshkruar atë si dhe për tu interesuar nëse nënshkrimet e tyre janë regjistruar.

Pavarësisht ftesave të ripërsëritura për ta firmosur peticionin, njoftojmë se vetëm nënshkrimet që përmbushin kriteret e rrepta të transparencës të përcaktuara që kur filloi peticioni, do të përfshihen në dokumentin zyrtar që do t'i dorëzohet qeverisë së re.

Ju rikujtojmë se kush e ka nënshkruar peticionin online, nuk duhet ta firmosë për së dyti, si dhe nuk ka të drejtë ta nënshkruajë atë në letër.

Lista e plotë e nënshkrimeve dhe komentet e bëra online do të jenë dokumente publike.

Gjithashtu, njoftojmë gjithë ata që kanë firmosur peticionin në letër, t'i sjellin ato sa më shpejt në redaksi, pasi procesi i përgatitjes së peticionit për t'iu dorëzuar qeverisë shqiptare ka filluar.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj!



NDIQ HAPAT E MËPOSHTME PËR TË FIRMOSUR SAKTË:

1 - KLIKO NË FAQEN E WEB SI MË POSHTË:
www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-thearb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarderrug% C3%ABn-e-arb%C3%ABrit?utm_campaign=petition_created&utm_medium=email&utm_source=guides

2- LART, DJATHTAS SHFAQEN KUADRATET BOSH
Shkruaj Emrin, Mbiemrin, Adresën e emailit dhe Qytetin tuaj. Pastaj klikon **"Sign".**
Pas kësaj, ju do të merrni një mesazh falënderimi dhe konfirmimi që emri juaj u regjistrua.
Për të gjithë miqtë tuaj që nuk kanë mundësi hyrje në web,
sharko formularin dhe plotësoje me dorë.
Për hollësi mund të vizitoni faqen e gazetës
në Web: <**www.rrugaearberit.com**>
ose në Facebook <**facebook.com/gezim.alpion**>
ose <**facebook.com/rruga.arberit**>

Rruga e Arbrit mbërrin në Indi

*Gazetari i njohur C. M. Paul i bën jehonë peticionit në mediat Indiane.**

Një ekspert i Nënë Terezës në Mbretërinë e Bashkuar ka nisur një peticion online për një rrugë, e cila do të sjellë më pranë nesh vendlindjen e murgeshës me famë botërore.

"Rruga për të cilën po lobojmë do të përmirësojë ndjeshëm infrastrukturën e transportit mes vendlindjes së Nënë Terezës, Shkupit dhe Tiranës", thotë Gëzim Alpion, profesor i Sociologjisë në Universitetin e Birmingamit.

Rruga e Arbrit ofron një lidhje më të mirë me Dibrën dhe do të ndihmojë në "zhvillimin e kësaj pjese të Ballkanit, e cila vuan nga mungesa e një rrjeti të mirë rrugor", u shpreh ai duke theksuar se kjo zonë është ndër rajonet më të pazhvilluara në Shqipëri, një vend në Europën jug-lindore.

Rruga do të krijojë një ndërlidhje të re vitale mes Shqipërisë e Maqedonisë, si dhe do t'i ofrojë Bullgarisë hyrje direkte në Adriatik dhe Detin Mesdhe.

Rruga ekzistuese prej 180 km është "një stërzgjatje torturuese dhe aspak e mirëmbajtur", thekson bashkëkombësi i Nënë Terezës. Sipas tij, rruga e re prej 70 km do ta shkurtoj kohën dhe koston e udhëtimit.

Alpion, që jeton në Birmingam, konsiderohet nga kritika si "autori me autoritar për Nënë Terezën në gjuhën angleze". Libri i tij i ri për Nënë Terezën, që do të botohet në shtator 2014, përfshin materiale që nuk janë publikuar deri më sot mbi jetën e murgeshës shqiptare.

Ai u shpreh se peticionin online për Rrugën e Arbrit e nisi më 18 mars "me shpresën për të ndihmuar Dibrën, vendlindjen time, zhvillimi i së cilës për mua është shumë i rëndësishëm. Po kështu, peticioni synon të tërheqë vëmendjen e politikanëve shqiptarë drejt varfërisë që ka pllakosur prej kohësh zonën e Dibrës."

Ai tha se së shpejti do të kthehet në Tiranës për t'i dorëzuar peticionin kryeministrit të ri të Shqipërisë, z.Edi Rama, dhe për të zhvilluar takime me një numër zyrtarësh të lartë në vend.

Alpion është larguar nga Dibra në moshën 14 vjeçare për të studiuar fillimisht në Tiranë e më pas në Universitetin e Kairos dhe atë të Durhamit. Rrënjët dibrane janë "tepër të rëndësishme" për të edhe pas 37 vitesh.

Ai e përshkruan Dibrën si "një zonë me bukuri natyrale të jashtëzakonshme" dhe 200,000 banorët e saj si "të mençur dhe shumë punëtorë, por gjithmonë të lënë pas dore nga shteti." Sipas tij "Dibra, nga të gjithë rrethet e Shqipërisë, nuk duhet të jetë e varfër vetëm po të kemi parasysh pasuritë e saj minerale të jashtëzakonshme."

Në 1980-ën Shqipëria renditej e treta në botë si prodhuese kromi me mbi një milion ton në vit. Rezervat e kromit gjenden në Bulqizë, që është pjesë e zonës së Dibrës.

Rruga e Arbrit gjoja ka qenë "prioritet" për disa qeveri shqiptare për më shumë se 10 vjet. Megjithëse lobimi për ndërtimin e saj ka nisur gati 20 vite më parë, deri tani punimet kanë përparuar pak.

"Rruga e re do të rilindë dibranët," u shpreh Alpion.

Më shumë se 4000 njerëz anë e mbanë globit kanë nënshkruar peticionin online dhe formularët që janë përgatitur në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Peticioni është përcjellë gjerësisht nga media në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe nga mediat shqiptare në diasporë: Amerikë, Angli, Kanada, Australi, Itali, Greqi, Zvicër, Bullgari e Rumani.

Alpion beson se vëmendja që politikanët shqiptarë i kushtuan Rrugës së Arbrit gjatë zgjedhjeve të qershorit dëshmon rolin e rëndësishëm që shoqëria civile mund të luaj në Shqipëri. "Shoqëria civile është ende në një fazë embrionale në Shqipëri dhe në vende të tjera ish-komuniste," argumenton Alpion, "por shenjat e para janë shpresëdhënëse."

Përktheu: ***Erisa Saraçi***

**Shkrimi i C. M. Paul, i titulluar "Mother Teresa expert roots for Skopje", u botua ne Indi ne MATTERS INDIA me 28 tetor 2013: http://mattersindia.com/mother-teresa-expert-roots-for-skopje/*

Rruga e Arbërit nr. 90

vëzhgim

Shëtitorja nga pronë e qytetarëve sot është kthyer pronë e makinave. Fare pranë shtatores së heroit tonë Gjergj Kastrioti Skënderbeu është ngritur një kioskë. Shesin kafe, pije, pse jo dhe qofte.

Ç'kemi asaj Dibre!

(Vijon nga faqja 1)

Në Bulqizë një burrë 51 vjeç e shtypi makina. Shiste mish në anë të rrugës. Kush e pati fajin? Shoferi, makina, rruga apo viktima? Zakonisht te ne fajet i merr viktima me vete në botën tjetër. Se të themi që e ka rruga pa standarde ka dalë jashtë mode tani...

Në Maqellarë një 65 vjeçar dogji veten me benzinë. Thanë se ishte i dehur dhe e shpëtuan bashkëfshatarët. Zakonisht të dehurit fyejnë të tjerët, por ky është zotni i dehur, djeg veten...

Një gazetar britanik ka qenë në Peshkopi. Ka blerë ca armë për rrjetet kriminale në Angli. Apo më mirë, ta lëmë këtë lajm, se ju dini anglisht më mirë se unë dhe mund ta keni lexuar më hollësisht te "The Sun"!

Një prokuror e nxori gjykatësin ta merrte vendimin në korridor. Gjykatësi e zhvillonte gjyqin në zyrën e tij dhe në fund tha "Trupi gjykues tërhiqet për të marrë vendim". Prokurori dhe palët në gjyq nuk lëvizën nga vendi. "Dilni pra jashtë!", u tha gjykatësi. "Po pse ne, zoti gjyqtar! Ju thatë se trupi gjykues tërhiqet për të marrë vendimin. Atëherë ju duhet të dilni jashtë "..

Prefektin e zgjodhëm. Djalë i mirë thonë. Edhe LSI-st, edhe socialist! Ca drejtorë nuk i kemi zgjedhur akoma. Po i shoshitim njëherë emrat, pastaj vendosim!

Në Bulqizë do hapen letrat. Ministri këndej nga Tirana ka urdhëruar verifikimin e të gjitha lejeve minerare. Po i hapën letrat brenda, do gjejnë ndonjë gjë, po i hapën jashtë, ua mori era e Qafë Buallit...

Fiksi ka shkuar këto kohë shpesh në Dibër... I ka rënë nga Kalaja në Gollobordë. I keni parë besoj! Ka folur për arsimin, për bujqësinë, për prerjen e pyjeve. Kur i shohim te Fiksi themi se i dimë, ama përpara nuk e hapim gojën. "S'dimë gjë, themi kur na pyesin. Ose ndonjëherë i biem më shkurt. "Punë spiunësh!". E reja nga fiksi është se luznakëve u është hapur gojë. Jo për ato sarkazmat që i kanë në natyrën e tyre, por për të folur për varfërinë...

Këto ishin andej nga Dibra! Këtej nga Tirana nuk ka shumë ndodhi. Vetëm në dogana është zbuluar Grupi i Dibranëve. Ca grupe të tjera dibranësh janë gati të zbulohen te tatimet, te policia, te SHIK-u, te ushtria, por këto nuk janë dhënë akoma në lajme; në gazeta dhe televizione.

Sapo të dalin, jam i sigurt se do më njoftoni ju të parët!



Mos e prishni qytetin!

Nga **SHAQIR SKARRA**

Dikur jo vetëm dibranët, por edhe nga rrethe të ndryshme të vendit, kur vizitonin qytetin e Peshkopisë mahniteshin me shëtitoren. Dikur qytetin e Peshkopisë e quanin qytet i bukurisë dhe pastërtisë, sa që klasifikohej si një ndër më të bukurit dhe më të pastër në të gjithë zonën veri-lindore. Çdo gjë ishte ndryshe. Kishte bibliotekë mjaft të pasur, të rregullt e të sistemuar bukur edhe me një mjedis jo fort të përshtatshëm ku qytetarët deri natën vonë kalonin orët mbi libra.

Dikur kishte një muze etnografik që krahasohej me muzeun e Beratit dhe Shkodrës me dyzet dhoma. Dikur qyteti kishte gjelbërim, kishte ujë të bollshëm që vinte nga bjeshkët e Korabit. Dikur në stinën e vjeshtës e deri në pranverë era karakteristike e mollëve "starking" ishte e pranishme kudo në Peshkopi. Në pranverë kur çelnin blirët tjetër aromë e bukur zëvëndësonte erën e mollëve. Dikur kishte një lulishte të madhe mes kinemasë së vjetër dhe ish-gjimnazit, ku fëmijët e lagjes luanin dhe argëtoheshin, por dhe pleqtë çlodheshin e mblidheshin tok duke biseduar për probleme nga më të ndryshmet. Dikur kishte shtëpi kulture e galeri arti, kishte futboll, volejboll, mundje e alpinizëm. Dikur godina e bukur e spitalit dukej nga larg. Dikur fabrika e ushqimores si një ndër më modernet prodhonte rakinë e njohur "Uskania" si dhe reçelna e komposto të njohura. Dikur, eh, dikur kishte çdo gjë të mirë e të bukur në qytetin tim.

Sot jo! Nuk ndodhen më këto që thamë. Ato kanë mbetur më së shumti në kujtesën e popullit. Sot nuk mund të themi se qyteti i Peshkopisë klasifikohet ndër më të pastërtit. Jo, ky imazh i ka ikur qytetit. Dikur puntorët e pastrimit rrinin deri në orët e vona në bulevard dhe pastronin në vjeshtë edhe gjethen e fundit që binte nga blirët, sot vërtet koshat për hedhjen e plehrave në qytetin e Peshkopisë nuk mungojnë, megjithatë ndotja e qytetit është në nivele të tmerrshme. Perimetri i zonave të caktuara për plehrat duket se zmadhohet dita-ditës.

Kështu, në lulishten mes rrugës "Tercilio Kardinali" dhe shëtitorja "Elez Isufi", si dhe fare pranë pallateve, plehrat gjenden të shpërndara përtej koshave, duke e përhapur ndotjen e mjedisit në të gjithë zonën. Kjo ndotje rrezikon të kthehet në burim infeksioni për gjithë qytetin dhe është e nevojshme ndërhyrja e Bashkisë për të shtuar stafin e pastrimit të qytetit. Pikërisht, aty ku dikur ishte lulishtja kryesore e qytetit, sot është kthyer në një nga zonat më të ndotura, e cila "furnizon" gjithë qytetin me baltë të kuqe e pisllëk. Dhe si me humor qytetarët shprehen se takohemi tek kafe "quhni" (pluhuri).

E vetmja ndërtesë social kulturore ka qenë shtëpia e kulturës "Haki Stërmilli", sot muzeu i rrethit. Kjo shtëpi kulture e vogël ndoshta si ndërtesë, por me një arkitekturë të bukur e me një emër të madh ka pergatitur sa e sa breza këngëtarësh e artistësh që janë ngjitur edhe në skena botërore, kanë dalë artist të popullit e artist të merituar, janë përgatitur festivale lokale e kombëtare. Sot është kjo ndërtesë përsëri e kthyer në muze që drynat i janë ndryshkur se rrallë herë hapet, por sipër kësaj ndërtese është ngritur dhe një ndërtesë tjetër banimi mbi dhjetë-dymbëdhjetë kate, që i rri sipër si ombrellë ish shtëpisë së kulturës së dikurshme.

Në mes të qytetit, një peisazh kaq i ndotur që dikur ka qenë një ndër lulishtet më të bukura është jo estetike, që vetëm me pak investime qytetarëve mund t'iu kthehej një hapësirë e gjelbërt dhe mjaft çlodhëse, por kjo vështirë se kthehet si vite ma parë.

Lulishtari i mirë që u rrinte luleve e kujdesej natë e ditë për to si prindi me fëmijën e tij Agushi ka kohë që nuk jeton më. Pushteti lokal nuk ndjehet pasi problemi është gjetkë. Mendohet ku të gjendet ndonjë hapësirë për të ngritur ndonjë pallat. E njëjta situatë ndodhet dhe aty ku dikur ishin çezmat me ujë Korabi dhe lulishte rreth e qark tyre. Këtu nuk ka mbetur asgjë nga ai imazh i bukur i viteve më parë. Çezmat, gjelbërimi dhe uji i ftohtë i bjeshkëve të Korabit janë zhdukur ku e gjithë kjo zonë është kthyer në një zonë tregtare.

Ajo që bie në sy dhe që është pjesë e shqetësimit qytetar nuk janë vetëm këto, por janë dhe dëmtimet e rrugëve si dhe hapësirat e zëna mes pallateve me ndërtesa të reja shumë katëshe. Pjesa e rrugës "Tercillio Kardinali" si dhe "Elez Isufi", janë goxha të dëmtuar dhe sikur kjo të mos mjaftonte njëra prej korsive të rrugës përdoret si vendparkim për makinat, edhe pse në kushtet e shkeljes së rregullave të qarkullimit. Shtoji kësaj edhe zënien e hapësirës së trotuarit nga shitësit ambulantë, të kalosh në këtë aks bëhet një sfidë e vërtetë.

Sot është vështirë të kalosh në këmbë mes hapësirave të pallateve, pasi këto hapësira që kanë qenë dikur janë zënë të gjitha me ndërtime të reja, ku ruaj Zot mos të bjerë ndonjë zjarr se zjarrfikësja e ka të vështirë të ndërhyjë. Me këto ndërhyrje vend e pa vend, një katrahurë që është bërë këto vitet e fundit Peshkopia tashmë themi me bindje të plotë se e ka humbur shkëlqimin e dikurshëm, e ka humbur imazhin e viteve ma pare. Në qendër të qytetit një ndërtesë e bukur, një investim goxha i madh. Ky është pallati i kulturës që në fakt qytete edhe më të mëdhenj se Peshkopia nuk e kanë një ndërtesë të tillë.Është ndërtuar në vitet e vona edhe pse zgjatën pak si gjatë punimet, fundja u ndërtua dhe u hijeshua qyteti im.Por e keqja qëndron gjetkë.E gjitha kjo godinë dalngadalë e ka humbur funksionin për kulturën dhe argëtimin e të rinjëve. Po kthehet në një mejhane ku vetëm pihet kafe, lozet domino e bilardo. Biblioteka më së shumti wshtw e mbyllur. Ishte e shtunë kur trokita në derë, por na thanë se nuk punon të shtunë e të dielë. Ditë pushimi ku mjaft njerëz mund te futen në bibliotekë të shfletojnë ndonjë libër dhe ajo rrinte e kyçur. Aktivitetet kulturore e artistike kushtojnë shumë dhe pushteti lokal nuk ka fonde të jap për të tilla aktivitete. Dyert e sallës kryesore hapen vetëm në ndonjë rast kur ka ndonjë mbledhje me përmasa të mëdha e së shumti në fushata elektorale. Mes pallatit të kulturës e ish gjimnazit, sot filiali i universitetit "Aleksandër Moisiu" ka qenë një rrugë e bukur që ngjiteshe tek spitali dhe në lagjen Kamen.

Sot qysh në fillim i kanë bërë prita, e kanë bllokuar.Askush nuk e di pse. Ndoshta është në riparim e sipër por kjo stituatë nuk ka ndodhur sot. Ka kohë që e njëjta gjendje. Shtëtitorja e qytetit pronë e qytetarëve. Këtu ka patur gjithmonë gjallëri, lëvizje dhe shëtitje deri në orët e vona të natës.

Sot edhe kjo ka ndryshuar destinacion, nga pronë e njerëzve është kthyer në pronë e makinave. Jo vetëm e atyre makinave të shumta që parkohen pa kriter por dhe të atyre që ecin me shpejtësi mes për mes shëtitores. Një pakujdesi e vogël e qytetarëve dhe u kushton shumë. Nuk bëhet fjalë për në stinën e dasmave që shëtitorja "pushtohet" nga autokolona e makinave, por e njëjta situatë ndodh në çdo kohë e orë ku policia bën të pa diturin.

Shëtitorja nga pronë e qytetarëve sot është kthyer pronë e makinave. Fare pranë shtatores së heroit tonë Gjergj Kastrioti Skënderbeu është ngritur një kioskë. Shesin kafe, pije, pse jo dhe qofte. Tek ish shkolla bujqësore më së fundi është ngritur edhe pallati i sportit, me shumë vonesë, por u ngrit më së fundi. I dhanë dhe një lyerje të gjithin në blu që nuk ka nevojë për orientim se gjendet kollaj në këtë qytet të vogël, por volejbolli i femrave të Korabit, mundja e pse jo dhe alpinizmi në qytetin tim nuk ndjehen më. Pikërisht këto sporte që bënë që ekipi i "Korabit" të klasifikohej në shkallë vendi, sot ka mbetur në vend numëro. Jo që kanë rënë në gjumë ato sportistë që bënë emër në sportet dibrane por që pushteti lokal është i pa fuqishëm ti stimulojë, biznesi i Dibrës ende nuk është kthyer nga sporti ashtu si Kukësi e mjaft qytete të tjera të vendit. Sot muzeu etnografik që iu desh plot pesëmbëdhjet vite për tu ndërtuar nuk ekziston më, mjaftuan më pak se pesë orë për t'u shkatërruar. Iku pa nam e nishan gjithë ajo pasuri e madhe e kulturës dibrane. Spitali i Peshkopisë nuk duket nga larg. Hapësirat rreth e qark janë zënë me ndërtesa. Ka shpëtuar vetëm pak lulishte para spitalit. Fabrika e ushqimores, prodhim gjerman si një ndër më të mirat dhe modernet për ato vite sot nuk ekziston. Depozitat dhe makinera e saj u shitën për skrap.

Zëri qytetar është ngritur herët për këto që kanë ndodhur në Peshkopi por që deri më tani është bërë i pa dituri. Dhe unë sot bashkohem me zërin e tyre: Mos e prishni qytetin!

Për opinione dhe komente mund të na shkruani në adresën: <rrugaearberit@gmail.com>
OPINIONET DHE KOMENTET E BOTUARA NUK SHPREHIN DOMOSDOSHMËRISHT QËNDRIMIN E REDAKSISË



Shoqatat joqeveritare të Dibrës në Shqipëri të ngrenë çështjen edhe te qeveria shqiptare.

Të mbrojmë Radikën!

- Është koha që të gjithë së bashku të koordinojmë veprimet dhe të mos lejojmë ndryshimin e rrjedhës së ujërave të Radikës.
- Humbja e ujërave të Radikës do të ketë ndikim edhe në lumin e Drinit të Zi dhe për pasojë do ndikojë në uljen e rezervave ujore në kaskadën e Drinit.
- Nëse ndërtohet hidrocentrali i Lukovës, këto janë dy foto se si do ta kemi liqenin e Dibrës. Uji i Korabit me një tunel do të derdhet në Vardar për t'u shfrytëzuar në disa hidrocentrale që do të ndërtohen më vonë në pjesën lindore të Maqedonisë! Edhe Drini i Zi në pjesë e Shqipërisë nuk do të ketë ujin e mjaftueshëm!

Fotot: © Gazmend Kërkuti

Nga **BARDHYL MARKU**

Më datë 25 tetor 2013, në Dibër të Madhe është zhvilluar një takim mes përfaqësuesve të Bankës Botërore, ELEM-it, Ministrisë për Mbrojtje të Ambientit Jetësor dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave të Maqedonisë. Në këtë takim kanë marrë pjesë edhe drejtuesit e qeverisjes lokale në Dibër të Madhe si dhe përfaqësues të shoqatave mjedisore dhe të komunitetit.

Do të më interesonte shumë mendimi i palëve në atë takim, por në pamundësi të këtij informacioni për momentin, dua të shpreh disa mendime.

Në fillim dua të falënderoj palët në takim, sidomos përfaqësuesit e Bankës Botërore, dhe përfaqësuesit e komunitetit të Dibrës së Madhe, të cilët kanë shkëmbyer debate konstruktive në të mirë të mjedisit. Sipas informacioneve që kam, fatmirësisht, përfaqësuesit e Bankës Botërore e kanë pranuar mesazhin e dibranëve, por kjo nuk do të thotë se me kaq angazhimi ynë ka përfunduar.

Duhet të dimë se në fillim të këtij projekti, Dibra nuk ishte paraparë fare për diskutim si njëra nga palët e interesuara ose si njëra nga palët që preket drejtpërsëdrejti negativisht nga ky investim.

Vetë fakti që palët e interesuara po vijnë sërish në Dibër, për të dëgjuar shqetësimin tonë, është një faktor pozitiv. Investitori (ELEM) dhe financuesi kryesor (Banka Botërore) më në fund na kanë identifikuar si pjesë e palëve të interesuara në këtë projekt energjetik.

Por kjo nuk do të thotë gjithçka ka përfunduar. Tani është nevoja më e madhe se kurrë për veprim dhe ngritje të problemit në nivele më të larta.

Do të pasojmë me siguri edhe takime të tjera në përbërje më të ngushtë mes përfaqësuesve të Bankës Botërore, ELEM-it dhe përfaqësuesve të Komunës sonë (nga Komuna dhe organizatat joqeveritare) ku do të ketë mundësi për të shprehë edhe më fuqishëm pasojat katastrofike ekologjike që do kenë për Radikën dhe liqenin e Dibrës kapja e ujërave të Radikës në rrëzën e Korabit.

ÇFARË DUHET TË BËJMË?

Në përpjekjet për të mbrojtur Radikën, ekosistemin e saj dhe në mënyrë të veçantë rajonin e Dibrës, së pari duhet të hartojmë një strategji dhe të punojmë të gjithë së bashku. Në radhë të parë, është e nevojshme që mes organizatave joqeveritare në Dibër dhe komunitetit, të hartohen strategji dhe të ndërtohen koalicione në terren për mbrojtjen e ekosistemit. Për këtë, ndoshta është e nevojshme dhe bashkërendimi dhe ftesa publike për organizatat joqeveritare me qendër në Shkup, pasi mbrojtja e ekosistemit të Radikës nuk është një e mirë e qëndrueshme vetëm për Dibrën, por për gjithë Maqedoninë.

Së dyti, duhet të takohen qytetarët e Dibrës ballë për ballë. Duhet të informohen dibranët dhe miqtë e dibrës ngado që janë, me email, me sms, me mediat sociale, të organizohen takime dhe debate publike, në mënyrë që të thithen argumenta dhe ide për ta mbrojtur Radikën. Sa më shumë argumenta dhe sa më shumë angazhime vullnetare për ta mbrojtur Radikën, aq më shumë do kemi sukses në synimet tona.

Së treti, në këtë përpjekje për të mbrojtur mjedisin dhe Dibrën, duhet që së pari të angazhohen pozitivisht edhe nivelet më të larta partiake të BDI-së, aktualisht në qeverisje, dhe të bëhet presion në Ministrinë e Mbrojtjes së Ambientit Jetësor dhe ndoshta të ndërhyhet drejtpërsëdrejti të Kryeministri. Për ta bërë këtë janë të gjitha kushtet dhe mundësitë. Duke pas parasysh se si po realizohen projektet të tilla, kur konsultimet e ngjashme me palët e interesuar, në fund nuk kanë ndonjë peshë të madhe, mendoj se njëra nga mundësitë e vetme për të anulluar këtë ide është veprimi dhe presioni politik "te koka e kupolës".

Së treti, gjatë kësaj fushate mbrojtje, duhet të jemi të kujdesshëm të përdorim fakte dhe argumente, që e mbrojnë çështjen dhe e mbrojnë Radikën. Duhet të largojmë euforinë, por të jemi dinjitoz dhe të shfrytëzojmë gjitha mundësitë për t'u treguar Bankës Botërore, investitorëve dhe qeverisë rëndësinë jetike që ka gryka e Radikës, për rëndësinë që ka lumi Radika për Dibrën, për biodiversitetin, për botën e gjallë bimore dhe shtazore të liqenit të Dibrës dhe rreth tij etj. Duhet ta shprehim



brengën tonë në mënyrë sa më të mirë të mundshme, gjithmonë duke pas parasysh se vendimmarrësit për financim të këtij projekti, në këtë rast Banka Botërore, nuk e kuptojnë gjuhë tjetër përveç gjuhës së argumenteve dhe gjuhës konstruktive, nuk kuptojnë gjuhën dhe folklorin patriotik, prandaj të përqendrohemi në pasojat ekologjike që bart ky projekt për tërë ekosistemin në Dibër dhe më gjerë. Banka Botërore ka disa kritere të cilat duhet të plotësohen nga një shtet për të marrë kredi, siç është rasti me kredinë për ndërtim të liqenit në Lukovë, dhe ato kushte Maqedonia i plotëson lehtë. Por, përveç kushteve financiare, ka edhe kushte tjera, të cilat Banka Botërore i respekton në mënyrë rigoroze.

Banka Botërore asnjëherë nuk i jep kredi një shteti, në rast se ndërtimi i cili do bëhet përmes ndihmës financiare të Bankës Botërore, ka çfarëdo lloj ndikimi negativ ndaj shoqërisë dhe ekosistemit të saj. Njëri prej tetë kritereve të Bankës Botërore për ti dhënë një vendi kredi është "Ensure Environmental Sustainability", që shqip do të thotë "Të sigurojë qëndrueshmëri të mjedisit". Pikërisht, kjo është pika ku ne duhet të përqëndrohemi: ndërtimi i liqenit të Lukovës jo vetëm nuk siguron qëndrueshmëri të ekosistemit, por përkundrazi ai e dëmton atë në mënyrën më të vrazhdë. Gjithashtu, Radika mban brenda saj bukuri unike, pastërti dhe shumëllojshmëri ngjyrash, vegjetacion bimor dhe shtazor, trofta dhe ngjala të pakrahasueshme dhe shumë e shumë bukuri të tjera. Të gjitha këta, nëse realizohet liqeni ashtu siç është planifikuar - pra duke kapur ujërat të cilat sot e furnizojnë Radikën - do humbin.

Së katërti, ne duhet të bëjmë të qartë se i kuptojmë shumë drejtë nevojën e ndërtimit të hidrocentraleve në këta kohëra kur nevoja për energji elektrike është gjithnjë e më e madhe. Ne e kuptojmë se ky hidrocentral do ndihmojë në zbutjen e kësaj kërkese për energji elektrike. Ne nuk do ishim asnjëherë kundër ndërtimit të tij nëse ai do ndërtohej në atë mënyrë që duke ndërtuar një ekosistem të ri, të mos dëmtohet një ekosistem tjetër, i cili në këtë rast ka vëllim dhe përmasa shumë më të mëdha se ai në Lukovë.

Ne nuk do ishim kundër tij nëse ky hidrocentral nuk do prekte aspak ujërat e lumit Radikë, por do të ndërtohej në bazë të kapjes vetëm të ujërave të cilat gravitojnë në mënyrë natyrore në fushë të Lukovës.

Së pesti, ne duhet t'i bëjmë me dije investitorëve dhe financuesve se ndërtimi i këtij liqeni në Lukovë me idenë e ndryshimit të rrjedhës së ujërave të lumit Radika, duke i çuar ata në liqenin e Lukovës, do bëjë një dëm të pandreqshëm ekologjik për Radikën dhe tërë krahinën e Dibrës, do të ngjall revolta dhe pakënaqësi të thella të jo vetëm dibranëve por edhe më gjerë, ndërsa institucioni i Bankës Botërore do njihet si institucion i cili nxit pakënaqësi përmes investimeve të saj, duke nisur një katastrofë ekologjike.

Së fundi, është e nevojshme që me shoqatat joqeveritare të Dibrës në Shqipëri, të ngremë çështjen edhe te qeveria shqiptare. Rrjedhat natyrore të lumenjve është një e drejtë natyrore që mbrohet nga konventat e Kombeve të Bashkuara, kështu që interesimi i qeverisë shqiptare në këtë proces është krejt legjitim dhe i pritshëm. Humbja e ujërave të Radikës do të ketë ndikim edhe në lumin e Drinit të Zi dhe për pasojë do ndikojë në uljen e rezervave ujore në kaskadën e Drinit.

Mund të ketë shumë zëra që mund të tregohen pesimistë në këtë proces. Por unë po tregoj shkurt një rast të suksesshëm në Malin e Zi. Atje është një kanion i shumë i bukur mbi lumin Tara. Është kanioni më i gjatë në malin e Zi, rreth 82 km. Në fillim të fiteve 2000, qeveria malazeze në bashkëpunim me investitorë boshnjakë, planifikoi ndërtimin e një hidrocentrali. Hidrocentrali do të përmbyste shumë pasuri natyrore përgjatë kanionit, por protestat e shoqërisë civile arritën ta ndalonin ndërtimin e saj në vitin 2005. Sot ky kanion është një pasuri e trashëgimisë botërore të UNESCO-s.

Rruga për të mbrojtur Radikën është e hapur. Sot janë mundësitë të shfrytëzojmë gjitha mundësitë ta mbrojmë atë, sepse kështu mbrojmë jetën tonë!



Mbro Radiken!

Kliko në likun e mëposhtëm në Facebook dhe bëhu pjesë e grupit të qytetarëve për të mbrojtur ekosistemin e Radikës

https://www.facebook.com/groups/radikadheliqeniidibres/?fref=ts

Rruga e Arbërit nr. 90

reportazh

Udhëtim përmes qytetërimesh



Nga **SELMAN MËZIU**

Shehri dhe Troja, dy fjalë me të njëjtin kuptim. E para e ardhur nga fiset Tartare (formuesit e Turqisë) me origjinë, përkundruall Mongolis. Ndërsa e dyta e shkruar së paku nga Homeri, Troja e fiseve pellazge të Dardanëve që kur.... . Të dyja shprehin kuptimin e grumbullimit të fiseve në një hapësirë të caktuar banimi që tanimë në shqipen e sotme quhet Qytet. Zvarrë – zvarrë në hullitë e shekujve udhëtuan kulturat dhe qytetërimet në qelizat trunore njerëzore, të praktikuara në jetën e përditshme, të shkruara në libra, apo të skalitura në gurë e mermerë duke ardhur edhe këtu në mes këtyre maleve të ashpra shkëmbore.

Ky qytetërim u zbulua rastësisht. Nga emri i vendit. Nga një pensionist. Duke punuar dora dorës, dolën në dritë objekte të një vendbanimi para dymijë vjetësh ose..... Një kurriz shkëmbor me copëza vatrash jete njerëzore, që përdornin monedhat, heshtat, veglat për punimin e drurit, gurit, hekurit e bronxit. Një zejtari, plotë fantazi dhe finese, në vatra të ngushta, në troje të shtrenjta, të kursyera nga formimet natyrore, gjeologjiko-fizike të kores së tokës në mijëra e mijëra vjeçarët.

DY KROJE PËR DY FISE

Filluam të zbisnim në një udhëz të hollë. Një pamje e copëzuar relievesh, hapesh e mbyllesh përgjatë sajë. Pak gjelbërim,më pas një bokë, ku shikohen gurë e guraleca të rrumbullakët të cilët lenë në tokë një gjurmë si guaska e një veze. Ndërsa flladi i pasdites na ledhatonte fytyrën e freskonte ajrin përreth nesh. Në ecje e sipër një rrugë automobilistike që fillon të fundi i fushës e shkon deri në shtratin e Setës ujë kthjelltë. Mjaft e përdorur nga makinat e markave të ndryshme. Padyshim të shumta nga kurbetëlinjt që janë të panumërueshëm nga këto anë, dekdisur në hapësirat tokësore të pesë kontinenteve.

Nuk është aty ku bashkohet rruga këmbësore me atë të makinave por disa metra më sipër një gjysmë harku prej çimentoje, ku dalin dy tuba xingate, me ujë të bollshëm, të freskët e të kthjellët si qelibari. I cili përfundon në një vijë të hollë e cila varet poshtë shpatit. Dikur ishin dy copa drurësh të gdhendur prej dushku, arre , thane...që kryenin këtë funksion. Natyrshëm lind pyetja: Po përse janë ndarë në dysh?Sigurisht edhe kjo ka një domethënie, një histori. Banorët e fiseve Cerri, Gjeci, Daci, Tola dhe Kola që banojnë në lagjen e Brethasve e tregojnë në mënyra të ndryshme. Ku asht ujët asht jeta. Aq i domosdoshëm për jetën e qenieve të gjalla. E pikërisht për këtë krojet ujëpijshëm u ndanë në mënyrë të barabartë. Edhe pse rridhnin nga i njëjti vend. Banorët e dy fiseve i ndanë në: Kroi i fisit të Bijse (*Basha, Tola, Cerri)* tjetri: Kroi i fisit të Dujse *(Përgjegji, Daci, Sala*). Sinqeriteti, ndershmëria dhe dashuria për të jetuar u shkrinë në këte veprim si fillesë e organizimit të veprimtarisë njerëzore.

E kështu njerëzit me atë, ujisnin bimët bujqësore, pemët, apo pinin blegtoria, laheshin e pastroheshin veshëmbathjet, shtëpitë etj. Ndërsa tani krahas ujit të dy çezmave përdorin ujët e kanalit të Setës, i cili banë të harlisen e rriten plotë shëndet perimet, drithërat dhe drurët frutor të mollëve, kumbullave, ftonjve, manave, kajsive, rrushëve varietet shumtë, por edhe hurma e fiqtë. Dy të fundit janë mjedisuar më së miri me klimën e në bashkëshoqërim me pemët e këtushme dhe njerëzit që i rritin e konsumojnë frutat e tyre.

Në këtë panoramë plotë hijeshi që shtrihen në këto bregore që rrëshqasin qetë - qetë deri në shtratin e përroit të Setës. Brethasi nga lindja kufizohet nga përroi i Kusarëve kurse nga perëndimi me varret e të tetëve. Gjatë udhëtimit tonë, ne pamë një pjesë toke të zhveshur, ku nga e djathta kalon një hendek i thellë plotësisht i zhveshur nga çfarëdolloj bimësie, përreth ka ndonjë ferrëmane apo dëllinja. Nuk dukej asgjë. Një sipërfaqe e zakonshme, fatkeqësisht e braktisur pa pike respekti e dhimbshurie. Në thellësi të saj kocka njerëzish të braktisur, të harruar, të.....

- Pikërisht në këtë pllam vend, ndodhen tetë martirët e vrarë barbarisht nga serbët gjakatar, njëri asht gjyshi im Halil Gjeci, nana e Haxhi Tërshallës, një grua e një vajze Spatesh dhe..... nuk i di emrat e të tjerëve, – Ai uli kokën, patjetër nga hidhërimi që i pushtoi shpirt e zemër por ashtu me përtesë vazhdoi udhën.

Përafërsisht një shekull, as pushteti popullor përreth dyzetë vjetëve në fshatin Çidhën, as Komuna e saj në demokraci për njëzetë e tre vjetë, po kështu dhe asndonjë mërgimtarë, nuk ka mundur të rregullojë këto varre, apo të ngrejë një shtatore për nder të flijimit të jetës së pafajshme nga mizoritë kanibaleske serbe.

Bashkëshoqëruesi tregon se si u plagos në luftë e sipër me Serbët babagjyshi. E mori Sali Krashi dhe Isuf Harçiku nga ku u plagos dhe ato e çuan në shpellën e Hoxhës (ose e Xhipit), ku ishte strehuar Hoxhë Kuta. Sa e pa të përgjakur nga plumbat gjyshin, Hoxha u shpreh: - Lëreni këtu, se po na erdhën ushtarët e pashpirt serb, të na vrasin e presin të gjithëve sa jemi këtu brenda në këtë zgavër prej masivesh gurësh gëlqeror. Por mjekimet atëherë mbështeteshin tek mjekët popullor. Me sa duket plagët ishin shumë të rënda. E kështu duke vuajtur tmerrësisht nga dhimbjet therëse torturuese, ai mbylli sytë përgjithnjë.

- Edhe gjyshen (*Sulltane Bodini)* ma therën me thika katilët serb pa ndjesi e dhimshuri, ishte duke ruajtur dhente. Në punën e vetë, bareshë e urtë. E gjetën në mes deleve të shtrirë përdhe ku plagët i kullonin gjak ,në një lendinë me gjelbërim, plotë bukuri tërheqëse, Hazis Tërshalla dhe Sali Krashi. Fatkeqësisht edhe ajo pas dy ditësh vuajtjesh të pa konceptueshme, ndërroi jetë. Halilit fytyra i kishte marrë pamje serioze, qerpikët dhe vetullat ishin varur duke zvogëluar pamjen e syve, ndërsa zëri sa fliste dhe po i shqimej. Nuk ka dyshim nga dhimbje që ndiente. Duke rizgjuar kujtimet e dhimbshme, atij natyrisht i ndryshoi gjendje morale e shpirtërore. Krenaria dhe dhimbja ishin përzier natyrshëm brenda shpirtit të tij duke vepruar në kundërshti.

Befas dhe rruga merr një kthesë të fortë, ku shihet një plantacion me pemë të sapo mbjella. Bashkëudhëtari im e kuptoi habinë time prandaj theu heshtjen duke thanun:

-Janë gjashtë dynim tokë e re, të mbjellura me qershi nga vëllezërit Murat, Rushit e Zenel Cerri, në shtratin e këtij viti. Ato vijnë nga Elbasani dhe iu bëjnë shërbimet e duhura agroteknike. Ne çidhnakët nuk i harrojmë trojet tona dhe shtëpiat i mbajmë të hapura gjate periudhës së verës. Mbjellim kopshtijet e mbledhim frutat e pemëve të shumëllojshme.

Ndërsa kjo hapësirë quhet Zabeli i Grubes, kushedi nga e ka fillesën ky emër, ndërsa tani do të quhen: Kshajat e Cerre. Diçka do të ndryshojë në mentalitetet e njerëzve, me transformimin e natyrës edhe emërtimet e vendeve, të gjitha këto përbëjnë në rrokullimën e shekujve historinë e shoqërisë e të natyrës.

Në krahun e majtë ngrihen dy masive gjigande shkëmbinjsh, të cilët bien thikë prej një lartësie mbi dyzetë metra. Në rrëzë tyre, pra aty ku ato puthin tokën e në mes tyre, bujis vrullshëm gjelbërimi i shkurreve e drurëve pyjor po kështu kësula e tyre ka të njëjtën ngjyrë e përbërje, duke të dhuruar një gërshetim të honeve të frikshme e hijerandë të Gjurit të Shqipes dhe Kepit të Arushës,me zbritjen drejt Setës me një dyshesë të amëltë shoqëruar me gjelberim bimesie të bollshme e siguristh tërheqëse e më "miqësore".

Në të djathtë të përroit të Setës, ku ne po i afrohemi urës, vështrojmë një peizazh me shkurre ku mbretërojnë masivet shkëmbore me ndonjë shkurre kurorë gjelbërt, të cilat kontrastojnë me shkëmbijtë e hijtë gëlqeror. Kodra e Fikut e ndjekur nga Guri i Sule një masiv i sertshëm shkembinjësh e ndiqet nga shpate ku ndodhet Grepi iÇene, poshtë të cilit ndodhet Shpella e Hoxhës, ku nga e majta nën atë, dallojmë disa drurë kurorë gjelbërt tamam këtu, rrëzë një masivi shkami, një burim ujëshumtë që gurgullon drejt Setës me shkumën e bardhë freskuese e bukurindjellëse. Ndërsa poshtë shpatit të Muratajës i cili fillon nga kanali Çidhnës drejt Setës plotësisht e zhveshur ku mbaron. Ai ndahet në dysh nga tubacionet e çelikta të cilat sjellin ujin, ku me rënien e lirë venë në lëvizje gjenerator të fuqishëm, që prodhojnë energji elektrike. Banorët e këtyre fshatrave përreth mbajnë mend mirë përurimin e tij në verën e vitit 1969. Kurora e shelgut vajtues thyen monotonin e peizazhit guror dhe të ndërtesës së hidrocentralit duke na dhuruar një pamje tërheqëse me kontrastet e të gjelbërtës me të përhimtën.

KUR FLET QYTETËRIMI

Me këpucët në dorë dhe pantallonat të përveshura, kalojmë ujërat e kthjellëta të Setës, në formë zig-zage prej disa kilometrash. Gurët e rrumbullakët, të latuar përsosmërisht nga rrokullisja e tyre përgjatë shtratit, përbëjnë rrezik për tu rrëzuar edhe çka se frika përzihet natyrshëm me ujët e kthjellët qe i ledhaton ato duke të ngjallur një ndjesi çlodhëse e argëtuese. Udhëtimi ynë, ndoshta iu ngjan kolonizatorëve të bardhë në Afrikën e Jugut për të gjetur copa diamanti. Apo ai ka qëllim tjetër?

Pas katër orësh, matje, fotografime e shënime, në muzeun personal të Halilit në shtëpinë përdhese private të tij i thashë:

- A mund të shkojmë që sot ta shohim qytetin ku keni zbuluar këto objekte arkeologjike?

Ai më hodhi vështrimin nga këmbët në majë të kokës dhe më përgjigjet disi me mosbesim, që i lexohej dukshëm në sytë e tij të vegjël dhe në fytyrën e hequr, paksa të zgjatur:

- Por, Troja asht larg e terreni i vështirë për t'u ngjitur!

- Të premtoi që unë jam gati për të dëshmuar mbi këtë qytet, ndoshta! - i thashë me za të plotë, duke dashur të shprehja vendosmërinë time.

Ndërsa bëja kujdes në hedhjen e çdo hapi dhe përpija peisazhet e frikshme ku përzihesh e gjelbërta e ndonjë shkurreje me të hirtën e hapur të shkëmbinjve në forma të copëzuara plotë relieve të gjithfarë formash, mendoja për qytetin e lashtë tremijë e dyqind vjet para krishtit, në Azine e Vogël mbi relievet e Hizarlikut. Edhe këtë e zbuloi një gjerman i thjeshtë i quajtur Shliman aty nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë.

Ndërkaq mendimet e mia ku unë kisha "humbur" mi theu, arkeologu amator:

- Ja, në mes përroit të Shehrit dhe atij të Setës, a e shikoni një kurriz, i cili përfundon më një masiv shkëmbor gjigand që quhet, Maja e Minares. E gjithë ajo quhet Troja.

Kurrizi fillonte përballë, në krahun e Setës me një prerje vertikale të shkëmbinjve, ndërsa në krahun jugor, ne filluam të ngjitemi përmes një shtegu të hollë që quhesh udha e Trojes, e cila përfundonte tek kalaja e Skënderbeut.

- U ngjitëm në një shesh të vogël jo më shumë se pesëmbëdhjetë metro katror. Këtu ishin gjetur, dy gur mokrre, që natyrisht shërbenin për të bluar drithërat, dy monedha, dy shigjeta dhe kocka të djegura. Përballë, matanë Setës një shpellë, ndoshta e përdorur për strehim ku mundësisht lidhesh me vatrën e parë nëpërmjet një ure prej druri.

Vatrat ishin vendosur në trajta të këmbyera, ashtu siç janë të vendosura gjethet e dushqeve në një biskë njëvjeçar. Shohim me imtësi bimësinë barishtore, shkurrore e ndonjë kafshë të vogël, dhe gurë të hedhur andej këndej, ndonjë fragment muri, bie fjala në vatrën tre. Dhe nuk reshtemi të përpijmë me vështrimin tonë kureshtar këto faqe e majë malesh shkëmbore pse jo edhe Gjalicën me shkamëra dham-dhame e hepe-hepe.

Tanima ndodhemi në vatrën dy, në të cilën janë gjetur tre shigjeta e një monedhë, në thellësinë gjashtë deri shtate centimetra nën dheun e zi e gurëve të bardhe gëlqeror me njolla likenesh. Më sipër majtas boshtit qendror janë gjetur, mbeturina bronxi, copa qeramikash, enësh të ndryshme dhe një spatë duke formuar kështu ndarjen tre.

Njëqind e pesëdhjetë metra nga kurrizi pamë një shpelle, ku Halili më shpjegoi se quhesh *Shpella* e *Trojes,* tridhjetë deri në dyzetë metra thellësi u gjetën një kmes e këputur pothuajse në mes, një sqepar, dhe një thadre, vegël që përdoret për të gdhendur drurin. Vatra e katërt e cila gjendet në të djathtë u gjetën dy shigjeta, një spatë dhe plumba të kohës së turkut. Ndërsa dy spata u gjetën në vatrën e pestë ku kishte formën e një trekëndëshi dhoma në dy anët e rrethuar me blloqe gjurësh ndërsa në pjesën e poshtme duken pjesë muri pa llaq gëlqereje.

Ngjitemi me kujdesin më të madh, se një vendosje pa kujdes e kamës, përfundon në një humnerë që zor se gjëndesh. Në kurriz, në një sipërfaqe katër metra katëror u gjetën një shigjetë e dy thika, kjo sipërfaqe ka numrin gjashtë. Ndërsa në të shtatën u gjetën dy monedha dhe një shigjetë. Kurse në sipërfaqen e fundit u zbuluan thengjijë, një thike e monedhë dhe copa qeramikash ngjyrë të kuqe dhe të hirta, po aty kishin hedhur shtatë dy shkurre të cilat me kurorat e tyre iu banin hije mjedisit gurishtor dhe me pak dhe.

MINARJA APO PALLATI I PRIAMIT

Na duhet me lanë kurrizin e të marrim krahun e djathtë për ti dalë nga sipër këtij masivi gjigand, madhështor e kryelartë, i cili bie vertikalisht, duket si i prerë me një thikë të stërmadhe, me një lartësi më shumë se gjashtëdhjetë metra. Diku në ndonjë zgavër ka gjetur kushte ndonjë bimë shkurrore që gjelbëron, jeton, duke u kënaqur me pak ushqim, por e lirë dhe me hapësirë frymarrje të gjerë, po kështu e pa cenueshme nga kurrfarë gjallese. Ndoshta pushon ndonjë shqiponjë, skifter apo zogjtë e përhimët të malit.

Poema homerike e Iliadës, më mikëlon kujtesën duke përfytyruar në atë kodrinë të Azisë së Vogël, Pallatin kolosal të Priamit, me shtatëdhjetë dhomat e tij, përkundruall me oborin e heronjëve legjendar Hektorit e Paridit si dhe me portën e madhe ku hyri krenar e gjigandë nga pamja kali i drunjtë dinakë dhe shkatrrimtar. Ngjarje e mijëra e mijëra shekujve më parë, nëzemrën e vrullshme të Trojes antike, ku ndodhesh edhe një kështjellë e ndërtuar me gurë të përmasave ciklopike të cilën grekerit e quanin *Ilion.*

Por zbulimi i Halilit, Troja e tijë nuk asht vend kodrinor, tokë e butë me pak guraleca, por plotësisht shkëmbore, ku jetët e gjallesave të ndryshme zhvillohen me zor, me stërmundime të mëdha. Ku mure kalash nuk ka, por ka shkaminj të pa mbarim me kthina, lugineza, gungëza e hepe shumëformeshe, ndërsa vargmali i Qafës së Kalas zbret turrshëm majëmprehtë në shtratine ngushtë të Artatusit të fiseve Peneste. Ato shkëmbinj nuk i vuri njeriu, por natyra në miliona e miloina vjet duke krijuar këto masive bukuri rrallë,mbrojtëse e strehuese të njerëzve në bokërrimat e shekujve dhe që i kanë zili piktorët më të shquar, regjisoret më me za, alpinistët më të sprovuar. Vetëm rapsodët popullor, vajzat e gratë qendismëtare të këtyre trevave mund të hedhin në tezgjahe apo në vargje emocionuese, këto bukuri me pamje gadi - gadi hynjore.

Ngjitja në maje të minares nuk asht e lehtë, por fatmirësisht u realizuar me sukses. Ndërkaq arkeologu amator më tha: – Janë të rralle ato që kanë hypur në këtë minare, ja disa prej tyre, Zenel e Osman Basha dhe Tahir e Riza Cani. Megjithëse une organizoj me rinine pikniqe në këto vise shkëmbore por.....

Me dukesh vetja Zeus në majë të Olimpit, kundroja këto visare me bukuri virgjërore të natyrës, dhe mu kujtua fjala *Kaoni* që Barleti, jetëshkruesi i heroit tonë legjendar Skënderbeut, përmend kur Sulltan Mehmeti i dytë,sulmoi kalane e *Çidhnës.* Duke përpirë me shikimin tim këto panorame kreshpë shumta, këto hone që ngrihen me qindra metra mbi Përroin e Setës njëlloji edhe mbi Shehun e Thatë. Mos vallë Barleti asht konsultuar me ndonje ish luftëtar të heroit dhe i ka thënë : - *Pikërisht atje ku ka hone (* ka-one, kaoni, S.M.) *marramendësebëri masakrën më ogurzezë e më shkatrrimtareushtria turke në verën e vitit njëmijë e katërqind e gjashtëdhejetë e gjashtë.*

Po të shikojm krahun e majtë ku kemi disa shpella të madhësive të ndryshme, bindemi plotësisht se në luftën nantë vjeçare kundër trupave tirane serbe, fëmijët gratë dhe pleqtë e Çidhnes sterhoheshin në këto mjedise shkamore me muaj të tanë. Jetonin si krimbi në gurë, por hanin, visheshin, lindnin fëmijë, friksoheshin, qanin me zemra të cfilitura nga dhimbjet e humbjes se bijëve të tyre luftëtar. Vendbanimi në atë krahë ishte sepse topat me të cilt serbi gjuante, nuk mund ta bombardonte atëkrahe nga maja e Pjese dhe Tërthorja.

Pikërisht atje asht edhe kisha e dom Markut. Dikush thoshte se në atë masiv kryeneqë na qenkan edhe rrënojat e njërës nga kishat më të vjetra në Ballkan. Ndodhen disa mure, por asnjë arkeolog nuk ka shkuar atje të përcaktoi lashtësinë e tyre. Poshtë kësaj minareje, ndodhet edhe një shpellë. Mos vallë kemi të bëjmë së pari me rite fetare pagane e më pas ka ardhur don Marku e ka ngritur kishën ose ika bërë meshat në atë shpellë? Ndoshta, shembuj të tillë nuk mungojnë.

Pikërisht në këtë pllam vend ku mund të soditësh majë malet e vargmalit të Runjës, të Xharxhishtit, majën e Shkurt e të Gjatë dhe rrafshnaltën ku asht vendosur fshati Çidhën në të cilën në anën jug - prendimore duket lugina e thelle e Setës, rrinin rojet e qytetit. Ato edhe gurët ku mbështetnin enët prej balte për të gatuar i merrnin nga shtrati isajë, por shtufor, se ato e dinin që nga nxehtësia, thermoheshin dhe....

Halili gjeti aty për aty një gjysmë unazë hekuri, në një të çarë shkami, në një qoshe ai me duar duke gërmuar nxori thëngij zjarri në pesë centimetra thellësi, sumulla xhamadani, të cilat ato vendoseshin në një numur të madhnë këto,me qëllim që të mbroheshin nga goditjet e fuqishne e vdekjeprurëse të shpatava,topuzeve etj. Pak hapa më tej u gjetën edhe dy copa enësh prej çeramike me disa vrimëza e shirita zbukurimi.

Une u gëzova pa masë nga rezultati i kërkimeve. Ndërsadisa prej tyre i ruaj si xhevahire të rralla dhe si kujtime më të vyera në një vitrinë të bufesë në shtëpinë time në Firence. Pa çka se Shlimani u gëzua më shumë, kur gjeti në shtresën e dytë tetë mijë e shtatëqind sende prej ari, ku me kalimin e kohësia dhuroi muzeut të Berlinit. A mund të hiqen paralele të tilla? Asnjëherë, por ama kërkuesit e arkeologjisë dhe historianët duhet të mbathin opingat, ngarkohen me çanta dhe të zbulojnë dëshmi të rejanë këtë qytet antik mbeshtetur në prehërin e këtyre maleve teje të ashpra. Sa mirë do të ishte! Megjithatë ne të dy robinsonët, shpresojmë se dikush do të kujtohet.

SHPUPURISJE QYTETËRIMESH DHE HERONJSH.

Kënaqësinë e këtijë mëngjezi Gushti eshijova duke ngranë leshnek, një ëmbëlsirë origjinale e këtyre nahive, e pregatitur me kulloshtër, miell e sheqer. Më shijoji shumë,e ndërkohe rrezet e diellit depërtojnë në kurorat plot fruta e gjelbërim në oborrin e gurëskalitësit Murat Krrashit. Ai kujton me hollësi kur shoqëroi nëpër fshat shkrimtarin dhe studiuesin Dhimitër Shuteriqin në Tetor të vitit 1969 dhe në gusht 1976. Duart e tija skalitnin, shqiponja e shkronja, toknin daltat, sopatat, kmesat, bënin patkonj e thuma, të gjitha këto në kudhrën e tijë punoheshin dhe skuqeshin me eshkën në farkën e ndërtuar vetë. Ndërsa ujit ua jepte të fortëpër tua bërë tehun të pathyeshëm e prerës si brisku.

Jeta e banorëve në Rrafshen e Çidhnës ka qenë e kollonisur kështu në dhjetëvjeçarë duke punuar, prodhuar, ndërtuar, në tokën e tyre që prodhon gjithëçka mjafton të jeshë një bujk i mirë dhei papërtuar. Gjithashtu edhe për të ndërtuar me një art e arkitekturë origjinale,bie fjala me qoshet e marra në Faqëza, duhet të jesh murator e gurëskalitës i pasionuar. E këto,të lidhura me gëlqeren e prodhuar nga zjarri druvrëve të pyjeve përrreth. Madhështia trupore, forca e njerëzve pse jo edhe zgjuarsia e tyre ashtë e natyrshme e qënësishme në të gjitha kohërat, veçse tanima i kam fare pranë.

-Përroi që kavërshuar sivjet më shumë se kurrë, ka zbuluar muret e një kishe, hajdeni të shkojmë, - na ftoi këtë mëngjez shkrimtari çidhnak Dali Tërshalla. Në një informacion të shekullit gjashtëmbëdhjetë lexojmë se në Çidhën ndodheshin dy kisha, Shën Mëria dhe Shën Demetri. Por ku ndodhen si pozicion gjeografik ato? Akoma nuk dihet asgjë, por.....

Një grup i përbëre nga Selim Daci, Halil Gjeçi, Zyber eFiqiri Krashi u vumëpër udhë. Është e gjërë ajo,ndërsa anash e kufizuar nga gjerdhe dhe kurora pemësh që e hiezojnë atë. Në bregun e përroit të Shehit shikohen mirë fragmente muri me gëlqere, copra tjegullash të trasha, e kocka me madhësi të ndryshme,të cilat i fotografuam dhe i matëm. Mbi sipërfaqen e tempullit të fesë para disa vitesh ishte një mulli korenti, ndërsa tani zhurmon njëkombinat i vogël druri, në po të njëjtën ndërtesë. Disa metra me tej dy gurë të mëdhenj mulliri, të braktisur, mënjanuar e rrethuar me barëra, por dëshmi e një pune mjeshtërore ushtruar mbi ato.

Vështroi panoramën përreth, për të mbledhur ndonjë dëshmi historike, apo për një rrugëzgjidhje të pyetjes së mëparshme. Duke u kthyer me fytyrë nga kodra, në të djathtë shtrihet Livadhi i Kishës, përballë një sipërfaqe e konsiderueshme me varreza që çuditërisht ka mbetur një kollonë guri diku në mes, me një pjesë të rrumbullakët me disa onde në krye ndërsa në pjesën e brëndshme disa gdhendje të shperndara të cilat duken si tëpakuptueshme. Sfera e kollonës i ngjanë një çallme sulltanësh.



Ndërkohë degjova:

- Pikërisht tek ky gurë varri na, - thotë Selimi- asht kufini ndarës midis varrezave myslimane dhe atyre krishtere. Pranë e pranë njerëzit e të njëjtit qytetë apo fshat por që kanë një vijë imagjinare ndarëse nga besimi mbi krishtin dhe Muhametin. Mesazh i mijëvjeçarëve i dashurisë njerëzore, i vllazërimit. Në cilin, fshat, krahinë, qytet, shtet mund ta gjejmë të shprehur vallë në këtë mënyrë? Aty këtu dallojmë ndonjë lis kurorë gjërë ndërsa ngjitet një shpat i amël me shumë fierëra e shtresa bari të tharë, kështu arrijmë në kodrën e Kishës. Të gjitha këto ishin mbi rrugën automobilistike e cila ka ndjekur udhën këmbësore të qyteit antik të Çidhnës.

Poshtë saj përsëri varre të krishterve e më tej,na kap syri një copë pylli thanash, qe na thone se janë shekullore, ku kurorat dhe trungjet,dëshmojne këtë mendim. Pasi lemë të gjelbërten e zbehtë me kuqëlimin e thanave të pjekura, çfaqen kurorat e larta të verrijve me të gjelbertën e thellë, poshtë tyre duken burime uji dhe toka e lagur nga ai por e jeshiluar nga bari. Ndërkaq veshët na përpijnë këto fjalë:

-Në këtë vend hidheshin gjithë mbeturinat e kishës, të varrezave, ishte kjo arsyeja që drurët nuk priteshin kurrën e kurrës dhe quheshin të shejtë edhe pse vendi quhesh:*Varret e këçinj*, - na thotë më i moshuari shoqerues, Zyberi.

Ndërsa ndjejmë flladin mëngjezor në fytyra, sytë i ''kullotim ,,në arat e misrit me të gjelbërten e thellë, me kopshtijet në të cilat hedhin shtatë, domatet me kokrrat e kuqe që iu ndrit akoma vesa, kastravecat sa një kofshë kame të ngjitur në rrufangën më se dy metra, specat të fryra me ngyrim të gjelbërt e aty këtu paksa të skuqura. Mrekullia e natyrës asht ngjizur me punën mjeshtërore te dashuruesve të punëve bujqësore të njerëzve të fiseve, Tershalle, Hoxhe, Krrashi, Cani, Tola, Basha, Koka, Mena, Përgjegji, Daci, Sala etj. Por e papritura që na ngjalli habi, kur pamë një arë në formë trekëndëshi të mbjellë me sherebelë të shëndetshme, e vendosur në rrjeshta me distaanca të barabarta. Dikur e mbledhur në shpatet e maleve të Runjave, te Kumbullës të Faqëzës ku njerëzit humbnin gjithë ditën për të mbledhur një kilogram nga kjo.

- Ndërsa tani e kemi mbjellë në arat tona pranë shtëpive, - na thote Fiqiriu- ku i bëjmë shërbime agroteknike, si grurit, elbit, misrit, perimeve duke vegjetuar karshi – karshi.

Të zgjon kureshtjen urbanistika e ish këtijë qyteti, rrugët në formë çelsi mbahen mend deri vonë me gjërsi katër metra e të shtruara të gjitha me kalldrame, fragmentet e të cilave duken gjetiu. Fillonte te Kodra e Bitrit ne fund të fushës e vinte tek Mani i Sefer Krashit vazhdonte përmes shtëpive të Krashe e përfundon Bizë, nga shkon udha për Gurë Lurë, e tjetra në drejtim të Xhamise i fundit degëzim të çonte në breg ku shikohet lagjia e Brethasve. Nyja e saj ishte tek ai man që edhe sot duken fillimet e këtyre rrugëve.

Nuk mungojnë debatet mbi shumë ngjarje dhe personazhe historike, të cilat padituria na i ka fshehur dhunshëm nën gëzofin e saj. Ndërsa jemi tek thana e Hysen Kolës. Këtu na tregojnë për tre gur të zinj, të vendosur në formë trekandëshi, me largësi dhjetë metra. Ishte ky vend ku ndaleshin kuajt e pushonin. Brinjët e trekandëshit për çudi quheshin breza.

Nuk vonojm, dhe ndodhemi tek toponimi i kishëssë madhe. Na tregojnë për Lurthin, ku emri lidhet me një legjendë se çidhnakët na paskan vumun ujqërit në kular për të lëruar tokën. Ose tjetër mendim asht se këtu kur ishte pyll lisi humbën një penë qe. Duke e lidhur me emrin e tyre Murri, Luri. Më tej kemi toponimin *Shumurtaje,* fillesa e thirrjes se tijë lidhet me një festë të krishterëve, shume larg nga kohët tona. Kemi vendin e quajtur *Meja* e *Priftit,* sipas gojëdhanve këtu na paska banuar prifti i kishës së Fundit të fushës ose në tokën me pronar Shaban Xheçin. Edhe pse ka munguar arsimimi, populli në një menyrë ose në një tjetër ka ruajtur brenda në ''kopshtin e begatë,, të memorjes së tijë, copëra të historisë dhe të institucioneve që i kanë shërbyer atijë. Çfarë mrekullie!

Kishim lexuar, dhe dëgjuar për Jovan Nokën, por edhe për Jovan Novian e së fundi për Jovan Tërshallën. Edhe në varrezat e krishtera dikush kërkonte të gjente varrin e J.Tershallës.

Dikush thoshte se J.Novia kishte ardhur nga Shkupi si gjeneral i një ushtrie per të ndihmuar Çidhnakët në luftën kundër Turqëve. Varri asht në dalje të Lugjut të Shkallës kur vijmë nga Arrasi. Kur asht hapur në fillim janë gjetur tre rrasa shumë të mëdha,Në krahë te majtë, kishte një fëmijë të vogël. Ka qene i ndërtua me qoshe të gdhendura. Kalimtarët kur shkonin në pazar ose në punë ndër ara, lidhnin një pe për t'iu sjellë mbarësi. Pranë tijë deri vonë ka patur hedhun shtat një lis gjigandë. Pranë tijë ka qenë, një ndër kishat më të medhaja të krahinës, muret e vjetra dukeshin deri në vitin njëmijë e nandëqind e gjashtëdhjetë e tetë. Përrreth sajë ka patur shumë varre. Ndërsa në këtë luginë, dymijë e katërqind vjet ma pare ka qenë shtrire qyteti i OENËS. Kepi i qyteti kapatur funksionin si tek minaria e Trojës. Çfarë ngjajshmërie admiruese! Sa kuptimplotë janë këto fakte që kur vihen përballë njëra tjetrës, iu ngjajnë, prozhektorëve të diturisë, të historisë njerëzore.

Porta e qyteti ka qenë aty ku zbrisnin shkallët e gurta, të cilat deri para vitit 1968 kanë funksionuar. Në këmbët e këtijëmasivi shkamor ka qenë Kalaja e Oenes ku Perseu, mbreti i maqedonasve e sulmoi (në vitin 169, para krishtit), duke bërë një betejë të përgjakshme, shkatërruese, dhe e pushtoi, duke marre si skllever mijëra luftëtarë e banorë të qytetit.

Ndërsa Halili, arkeologu amator ka gjetur një shpat me kllëfin e saj të ndryshkur e grryer prej tijë, dhe gurin mprefës, monedha të ndryshme, nje unazë argjendi dhe tjetra unazë vula me shtatë rrathë brenda që përfaqësojnë numurin e deshmitarëve në një gjyq. Kërkoi që këtyre peisazheve t'iu jap ngjyrimet historike, por Rexhep Ndreka mi ka shkatërruar ato, edhe pusin e qyteit e mbuloi edhe varret e stërlashta i beri lesh e li. Ishte shteti i atëhershëm qe bëri kredin. Ndërsa Haki Përnezha, Doktor Islam Cani e të tjerë shkrues të historisë, duan ti ringjallin duke i hedhur me penë në letër të bardhë. Sa punë të shkëlqyer kanë berë! Sa vlera të pallogaritshme, historike, turistike, do të marrin panoramat e përthyera të këtyre maleve, luginave, shkëmbinjëve, lëndinava kurrizeve e shpateve të gjelbërta nga bimësia!

NGA RESNA TEK TROJA E SINËS

Një të papritur të kandshme ma bëri Selimi. Trupi i tijë është i mbushur, me ca shpatulla të gjëra e pak thinja tek flokët. Njohësi më serioz dhe më i saktë i historirave e toponomistikës të këtyre fshatrave.

-Hajdeni të uleni në bahqen time para se të marrësh këtë udhëtimtë veshtirë e të largët, - na tha, dhe na hoqipara duke na buzëqeshur.

Pasi u ulëm dhe u pyetëm, shikoi të vijë vajza e tijë me një tasë prej bote, zgjata kokën nga kureshtja për të parë se çfarë kishte aty. Mora me majë të lugës mjalt dhe e afrova pranë gojës. Ndjeva aromën e luleve të këtyre anëve. Tërheqëse ishte ngjyra dhe shkelqimi i sajë. Nuk prita dhe e shijova me kënaqësi të madhe.

- Pas afro gjysmëshekulli po shijoja atëlloji mjalte të mrekullueshme që haja, tek qypi i mjaltit, tek dajat e mi, - thashë me një za të gëzueshëm e nostalgjik një kohesisht.

Vërtet këto njerëz bujar, më përcollën me zemrën në dorë, të pastër e të shëndetshme, me bujarinë e sofrave plotë e përplotë, me fjalën e amël si ky mjalti dhe kulturën e të sjellurit. Tani s'kam ma kohë se dua të ndjek udhën e pazarit të para njëqindë vjetëve. Fillon me Rrafshen e Çidhnës, zbret në Përroin e Setes, kemi ngjitjen për në Sinën e Epërme, Përsëri zbritje drejt Sinës së Poshtmja dhe Vajmdhej, më pas kalon pergjatë Fushë Muhurrit kalon në drejtim të Luznis ku më pas vjen Ura e Spiles kështu kaluamtek Shehu i Dibrës dhe përfundon tek Pazari i Shkupit. Padyshim nuk do ta shkel gjithë këtë udhë, por diçka nga kalonin karvanet e kuajve me fshatarët që i ndiqnin pas për të shitur prodhimet e tyre blegtorale, bujqësore e artizanale për të jetuar sa më mirë në gjokset e këtyre maleve kryelartë, sa bujarë aq edhe të egër.

I vetëm me makinën fotografike dhe çantën me blloqet e shënimeve, lë pas burimin e Saponekës që nxjerr edhe pesëqind litra në sekond e më pas burimin e Resnës. Mëkujtohet edhe mua me ujin e tijë fuksiononte nje mulli uji për të bluar edhe njëValevec. Copra e hollë e thurur në rasbujë me lesh deleje ose dhije, shkelesh dy tre fije sëbashku me trupat që viheshin në levizje nga forca e ujit. Kështu formohesh, qeshna ose shajaku, shprehuni si të doni. Me anën e sëcilës, terziu priste e qepte tirqit, kajuket, xhupat, xhamadanët etj. Ndërsa tani ato kanë mbetur në hojet e kujtesës, si diçka në mes ireales e reales, në mes kujtimve të vyera e pshtirosjes së rinisë së sotme që vishet me coprat e fabrikuara të Firences, Venecies, Lyonit, Bonit, Ankaras, Izmirit, Shangait etj.

Ndërsa befasohem në ngjitje e sipër përmes pyjeve të shkozës frashërit, dushqeve duke mbetur i shushatur nga lisat shumë shekullor të malit te Butuermit, një kurorëe vërtet bukurie magjepse. Sakaq ndodhem në Kodrën e Bitrit që duket një sipërfaqe një hektarëshe me livadhe që jeshilojnë ose ara të punuara por edhe disa lopë e kuaj që kullotnin qetësisht. Sakaq veshtrimi më rroku Kulmatrajsin e mbuluar me shkurret e shkozave.

Kur kaloi mbi kanal dhe hedh vështrimin poshtë, shikoi një luginë e cila kufizohet nga shpati i Shkozës së Keqe dhe shpati kodrës së Bitrit, numuroi dhjetra shtëpi të pa banueshme, të pa çati, gjysëm të shembura. Fshati Resën, përbëhesh nga këto familje të fisit Krrash, të Rushitit, Hanit, Xhilit, Danit, Sadikut, Islamit, Jasharit, Veselit, Halimit, Veliut, Faikut ndërsa dy familjet e para që populluan këtë luginë pjellore e mjaft prodhuese ishin Fali Ramadani dhe Ramadan Faliu.

Edhe pse i braktisur njëzetë e një vjetë më parë, me shëmbëllejnë me shkatërrimet barbare që grekërit i shkaktuan Trojës së stërlashtë që më vonë u boshatis nga qytetarët e vet, apo të Aleksandrisë, të tërmetit të Raguzës (viti, 1693) apo të Durrësit (viti 314 pas krishtit) shume shekuj të shkuar të rrënuar pothuajse plotësisht. Në një mënyrë apo në një tjetër historitë e bashkësive njerëzore dhe të vendbanimeve të tyre përsëriten. Kështu ka ndodhur edhedo të ndodh gjithënjë.

Pasi kaloi me anë të një ure kanalin që e merr ujin nga Seta me anën e të cilit ujiten dhjetra hektare të Sinës së Epër dhe të asaj të poshtme i cili u jep gjallëri e prodhime të bollshme bujqësore. Ndalem për pak minuta në Kodër Çerse dhe në atë të Kusare për të kundruar peisazhet bukuri ndjellëse të një pjese të krahinës së Çidhnës duke ndjerë kënaqesi e krenari njëherësh.

Zbres një udhe të holl kamsore në fshatin Sinë e Epër ku freskohem e pijë ujë në çezmën në qendër të sajë. Marrë rrugën e maqinave dhe takoi përroin e Vok Setës, kthehem majtas, edhe njëhere majtas ku ndeshi një kabinë elektrike me tulla të kuqe gjysëm të shkatërruar, qendrën shëndetësore, një dyqan dhe nën kuroren e një shelgu një burim uji të ftohtë që vapa e nxehtë më detyroi ta shijoi.

Ngjitem një udhe të hollë kamsore dhe arrijë në majë të një kodre që quhet *Kopo bredh(ose Kopodherdhi? Ose Kunji i Senës).* Ajo i ngjanë një filxhani kafeje në mes të tabakut të tyre. Nga ky vend me shpate të veshura me dushqe, thana, arra, shkoza e frashëra etj, kam nën vete gropën e Sinës së Epërme, lagjen Pashnjane, Trojet e Mëzeze, dhe lagjen Loke duke u ngjitur edhe më shumë, në horizont mezi duken disa shtëpia të fisit Doke të cilat quhen Palpus.

Do të ishte një gjetje dobiprurëse, e përkryer nga ana e fushë pamjes, të ndërtohesh një restorant, kafene, apo hotel që njerëzit të hanin, pinin, pushonin me kënaqësi duke rajvizuar me shikimin e tyre peisazhe të gjelbërta, me përthyerje, luginash, shpatesh, përrenjesh, kodrash me kurrize gjithëfarë përdredhjesh e formash në këtë kodër të rrumbullakët me pamje piktoreske përreth sajë.

Misioni im sa ka filluar në këtë trevë me qytetërime të lashta e heronj legjendar, prandaj më duhet të kaloi *Ara* e *Kusajas* e ti bie përfundi shpatit të paanë të Valit të Sinës. Pergjatë rrugës herë herë më shoqërojnë shkurret e gjelbërta, herë herë një tokë e xhveshur gurishtore, ku duken lloje të ndryshme barërash, tanima të thara nga vapa e Gushtit.

Sakaq ndodhem te Lama Gavril i shoqëruar nga shtatedhjete vjeçari Rustem Idrizi, i cili më thotë se siperfaqe të tilla të quajtura Lame janë të shumta. Pas disa hapash shikoi një masiv të madh shkëmbor, i cili na u quajtka Gjuri Grepas. Këtu del një burim uji, me emërin Gjurra e Mëzeze, ku dikur ziheshin kazanat e qumeshti, e prodhoheshin djathra të ndryshme e të tjera bulmetra.

Më ngacmoi mendimin kureshtja prandaj pyeta Rustemin:

-Nga ku merresh gjithë ky qumësht?

Ai nuk vonoi dhe më shpejgoi qetësisht:

-Pesëqind deri njëmije ftuja, dhi plleja, veronin në hapsirat e gjana te Pllaut, dhe nga maja e Gjurit me lugje teneqeje, druri apo... vinte qumështi e këtu përpunohesh, - Ai mori frymë thellë, por nuk e di përse mua mu dukse ai fshihte shumë e shumë gjëra.

Më tej shtrihesh Lajthishtja, ku binin në sy madhështia e shpeshtësia e këtijë pylli. Pranë ishte një masiv shkëmbor ku ndodhesh, Shpella e Ashes.

–Këtu kanë patur banuar edhe njerëz, - me thotë plaku i cili kishte një trup te hollë me pak rrudha në ballin e tijë e me dy sy të zesë, mjaft të lëvisshëm.

Poshtë gjurrës shtriheshin vendet e quajtura, Pazari dhe Dyqanet. Ishin siperfaqe të rrafshta, por nuk pamë shenja ndërtimesh, veçse disa fragmente kalldramesh. Duke iu afruar përroit të Mëzeze, kemi vendin e quajtur Balladrem dhe djathtas Zabeli i Kumbullës, ku ne nuk pamë asnjë të tillë por vetëm pyll dushqesh.

Duke lëvizur drejt lagjes Pashnjane shtrihen Zabelet e Shqute ku kalon Përroi Gram, me një burim në krye me të njëjtin emër, në të cilin sipas shoqëruesit kanë qenë disa lugje dru lisi, deri në tremetra, ku blegtoria pinin uji. A duhet të ketë ndonjë lidhje ky emër me bjeshkët, apo livadhet e Gramës? Më shkrepi vetëvetiu kjo pyetje. Ku ta dimë këtë, përderisa nuk kemi ndonjë studim historiko - gjeografik.

Ngjitemi përpjetë ku shtrihet vendi i quajtur Popteshja. E cila ka patur përfshirë në gjirin e vetë, një kovaçhane, rezidencën e qeverisë, dhe nje kishë që kuptohet shërbente Popi ose e thamun ndryshe prifti. Në ecje e sipër, vumë re pjesë kalldrami, me gurët e marra ne këto shpate që fatmirësisht nuk mungojnë.

Diku më tej na treguan për një pjesë toke që quhesh Granja. Ndoshta ka qenë pronë e fisit me të njëjtin emër i cili asht i përhapur jo rrallë tek arbëreshët e Italise jugore.

Ndërsa hapsira edhe pse shpat me pjerrësi të vogël, ndodhen disa taraca një ose dy dynymshe që të gjitha këto përbëjnështatë hektar tokë, dhe quhen Trojet e Mëzeze. Duken anash mure të thata, me gurë të madhësive të ndryshme. Vallë mos edhe këtu kemi të bëjmë me një Trojë tjetër? Ndërsa diku aty afër kemi një thanë me kurorë të madhe e trung trashë që quhet Thana e Skënderbeut. Kur, si e qysh ka qenë organizuar ky qytet në këto territore të mbështetura në shpatullat e vargmalit të Runjës? Përball vjen vargmali me majën e Çakreshtit e vazhdon me majën e Marthit e vazhdon ngjitjen me Tallajën, të veshura me pyje të pafundme dushqesh si dhe me relieve te ndryshme.

VARGËZIM QYTETËRIMESH

Në ecje e sipër kaluam shpatinën e rrasës të Vok Setës, dhe papritur bashkëudhëtari me tregoi se këtu në skrapatën e rrugës automobilistike që të çon në Sinë të Epër, duken fragmentet e një muri gëlqeror. Pikërisht këtu ka qene një kishë, për katundin e Vjetër. Ndodhet jo më shume se njëqind metra,më para se të arrijmë tek shtëpia e tijë. Në shpatin e malit duket një njollë me lisa trupe larte e kurorë gjërë. Kuptohet keto janë të shejtë e nuk venë sopatën njeri. Se me qenë kishin.....

Në shtëpinë e Rustemit, varun në një gozhdë, një pushkë gjermane me kollanin e fishekëve. Asht kjo trashgimia më e vyer e trimërisë e vetëmbrojtjes, në gjithë zinxhirin e shekujve, e rrënjosur thellë në ndërgjegjen e shqiptarit e ngjizur përjetësisht me jetën e tijë. Pasi pimë kafenë e pritjes dhe hangrëm drekën e bollshme, Hazizi më thotë në dalje e sipër:

-Të lutem bani një fotografi brirëve të dashit mbi shqemën e derës.

Një pamje e habitshme që më emocionoi pa kufi. Brirëtishin shkëputur me një pjesë të kafkës kishin dy përdredhje në formë spiraleje. Ato përfundojn me një majë të hollë shpuese. Këto vihen si shenjë e mbarësisë për rritjen e kafshëve shtëpiake. Mjaft tërheqëse kjo pamje, e veçantë, kureshtëndjellëse e të zgjonte emocione.

Një djalosh, energjik me trup të shkurtër, me sy që shëndrisnin e lëviznin shpejt e lirshëm, fliste shpejt, por i kuptoheshin të gjitha toponimet e Sinjës, i mbante mend më së miri ky ishte Hazis Kaloshi. Prandaj u ngjitëm në kodrën me emrin Maja e Gjurthit me lartësi pesëqind e gjashtëdhjetë metra. Nga këtu nuk asht e vështirë të rrokësh me vështrim, peisazhe e pafundme me coptime formash por më të buta, më të kandshme, si edhe shumë domethanësenë relievet historike.

Në perëndim, përgjatë shtratit të përroit të Mëzeze, ngrihet me shpate, me relieve paksa të dallueshme, kodra e Breksave. Një trung koni me gjelbërim dushqesh të degraduara, ndërsa përball lagjes së Pashnjanëve me brezare, kanë mbetur aty këtu disa drurë frutor, si molla e kumbulla. Fatkeqësisht të braktisura e që duken si të egra.

Hidhemi në shpatet e malit të Çersës, të cilat relievi ndjek tekat e tokëformimit me valëzime, veshur me dushqe, dhe duket se i rrin hijerande Sinës së Poshtme. Pikërisht rraze tijëashtë ndërtuar në vitin 1986 Muzeu i Skënderbeut. Shembëllen me një kala të vockël.

Ndërsa në rrafshën e saj ka lulëzuar qyteti i Gjon Kastriotit, Sinja, me mjediset e saja qeveritare, administrative tregtare e prodhuese. Mbahet mend deri vonë një sipërfaqe e rrethuar me unazë dheu deri në një metër naltësi. E cila shërbente për kuvende dhe për tu argëtuar me lojra të ndryshme popullore.

Kodra e Çardakut, me dy luginat që zbresin drejt shtratit të thellë të përroit të Mëzeze. Lugu i Kovaçit dhe i Priftit, dhe prane tijë meja e Gjurthit. Sipas tregimeve, më të moshuarve këtu ishte një ndërtesë disa katshe, me çardake ku komanda turke shikonte çdo lëvizje të banorëve apo ushtrive kundërshtare në drejtime të ndryshme.

Jo më shumë se njëqind apo njëqind e pesëdhjetë metra, ka qenë një kishë e madhe. Ku sipas Shefki Priftit gjatë punimit me traktor u gjetën kockat e një njeriu të madh, mbuluar me një rrasë me përmasa katër metra per dy metra gjerësi, dhe mure me gurë shumë të mëdhenj. Tanima mbi to rriten dhjetra drure frutore mollash kumbullash, dhe jeshilon jonxha. Dëshmitë e historisë prehen në botën tjetër. Ç'mrekulli shqipetare!

Në lindje, shtrihet një luginë e gjërë që quhet Vneshta, por e gjithe hapsira toksore e xhveshur thirret: Epshaku përfund sajë ngrihesh një kishë, muret e të cilës i mban mend edhe Rustem Drizi. Ndërsa poshte mejes ku ngrihesh ajo shtrihen arët e Gjegje. Duke vazhduar më poshtë, vështrojmë fushën e Topojanit dhe një pllajë që emërtohet, Renci i cili, ka qenë pyll dushku me një liqe në mes, tanima e xhveshur plotësisht, me ndonjë cope tokë ku jeshilon misri.

Përballë ngjitet shpati prendimor i malit të Sukes, ku diku në majë ka qenë një kishë tjetër. Në një rrafshine në forme eliptike shtrihet Kllezi i Eper ku ka burim uji, në krahun e majtë shtrihet ne formë gjuhëze, Kllezi i Poshtëm në të dy ka qenë ngritur një qytet, muret e te cilave mbahen mend nga ma të moshuarit. Aty viheshin Stanet verës, me tufat edhive e deleve. Vathimi i tyre, kryhesh me këto gurë.

Në krahun e Tallajës së Sinës, pikërisht rrazë tijë, shtrihet lagjia e Zoke, Gjegje dhe Kadrie, pranë tyre ndodhet një sipërfaqe, që quhet Troja, ku dikur ngrihesh Kisha e Çimdhejt. Duke ndjekur përroin deri pas shtëpive të braktisura të Matrice të cilët në shekullin e katërmbedhjete e pesëmbëdhjetë kanë qenë familje e madhe dhe mbeshtetës e Kastriotëve, çuditërisht ndryshon emrin dhe quhet perroi i Shehit. Mos vallë, diku këtu pranë kemi rrënojat e një qyteti që koha na e ka fshehur ose zhdukur me baticat e zbaticat e saja?

Mbi fshatin Grishqan të zhdukur pas vitit 1467 shtrihet një sipër- faqe dy tre dynym tokë që quhet Troja. Edhe kjo e zhveshur, por para disa vitesh kanë hedhur shtatë disa dardha te egra, plotë shëndet e tregojnë shenja e jete. Në të djathtë ndodhet toponimi Hambarët e Skënderbeut.

Kërkoi me ndihmën e shoqëruesve te mijë, me anë të bisedave të kryera në vite me bamorë të moshuar të këtyre trevave, me librat e lexuara, hartat topografike të grumbulluara në vite, të vendos shenja dalluese, kufinj të dukshëm në mes të kalurës së largët dhe të atyre që shikoi e ndjejë në këto çaste këtu në kodrën e Gjurthit e cila në fund të formës së sajë të stërgjatur, gjënden shkëmbinj shumë të mëdhenj të shpërndarë, por.....

* * *

Nuk kisha ndërmend të rindërtoi për herë të fundit, Trojën Homeriane, siç veproi Perandor Agusti i Romës së lashtë për herë të fundit, këtu në mes maleshhijerandë, fole shqiponjash e qytetërimesh, por të shkruaj se arkeologu amator Halil Gjeçi ka zbuluar një monedhë romake me figurën e Augustit perandor, pikerisht këtu.

Ja pra ka një lidhje historike, ndoshta qytetërimesh, fisesh, veprimtarishe tregetare, prodhuese, politikash etj. Ka vazhdimësi, në punimin e hekurit, të gurit, të prodhimeve bujqësore blegtorale, të veshëmbathjes etj. Jeta njerëzore një shtatore, gjigande me themele në zemrën e shkujve, e cila ka pompuar, trashëgimi qytetërimesh në kohëra.

Në gjerdanin e shekujve, sejcili, popull, komb, fisë apo grupim i tillë, e individ kanë shkrirë dituritë, eksperiencën e trashgueme, forcën fizike për te lanë gjurmë të pashlyera në kohëra e hapsira të ndryshme. Por çfarë e don kur fatkeqësisht padituria, të pa shkruarit, të pa dokumentuarit, të qeverisurit djallëzor e shtazarak, pushtuesit e shumtë shkatrrimtare, na i kanë mbuluar me shtresa të pa rrëmueshme, të padukshme, të pa deshifrueshme.

Firence 09.09. 2013

Rruga e Arbërit nr. 90

Në jubileun e Maturës
së vitit 1958

nostalgji

55 vjet më vonë pedagogjikasit bëjnë apelin...

Nga **SULEJMAN TOMÇINI**



Nuk e di nëse është mbledhur ndonjë maturë pas 55 vjetësh, sepse është një kohë goxha e gjatë, por kjo ndodhi me ne maturantët e vitit 1958 të Shkollës Pedagogjike "8 Nëntori" të Peshkopisë, më 21 shtator të këtij viti në Peshkopi. Në fakt një takim të tillë patëm bërë edhe me rastin e 50-vjetorit të maturës, por në Tiranë, ku edhe pjesëmarrja qe më e vogël, për shkak të pamundësisë për të ardhur të disave prej nesh. Kështu që e vendosëm ta bënim në Peshkopi, aty ku kaluam 4 vitet më të bukura të moshës dhe ku u përgatitëm për punën dhe jetën me një përkushtim të jashtëzakonshëm. Pa frikë mund ta quajmë një kohë heroike jo vetëm për ne por edhe për mbarë vendin, që e jetuam me dinjitet.

I bindur në nevojën e aresimimit te njerëzve e sidomos të brezit të ri, të parën vepër që ndërtoi në Peshkopi pushteti i asaj kohe ishte Shkolla e mesme Pedagogjike "8 Nëntori", që u hap në vitin e largët të 1948-s, vetëm katër vite pas çlirimit të vendit nga pushtuesit nazi-fashistë. Aty u grumbulluan me bursën e shtetit me dhjetra djem e vajza te Peshkopisë dhe të rretheve verilindore të vendit. Mësuesit e parë erdhën nga qytete të ndryshme si nga Elbasani, Shkodra, Tirana etj. Pak më vonë dolën kuadrot vendase nga ish pedagogjikasit si Shemsi Manjani, Ismail Erebara, Sabri Vranici e më vonë edhe shumë të tjerë, derisa të "importuarit" filluan të numëroheshin me gishta.

Kishte shumë vështirësi. Nëpër male ende bridhnin bandat diversante. Mungonte buka dhe gjërat më elementare të jetesës. Mungonin librat dhe mjetet e tjera mësimore. Kjo reflektohej edhe në kushtet e jetesës në konvikt. Ne fillim bukë misri dhe dyshekë e nënkrese prej kashte. Por me vonë kushtet filluan të permirësoheshin. U kalua tek buka e grunjtë dhe qumeshti, pastaj edhe tek embëlsira ditët e djela. Pothuajse çdo vit, por me pikatore, na shpërndaheshin veshje si kostume, pallto e kepucë. Me një fjalë, me forcimin e ekonomisë në përgjithësi, përmirësoheshin edhe kushtet tona të jetesës. U shtuan botimet dhe laboratioret, bile u suall edhe një kontigjent violinash e mandolinash që i dhanë mundësi krijimit të një aradhe të tërë instrumentistësh e këngëtarësh. Ishin pikërisht instrumentistët e kësaj shkolle ata që krijuan më vonë bandën frymore të qytetit, që fatkeqësisht sot, ashtu si shumë arritje të tjera, është zhdukur.

Pa e zgjatur shumë, dua të them se kur mbaruam Pedagogjiken në vitin 1958 ishim tridhjetë e gjashtë djem dhe vetëm një vajzë. Ajo ishte Lumturi Toptani- vajzë e adaptuar nga Delfiqare Toptani, një nga kater grate toptanase të vendosura në Peshkopi n'atë kohë. Njëra nga këto gra, Nora, thirrej dhe njihej si doktoreshë, pasi punonte si kirurke ne spitalin e Peshkopisë, ku kryente edhe operacione të thjeshta, megjithëse ishte vetëm gjinekologe, por me një experiencë të gjatë pune, duke lënë përshtypjet më të mira per njerëzillëkun, kulturën dhe përkushtimin e saj ne mbrojtje te jetës së njerëzve.

N'atë kohë dërgimi i vajzave në shkolle ishe diçka e pandodhur, për shkak të fanatizmit që sundonte në Dibër. Bile edhe për djemtë ishte pak e veshtirë për t'i dërguar, sepse familjet preferonin më mirë t'i kishin si ndihmë në punët e tyre, sesa ti dërgonin nëpër shkolla. Por katë gratë arsimdashëse toptanase e dinin se ç'ishte shkolla dhe nuk e penguan vajzën e tyre të ndiqte shkollën, pavaresisht se e vetmja femër e maturës sonë.

Lumja ishte si "veshka midis dhjamit" në atë lukuni djemsh adoleshentë. Vinte mjaft simpatike, me flokë të verdha, pak e ndrojtur, trup mesatare dhe shume e urtë dhe e sjelleshme. Ne djemtë, si djemtë, përgjithësisht mjaftë camarokë, gjatë kohës së pushimit midis orëve e përmbysnim klasën me lloj-lloj lojrash, shakarash e epitetesh, saqë Lumja shpeshë detyrohej të dilte nga klasa për të mos u bërë dëshmitare e këtyre sjelljeve, në disa raste e dhe me fjalor banal.

Është për t'u theksuar se asnjeri prej nesh nuk ngeli në klasë dhe mesatarja e notave ishte mjaft e lartë.

Me mbarimin e shkolles, shume prej nesh punuan si mesues te thjeshtë, por plot përkushtim, jo vetëm në zonat më të thella të Peshkopisë, por edhe të Matit, Mirëditës, Pukës, Kukësit e Tropojës, pasi Pedagogjikja "8 Nëntori" mbulonte me kuadro të gjithë



zonën Verilindore, detyrë që e kreu me nder, deri sa u mbyll ne vitin 1967. Nje pjesë tjetër vazhdoi arsimin e lartë brënda e jashtë vendit, dikush u bë shkencëtare e dikush diplomat, dikush kuadër drejtues e ndonjeri edhe shkrimtar e poet. Ka mes nesh me tituj shkencor , mësues të merituar dhe shume të tjerë me urdhëra e medalje "Naim Frashëri" etj.

Tani ne pleqëri një pjesë e mirë e ish maturës tonë jetojnë në Tiranë dhe në disa qytete të tjera të Shqiperisë së Mesme, si në Berat, Elbasan e Durrësi, kryesisht pas eksodit masiv qe pasoi vitet pas rrëzimit te sistemit monist. Dy prej tyre janë vendosur në Shtetet e Bashkuar të Amerikës. Disa janë ndarë nga jeta si: Maliq Kacani, Pellumb Qosja, Isuf Xhaferi, Abdi Spahiu, Sulejman Kamberi, Elmaz Sula e Shaban Çollaku.

Megjithë përpjekjet e grupit organizator:Shahin Lazrit, Kapllan Keçi e Sulejman Tomçinit, nga Tirana u bë e mundur nisja e një grupi prej vetem 10 ish maturantësh, ku, përveç treshes organizatore, ishin nga Tirana Ahmet Tomja, Ahmet Çollaku, Ferit Hasani e Lumturi Toptani, ndërsa Halit Bushi erdhi nga Berati, Myrteza Boboçi nga Durrësi dhe Asllan Aga nga Elbasani. Nuk iu bashkëngjiten dot grupit për shkak të sëmundjeve dhe pamundësive të tjera Avni Fida, Besim Turja, Hamza Spahiu, Naim Plaku e Kreshnik Spahiu nga Tirana, Sulejman Uka, Qamil Duka e Esat Lata nga Burreli, Ramadan Ajazi nga Arëmolla e Lurës, të cilit nuk ia gjetëm dot adresën, dhe Ahmet Çaushi- myftyu i Peshkopise.

Interesant është fakti se disa prej nesh nuk ishin takuar që prej 55 vjetësh dhe për pasojë edhe nuk e njohën njëri-tjetrin. Keshtu që prezantimi qe i domosdoshëm për disa prej nesh. Ky ishte edhe momenti më prekës, sepse të tjera kujtime rruanim per njëri-tjetrin nga ndarja, kur ishim të rinjë 18-vjeçarë, dhe të tjerë, të mplakur dhe rrudhur nga pleqëria dhe vitet mbi supe, na dilnin tani përpara.

Pas një kafeje tek nisja e autobusëve në Laprakë, morrëm rrugën për Peshkopi. Rruga për një pjesë prej nesh ishte e lodhshme, prandaj dhe luteshim që sa më parë të bëhet Rruga e Arbërit, e cila do ta bënte shumë më të lehtë vajtje-ardhjen në Peshkopi. Por kohëzgjatja e udhëtimit na vlejti për t'i treguar njëri-tjetrit të paditurat dhe ndodhitë që na kishin ngjarë gjatë viteve që nga mbarimi i shkollës.

Në Klos u bashkuan me grupin edhe Beshir Shira e Ndue Nikolla, të mbuluar nga thinjat por të mbajtur mirë. Këtu u ndalëm tek gjimnazi që mban emrin e ish bashkëmaturantit tone, Shaban Çollaku. Me ketë rast, në një nga klasat e shkollës, foli për të ndjerin shoku ynë, pedagogu dhe gjuhëtari Enver Hysa. Ai, duke e pas njohur atë më nga afër gjatë viteve të punës, pasi jetuan në të njëjtin bllok banesash në rrugën "Budi" në Tiranë dhe si punonjës shkencor në Institutin e Gjuhës dhe të Letërsise të Akademisë së Shkencave, ku u vendosën pasi mbaruan arsimin e lartë, dha nje jetëshkrim të shkurtuar të Shabanit dhe të veprimtarisë së tij shkencor. Ai vuri në dukje se Shabani pati fatin të dërgohej për studimin e gjuhës dhe të letërsisë turke në Sofje te Bullgarisë, ku, me ç'rast, mësoi edhe bullgarishten. Ai përmendi gjithashtu se Shabani, gjatë kohës që jetoi e punoi në Tirane, "u muar me studimin e periudhës së Rilindjes Kombëtare, duke u përqëndruar tek figura e personalitetit të madh të kulturës shqiptare, Sami Frasheri, të cilit i kushtoi edhe një monografi të gjërë, që padyshim e ka pasuruar bibliotekën me një botim dinjitoz". Ne shenjë nderimi dhe respekti, të gjithë shokët ngrihen në këmbë dhe mbajnë një minutë hedhtje. Foli edhe i biri, Kreshniku, i cili, midis emocionesh te forta, na falenderoi për atë që bëme në nderim të kujtimit të babait të tij.

Pas një kafeje, që na dhanë pritësit dhe drekës në njërin prej restoranteve anës rrugës, kur merr të përpjetën e Klosit drejt Qafës se Buallit, vazhduam rrugën për Peshkopi. Nuk po ndalem në peisazhin e bukur e madhështor të atyre anëve në këto ditë vjeshte, por nuk mund të mos them se Bulqiza e dikurshme e kishte humbur shkëlqimin dhe dukej si një qytet I perhimtë e I ngrënë nga vjetërsia. Ndalesën e radhes e bëme tek shkolla e Dovolanit, ku per disa vite me radhë aten dhënë mësim dy ish bashkëmaturantët tanë Pellumb Qosja dhe Abdi Spahiu dhe ish pedagogjikasi Eqerem Hoxha e Xheladin Isaku, të cilët tashmë janë ndarë nga jeta. Këtu na pritën drejtori i shkollës dhe disa mësues, ish pedagogjikas, si dhe përfaqësues të familjeve të Pëllumbit, Abdiut, Eqeremit e Xheldinit. Fjalën e rastit e mbajti shoku ynë Shahin Lazri, i cili gjithashtu kishte punuar si mësues në këtë shkollë para 35 vitesh. Ai, midis të tjerave, vuri në dukje se sa me passion e kishin ata mësimdhënien dhe edukimin dhe se si shkolla e Dovolanit, në sajë të punës së tyre dhe sidomos të drejtorit të saj Pëllumb Qosja, u bë një ndër më të dalluarat në Peshkopi.

Pëllum Qoses, vazhdoi Shahini, i takoi të ishte drejtor i kësaj shkolle në fillesat e saj. Ai, duke qenë një drejtues i aftë dhe i shkathtë, beri të mundur që të ardhurat nga veprimtaria ndihmëse, që zhvillonin nxënësit, t'i vinte në dispozicion te përparimit dhe zhvillimit të shkollës, duke e bërë atë shembull për të gjithë rrethin e Peshkopisë. Ai arriti t'u siguronte nxënësve drekën në shkollë si dhe mësim të organizuar pas saj, duke shënuar tregues mjaftë të lartë në mësim. Nuk kishte n'atë kohë kabinete informatike, por shkollës së Dovolanit, nën drejtimin e Pëllumbit, nuk i mungonin kabinetet e gjuhës, fizikës, biologjise etj. të pajisur me gjithë mjetet e mevojshme për konkretizimin e mësimit. Edhe drejtuesit e tjerë të kësaj shkolle, që pasuan Pëllumbin, si Neki Osmani, Eqerem Hoxha e Shkëlqim Pulaj, bashkë me ekipin mësimdhënës, ku spikati edhe bashkëmaturanti ynë Abdi Spahiu e pedagogjikasit Xheladin Isaku e Eqerem Hoxha, e vazhduan traditen model të krijuar në këtë shkollë.

Shahini vuri në dukje gjithashtu së ish shoku ynë Pëllumb Qosja punoi me ndershmëri e përkushtim edhe në detyrën e drejtuesit të organeve të pushtetit vendor, që n'atë kohë ishte nën vartësinë e Maqëllarës.

Drejtori aktual i shkollës shprehu falenderimet e tij e te kolektivit te mësuesve të shkollës për këtë vizitë dhe vlerësimet që u bëmë pararendësve e tij dhe për vetë shkollën e Dovolanit. Edhe këtu një minutë heshtje në nderim të ish shokëve, që u ndanë prej nesh.

I biri i Pëllumbit, Bekimi, inxhinier pyjesh, që gjithashtu kishte dalë për të na pritur me gjithë bashkëshorten, Teutën, vajzën e pedagogjikasit Hysni Çipurri, u prek aq shumë saqë nuk qe në gjendje as të fliste nga emocionet.

Pastaj, sipas zakonit, nje kafe dhe nisja e mbërritja në Peshkopi. Ishte ora 18.00. Vajtëm drejt e tek ish Pedagogjikja, ku na priste mësuesi ynë Sabri Vranici, si dhe bashkëmaturantët tanë peshkopias Huzri Shehu, Tahir Carra, Rexhep Deda, Lavdrim Kaba si dhe i biri i të ndjerit Maliq Kacani. Shënojmë këtu se Lavdrimi kishte gjashtëmujorin e humbjes se bashkëshortes se tij, megjithatë gjeti kohën dhe forcën për t'u bashkuar me ish shoket e tij te matures.

Pas përshëndoshjeve dhe përqafimeve të përmmallura, futemi në njërën nga klasat. Profesor Sabriu bën apelin. Dikush thotë këtu, dikush nuk përgjigjet.... Jeta kështu e ka.... . U bë edhe njohja me disa dokumente arkivore rreth maturës sonë të viteve 1957-1958, që i kishte mbledhur dhe ruajtur shoku punuan. Pastaj përshëndeti shokët Kapllan Keçi, i cili vuri ne pah meritat e matures sone, qe dhane kontribut ne edukimin e brezave te rinje qe nga Tropoja e largët e Mati e deri ne fshatrat me te thella te peshkopise. Me tej Sulejman Tomçini lexoi përshëndetjen e ish mësuesit Shemsi Manjani, i cili nuk mundi te vinte për arsye shëndetësore. Me këtë rast ky informoi se grupi inisiator ishte lidhur edhe me ish drejtorët Astrit Hoxha e Zejnel Sula dhe disa mësues ende në jetë, por që nuk mundën të vinin për arsye shëndetësore. Te gjithe te pranishmit ngrihen ne kembe dhe ngrejne nje dolli per ish mesuesit tane te nderuar....

Gjatë darkës njeripastjetrit ngriheshin ish maturantët dhe tregonin histori e ngjarje nga jeta shkollore. Njëra, që nuk mund të harohet, ishte ikja një ditë nga mësimi si klasë dhe pasojat që patëm prej saj, si vijon:

N'atë kohë shumë prej mësuesve tanë, përfshirë drejtorin Astrit Hoxha, aktivizoheshin me skuadrën e futbollit te Korabit dhe zakonisht largoheshin në fund të javës për ndeshjet e rradhës. Kjo krijonte goxha boshllëk dhe shumë orë mësimi të humbura. Profesor Muniri dhe ndonjuë tjetër mundoheshin me sa mundeshin të kontribuonin në mbushjen e këtij boshllëku. Por e keqja ishte se profesor Muniri na bënte vetëm muzikë, gjë që na mërziste. Kështuqë vendosëm të iknim si klasë nga shkolla dhe u drejtuam për nga kodrat e Kubenit deri në Kastriot. Rrugës, si te rinjë që ishim, filluam të bënim shakara. Dikush u hodh e tha se duhej të krijonim një parti. Pikërisht kjo batudë na kushtoi shumë shtrenjtë, sidomos shokëve Halit Bushi e Maliq Kacani. Ishte viti 1956 i ngjarjeve në Hungari dhe të hidhnje ide për krijim partie ishte shumë e rrezikshme. Për më tepër që Halit Bushi kishte pasur një bombë në komodinë, që mendonte ta përdorte për të zënë peshq, por që konsiderohej armëmbajtje pa leje. Kështu që në mbrëmje, pas disa mbledhjesh e zbritjesh të rrufeshme, Haliti përfundoi në paraburgim. U morën në pyetje disa prej nesh. Megjithatë pas dy ditësh Haliti u lirua, por e keqja qe se drejtoria e shkollës vendosi përjashtimin e tij dhe te Maliq Kacanit nga konvikti.

Me një fjalë një lojë kalamajsh përfundoi në formën e saj më të keqe... Haliti dhe Maliqi e vazhduan shkollen si të jashtëm. Me mbarimin e shkolles, Halitit iu dha e drejta të vazhdonte Universitetin ne degën e gjuhës angleze, ku u njoh edhe me bashkëshorten e tij të ardheshme, Domenikën nga Korça. Ai u vendos si mësues anglishtjeje në Berat dhe aty ka mbetur sot e kësaj dite.

Vonë, nga ore 23, te lodhur nga mosha dhe rruga, i dhamë fund darkës per t'u shpërndarë, dikush tek të afërmit e tij, dikush në hotel, për t'u takuar të nesermen për një



ynë Shahin Lazri, i cili vullnetarisht punoi per dy vjet resht pas vitit 1990 per shpetimin e shumë dokumentave arkivore te shkollës, te hedhura pa asnje kujdes neper bodrume, të destinuara për t'u zhdukur. Me këtë rast u kujtuan ca momente pikante nga jeta në shkollë si dhe eksperiencat e ndryshme me mësuesit, duke filluar me drejtorët Astrit Hoxha e Zejnel Sula e duke përfunduar me mësuesit e thjeshtë Munir Shehu i muzikës, Shefki Hafizi i pedagogjise, Julia Levani e gjuhë-letërsisë, Perihan Dizdari e rusishtes, Mois Cami i biologjisë, Kadri Shupejua i kimisë, Jorgji Sinjari i historisë etj.

Pas një pushimi prej një ore, u mblodhëm në restorantin "Kuka", që ishte ngritur në brinjë të Gjykatës së Peshkopise, në afërsi të ish Shkollës Bujqësore. Ishim gjithësej rreth 20 veta. Në hyrje të sallës, në një tavolinë të veçantë vendosëm emrat e shokëve që nuk jetonin më dhe pranë çdo emri një karafil të kuq. Ne krye të tavolinës vumë profesor Sabriun. Ai me këtë rast na uroi edhe një here mirëseardhjen, duke u ndalur në disa momente të historisë së lavdishme të Shkollës Pedagogjike "8 Nentori" të Peshkopisë dhe të pedagogjikasve të saj, që u shquan kudo që kafe loamtumire tek Turizmi i Peshkopise.

Kështu mbaroi ky takim historik për ne ish maturën e vitit 1958. Dikush uroi të mblidhemi edhe për 60-vjetorin, por nuk besojmë se do të kenë mbetur shumë prej nesh për të perkujtuar këtë jubile që do të përkonte edhe me 70 vjetorin e hapjes se Shkollës Pedagogjike "8 Nëntori" të Peshkopisë. Sidoqoftë u urojmë shokëve tanë bashkëmaturas jetë të gjatë e të lumtur... dhe pse jo edhe pjesëmarrje ne 60 - vjetorin e maturës.

Përvjetori i 55-të i matures sonë koinçidoi me 70-vjetorin e hapjes se Pedagogjikes, por, edhe pse kanë qenë mundësitë, nuk u bë e mundur organizimi i një aktiviteti përkujtimor me këtë rast. Për më tepër që mjaft nga maturantët e pare të saj janë ende gjallë. Besojmë se aktivitet më të rëndësishëm në fushën e arsimit organet drejtuese të qarkut Dibër nuk kanë dhe mbase kujtohen për të përkujtuar 70-vjetorin e saj.

Në kthim, një përfaqësi e jona u ndal në Burrel, për nje kafe ngushullimi, në familjen e ish shokut tone Esat Sula, i cili u nda nga jeta vetem pak ditë para së të organizonim këtë aktivitet.

** ish maturant i vitit 1958*

intervistë

Rrugëtimi i djalit nga Peshkopia, prej 12 vjetësh koncertmaestër në Operën e Mynihut.

Violinisti **Spahiu**: Koncertet në Tiranë, një festë e madhe

Nga **ALMA MILE***



Arben Spahiu ishte në Tiranë këtë muaj, për një koncert me "Different Trains", një grupi muzikantësh shqiptarë që jetojnë jashtë, si Klajdi Sahatçi, Dorian Xhoxhi, Vlorent Xhafaj, Olsi Leka, Dhurata Lazo. Ata së bashku me Luca Ranierin dhe Adam Laloum luajtën muzikë dhome gjatë katër netëve në sallën e Universitetit të Arteve dhe të Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit pjesë nga Tschaikovsky, Schumann, Beethoven, Schubert, Ravel, por edhe shqiptarët Çesk Zadeja e Eriona Rushiti. Gazeta "Panorama" botoi një intervistë me violonistin Spahiu, i cili është larguar që në moshën 6-vjeçare nga Peshkopia. Suksesi i tij na gëzon të gjithëve, ndaj redaksia vendosi të botojë intervistën dhënë gazetares Alma Mile.

Arben Spahiu s'flet shumë, madje ka një lloj ndrojtjeje, e cila zhduket menjëherë sapo merr harkun në dorë e vendos gishtat mbi telat e violinës. Arben Spahiu lindi në Peshkopi, shumë larg kryeqytetit. Askush nuk mund ta mendonte se një ditë do të bëhej mjeshtër i violinës. Qëlloi me fat që e gjetën pikërisht në qytetin e lindjes. Ashtu, 6-vjeçar, i paorientuar, do të nisej drejt Tiranës e që andej në Vjenë në 'Hochschule der Kunste". Prej vitit 2001, është koncertmaestër në "State Opera Orchestra" në Mynih (Bayerischer Staatsoper). "Different trans" do ta ngjiste atë pas shumë e shumë vitesh në një skenë shqiptare, ku mori një kënaqësi të tillë, për të cilën ai thotë se ia vlen t'i lësh pas të gjitha vështirësitë.

Si mund të shquhej një talent në një qytet si Peshkopia qëkur ju ishit fëmijë e që nuk ishte aspak afër kryeqytetit?

Atëherë ishte sistem tjetër. Shpërndaheshin pedagogë nëpër rrethe për të gjurmuar talente, nëpër kopshte, shkolla, shtëpitë e pionierit. Kështu që ishte edhe meritë e shtetit. Pastaj mblidheshim në Tiranë, ku vendoseshim në konvikte dhe të gjithë kohën ia kushtonim profesionit. Kështu ndodhi edhe me mua, iu nënshtrova këtij procesi.

E zgjodhët apo jua dhanë violinën?

Sigurisht që ma caktuan këtu. Ne ishim tërësisht të paorientuar, nuk kishim prekur kurrë instrument më parë. Kishim vetëm talentin me vete. Madje, një herë ngatërrova klasë dhe hyra në një sallë baleti dhe më vonë e mësova se ne bënim mësim diku tjetër.

Ishte edhe dëshira e prindërve?

Prindërit atëherë duhet të bëheshin vetëm trima dhe të mblidhnin mendjen që fëmijën do e lejonin të shkonte në këtë udhë, pasi kishte edhe prindër të tjerë, që thoshin që është e pamundur ta lësh fëmijën vetëm, në konvikt, aq larg. Në rastin tim, ata u treguan me zemër dhe thanë: pse jo?

Kishin ata lidhje profesionale me muzikën apo e shijonin si gjithë shqiptarët?

Jo, asnjë kontakt profesional. Thjesht qasje amatore si shumë të tjerë.

E ndienit vështirësinë e të qenët larg shtëpisë?

E kam kuptuar shumë më vonë që ka qenë e vështirë, sepse imagjinoni, për një fëmijë që vjen nga një qytet i vogël, në një qytet të madh... për mua nuk përbënte ndonjë problem, por tani që e mendoj, nuk ka qenë e thjeshtë për t'u organizuar dhe orientuar.

Jeni ndër të parët që arritët të shkolloheshit në një vend perëndimor gjatë viteve të diktaturës, si u bë e mundur kjo?

Unë përfitova prej marrëdhënieve të para të vendosura nga shteti me përfaqësi të ndryshme diplomatike për të çuar studentë me studime nëpër Europë, me kushtin që të ktheheshim prapë. Asokohe kam qenë unë, Tedi Papavrami dhe Klodiana Skënderi. Ishin bursat e para që jepeshin për jashtë shtetit. Tani kjo nuk përbën asnjë çudi, por atëherë ishte me të vërtetë një ngjarje shumë e madhe. Ishte viti 1983.

Dhe ju vendosët të qëndroni, apo jo?

Pas ndryshimit të sistemeve në Shqipëri, unë nuk shihja ndonjë të ardhme këtu. Nuk kisha asnjë plan, këtu gjithçka mbeti në gjysmë dhe unë vendosa ta ndjek vetë me forcat e mia. Vendosa të mos kthehem dhe të vijoj studimet atje.

Kur Tedi Papavrami vendosi të mos kthehej në Shqipëri, u bë zhurmë e madhe, ç'ndodhi me familjen tuaj pas këtij vendimi?

Sigurisht presione pati edhe ndaj familjes sime, por nuk u arrit deri në atë pikë sa të internoheshin. Në Shqipëri kishin filluar të ndiheshin erërat e ndryshimit, por nëse kjo do të kishte ndodhur 2-3 vite më parë, pasojat do të kishin qenë shumë të rënda.

Ju vinit nga një vend, që njihej pas ose aspak, me gjasë ju shihnin si një jashtëtokësor...

Ishte pikërisht kështu si thoni ju. Madje atje e kam dëgjuar që na shihnin si "jashtëtokësorë". Studentët qeshnin dhe thoshim po ku bie kjo Shqipëria, atje vetëm përmes satelitit mund të marrësh ndonjë fotografi, sepse nuk ka asnjë mundësi tjetër komunikimi. Por tani gjërat kanë ndryshuar. Sa i përket mënyrës se si të trajtonin, muzika flet me një gjuhë tjetër dhe nuk kishte asnjë lidhje me politikën.

Prej vitesh ju jeni koncertmaestër në Orkestrën e Mynihut, çka do të thotë një sakrificë e përhershme, apo jo?

Jo vetëm dita, por e gjithë qenia e njeriut i kushtohet këtij profesioni. Edhe kur nuk je duke u ushtruar, ajo është në mendjen tënde. Është si të jesh i thirrur për t'iu përkushtuar. Kërkon shumë mund. Sidomos kur bëhet fjalë për opera, që është ndërthurja e të gjitha arteve, kërkohet një përgatitje shumë më e gjerë. Është një profesion që të mbush jetën, por është edhe shumë i rëndë.



Ndihet konkurrenca?

Je gjithnjë nën presion. Niveli është aq i lartë, saqë mund të mbahet vetëm duke pasur konkurrencë. Unë e krahasoj me një skuadër futbolli. Çdo skuadër, çdo sezon e fillon nga e para, "hapet merkatoja e re" dhe o fiton, o humb.

Por ndërkohë, keni mbajtur kontakte me skenën shqiptare, keni pasur ftesa?

Nuk kam pasur kontakte më parë, pasi kam qenë shumë i fokusuar në ngritjen e karrierës sime atje dhe ky është një kthim pas shumë vitesh. Kam pasur ndonjë ftesë, por nuk kemi mundur të rakordojmë për çështje organizimi apo kalendari.

Por kësaj here nuk mund të thoshit dot jo...

Ishte me të vërtetë një iniciativë shumë e bukur realizimi i një aktiviteti me muzikë dhome. Sidomos për ne muzikantët që jetojmë jashtë, ishte si një festë e madhe.

I njihnit më parë djemtë e "skuadrës"?

Ishte hera e parë, me shumë pak prova. Jemi takuar shumë pak, por ishte kënaqësi e madhe. Nuk kisha luajtur me ta më parë, vetëm si emra i njihja.

Në të njëjtën skenë kaq shumë emra të suksesshëm, sidomos nga harqet, si shpjegohet?

Është si rezultat i shkollës këtu. Fillimet kanë qenë aq të shëndosha, saqë vazhdojnë të mbajnë një nivel të lartë. Sidomos për harqet ka qenë një shkollë shumë e mirë.

Si po largoheni pas kësaj eksperience të parë me publikun shqiptar?

Publiku ishte kaq i mirë dhe kaq i përqendruar te muzika, saqë më ka lënë mbresa të jashtëzakonshme. Ishte me të vërtetë një publik europian. Jam habitur nga mënyra se si na kanë pritur dhe nga përkushtimi i tyre. Kështu që duhen kaluar të gjitha pengesat për ta takuar sërish këtë publik.

(Marrë nga gazeta Panorama.com.al. Titulli është i redaksisë. Titulli në origjinal: ***Violinisti Spahiu: Kur ne shqiptarët na shihnin si "alienë"****)*

Rruga e Arbërit nr. 90

turizëm

Në zonën e Dibrës gjenden katër zona natyrore të mbrojtura: Parku Kombëtar i Lurës, Rezervati Matyror Korab - Koritnik, Zona e mbrojtur e burimeve të menaxhuara Luzni - Bulaç si dhe monumente të natyrës: 17 gjeomunumente, 12 hidromonumente dhe 12 biomonumente.

Trashëgimia natyrore, burim i pashfrytëzuar për zhvillimin e turizmit

***Nga* FATBARDH CENA**

Në Shqipëri ekzistojnë gjashtë kategori zonash të mbrojtura bazuar në kategoritë e IUCN në bazë ligjit nr. 8906, datë 06/06/2002 për "Zonat e Mbrojtura". Sipas këtij ligji, pjesë të rëndësishme ose të kërcënuara të territorit shpallen zona të mbrojtura, të cilat ndahen në gjashtë kategori: rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor (Kategoria I); park kombëtar (Kategoria II); monument natyror (Kategoria III); rezervat natyror i menaxhuar/zonë e menaxhimit të habitateve dhe llojeve (Kategoria IV); peizazh i mbrojtur (Kategoria V); zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara/ zonë e mbrojtur me përdorim të shumëfishtë (Kategoria VI).

Zonat e mbrojtura zënë një sipërfaqe të përgjithshme 361 569 ha (rreth 13%) të sipërfaqes së Shqipërisë. Në përbërjet të trashëgimisë natyrore përfshihen objekte, peizazhe, ekosisteme, habitate më të veçanta, të rralla, endemike apo të rrezikuara për t'u zhdukur. Prandaj ruhen e mbrohen edhe me forma e mënyra shumë më të rrepta, të përcaktuara saktë dhe prerë në ligje të veçanta. Veprimtaria njerëzore ushtrohet vetëm për t'i mbrojtur dhe për t'i evidentuar vlerat e tyre, që shprehen në biodiversitetin shumë të pasur dhe në peizazhin e veçantë.

Sipas **IUCN *(International Union for Conservation of Nature)*** në Shqipëri kemi 6 kategori të zonave të mbrojtura, ku në rrethin e Dibrës gjenden 4 te tilla: Kategoria II - parqe kombetare: Parku Kombëtar i Lurës; Kategoria III - monumente natyre: gjeomonumente (17), hidromonumente (12), biomonumente (12); Kategoria IV - rezervat natyror i menaxhuar: Korab Koritnik; Kategoria VI - zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara: Luzni-Bulaç.

PARKU KOMBËTAR I LURËS

Parku Kombetar i Lures shtrihet në faqen lindore të masivit "Kunora e Lures" me një gjatësi 9.6 km. Lartësia minimale nga niveli i detit arrin 1375 m, kurse ajo maksimale 1919m. Sipërfaqja e parkut është 1280 Ha (nuk dihet me saktësi ditët e sotme pasi shumë pyje janë djegur vitet e fundit), nga e cila 1100 ha janë pyje, 50 ha livadhe, 30 ha pasqyra e ujit të liqeneve dhe 100 ha sipërfaqe shkëmbore. Në kuadrin e Krahinës Malore Qendrore zë pjesën veriore të saj. Si njësi administrative tokësore përfshihet në Komunën Lurë. Komuna e Lurës nga veriu kufizohet Arren të Kukësit, në lindje me komunat Reç, Zall-Dardhë dhe Arras të Dibrës, në jug me komunat Macukull dhe Selishtë dhe në perëndim me fshatrat e Mirditës: Kurbnesh dhe Lajthis.

Padyshim që elementi gjeografik që e bën më të njohur këtë zonë janë liqenet akullnajore. Liqenet e Lurës janë një grup liqenesh akullnajore, shumë piktoreskë, të përhapur në një territor me sipërfaqe 30 km2, në zonën me formacione të papërshkueshme. Zona ku janë të përhapur Liqenet e Lurës shtrihet në lartësinë nga 1500-1800m mbi nivelin e detit. Liqenet kanë forma të rrumbullakosura, më i madhi nga të cilët është Liqeni i Madh me sipërfaqe afro 0.32 km2, gjerësi maksimale 300 m, gjatësi 450m, pas tij vjen Liqeni i Pishave me sipërfaqe 0.13 km2, Liqeni i Zi 0.8 km2, Liqeni i Luleve 0.4km2, Liqeni i Gallabes, i Hotit, i Thatë, i Bruçit etj.


Për të përshkruar bukuritë që ofron kjo zonë turistike janw shprehur shumw personalitete, mes tw cilwve, Gjergj Fishta ka thwnw se *"***Kush nuk ka parë Lurën, nuk ka parë Shqipërinë***", ndwrsa* studiuesja britanike Edit Durham do ta cilësonte si **"Një ndër zonat më të bukura në Ballkan".** Ndërsa një mjeshtër projektesh sportive, që kishte ardhur të shihte këndej, thotë: **"Për dy ditë isha në Zvicrën e Shqipërisë, aty ku Zoti ka falur shumë por njeriu ka punuar pak".**

Lura me relievin e saj të larmishëm, monumentet e shumta të natyrës, shumëllojshmërinë e klimës dhe pasurinë e ujërave ofron mundësi të shumta për zhvillim në plan turistik. Relievi malor me vlerat e parametrave morfometrike të larta ka kushtëzuar e ofruar mundësinë e zhvillimit të turizmit në planin kryesisht zbavitës e sportiv.

Jo rrallë aktivitetet që zhvillohen në zonën e mbrojtur, bien ndesh me statusin e miratuar, por edhe në rastet kur këto nuk bien ndesh, zhvillohen jashtë kontrollit e pa ndonjë kriter shkencor, njëherazi shkaktojnë një impakt të rëndësishëm në ekosistemet, habitatet dhe në komunitetet bimore e shtazore të parkut

PARKU NATYROR KORAB-KORITNIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 4/2, 9, 13 e 23, të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave vendosi shpalljen e ekosistemit natyror malor Korab - Koritnik "Park Natyror", sipas hartës që i bashkëlidhet këtij vendimi.



Hartë e punuar nga autori me programin Arc Gis 10

Parku Natyror Korab - Koritnik ka sipërfaqe të përgjithshme 55 550.2 ha, nga të cilat në rrethin e Kukësit 34 886.8 ha dhe në rrethin e Dibrës janë 20 663.4 ha. Autoriteti shtetëror, që ngarkohet me administrimin e zonës së mbrojtur, janë strukturat e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe administratat ekzistuese të sektorëve pyjorë (Kukës e Dibër), që përfshihen brenda sipërfaqes së parkut natyror..

Pjesën kryesore të territorit e zënë sipërfaqet me kullota e livadhe, të ndjekura nga sipërfaqet pyjore e me bimësi pyjore, sipërfaqet joprodhuese, sipërfaqet bujqësore, si dhe sipërfaqet urbane e troje të përziera me tokë bujqësore e pyjore.

Mali i Korabit është maja më e lartë e Shqipërisë, 2751m mbi nivelin e detit. Vendndodhja gjeografike e tij shtrihet në veri-lindje të rrethit të Dibrës, në kufirin lindor shtetëror që ndan Shqipërinë me Maqedoninë.

Ky territor karakterizohet nga një shumëllojshmëri formash të relievit të shoqëruara me formacione të mëdha shkëmbore, pjesa më interesante e të cilave janë formacionet e gipsit mbi të cilët është instaluar bimësia pyjore në kushte relativisht të vështira, duke krijuar në këtë mënyrë një ansambël magjepsës natyror me efekte të mëdha panoramike

Sipërfaqja paraqet një larmi formash të terrenit me shpate të thepisura, lugina dhe kanione të thella, me formacione gipsesh të dala në sipërfaqe si edhe rrafshnalta të vogla të pasura me bimësi barishtore e bimë shumëngjyrëshe, në trajtën e bjeshkëve. Lartësia minimale është 850m mbi nivelin e detit dhe ajo maksimale 2751m (maja e Korabit). Një konfiguracion i tille i relievit mundëson zhvillimin e turizmit elitar malor dhe alpin. Për këtë do të ishte i domosdoshëm zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme si pjesë integrale e një plani të përgjithshëm menaxhimi pas shpalljes si zonë e mbrojtur.

Pritet që të ngrihet e të plotësohet me organikën e nevojshme edhe administrata e Zonës së Mbrojtur e këtij parku.


MONUMENTET E NATYRËS.

Rrethi Dibër dallohet për monumente te shumta natyre qofshin këto gjeomonumente (17), hidromonumente (12) apo biomonumente (12). Për vlerat e tyre të veçanta historike, estetike, turistike, biologjike etj. mund të propozojmë një numër të madh për shpalljen e tyre monument natyre.

a. **Gjeomonumentet.**

Në kategorinë e gjeomonumenteve përfshihen objekte gjeologjike: zhveshje apo fosile unikale, struktura e formacione gjeologjike të rralla; objekte gjeomorfologjike: mikroforma, forma dhe peizazhe të relievit të krijuara apo modeluara nga era, akujt, dëbora, ngricat, lumenjtë, karsti, valët detare apo liqenore, erozioni për shkaqe natyrore dhe i intensifikuar nga njeriu etj.

1. Karsti i Malit të Bardhë. Ndodhet në afërsi të fshatit Sllatinë (Komuna Sllovë), në një territor të përbërë nga gjipset e Permianit të Sipërm dhe Triasit të Poshtëm, në të cilët është i zhvilluar fuqimisht proçesi i karstit, i cili ka formuar një peizazh me një mori formash negative karstike, sidomos hinka të ngushta dhe të thella. Është i gjatë rreth 1200 m dhe i gjerë deri në 230 m. Në të njëjtën kohë përbën edhe një ekosistem interesant karstik. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike, estetike, didaktike, ekologjike dhe turistike. Para 5-6 vitesh në burimin e ujit që del nga shpella e Sopanikës, ka patur një ndërhyrje për marrjen e ujit për ndërtimin e një ujësjellësi për furnizimin me ujë të pijshëm të disa fshatrave të luginës së Drinit të Zi. Por që nga viti 2009, punimet këtu janë ndërprerë dhe nuk kanë vazhduar më tej.



Liqeni i Luleve, Prill 2013

2. Shpella e Gurit të Kuq.Ndodhet në afërsi të fshatit Muhurr, 500 m mbi nivelin e detit. Përbën një shpellë karstike të formuar në gëlqerorët e Triasit të Sipërm. Është e gjatë 400 m, e gjerë deri në 2-3 m dhe e lartë 4 m. Shpella ka konkrecione të shumta dhe me bukuri të rrallë. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, didaktike, ekologjike dhe kulturore. Hyrja e shpellës është e mbuluar nga gurët dhe duhet të studiohet nga specialistët e fushës.

3. Shpella e Rusit.Ndodhet në afërsi të fshatit Grykë Nokë, në lartësinë 710 m mbi nivelin e detit. Përbën një shpellë karstike të formuar në gëlqerorët e Triasit të Sipërm-Jura e Poshtme. Është e gjatë 10-15 metra, e gjerë deri në 2 m dhe e lartë 2 m. Shpella ka konkrecione të shumta. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, didaktike, ekologjike dhe kulturore.

4. Shpella e Qytezës-Bellovë.Ndodhet në lindje të qytetit të Peshkopisë, në afërsi të fshatit Bellovë, 1400 m mbi nivelin e detit. Përbën një shpellë karstike të formuar në gjipset e Permianit te siperm-trasi i poshtem. Eshte e gjate mbi 10 metra, e gjere deri ne 2 m dhe e larte 2-3 m. Shpella ka konkrecione te shumta. Ne te ka mbetje te aktivitetit te njeriut lashte. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, arkeologjike, didaktike, ekologjike dhe kulturore.

5. Shpella e Akullit (Bulaç).**Ndodhet në Bulaç, në afërsi të fshatit Muhur, 1000 m mbi nivelin e detit. Përbën një shpellë karstike të formuar në gëlqerorët e Triasit të Siperm- Jura e Poshtme. Është e gjatë 50 metra, e gjerë deri në 3 m dhe e lartë 2 m. Shpella ka konkrecione të shumta. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, didaktike, ekologjike dhe kulturore**

6. Pasqyrat e Gramës. Ndodhen në malin e Gramës, në afërsi të fshatit Sllatinë, 1900 m mbi nivelin e detit. Përbën një gur të madh me përbërje gjipsore të llojit selenit, prej të cilit ka marrë edhe emrin "pasqyrat". Është e gjatë deri në 500 m, i gjerë deri në 200 m. Kanë vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, didaktike, ekologjike, kulturore.

7. *Gropa e Panairit*.Ndodhet afër fshatit Radomirë, 2115 m mbi nivelin e detit. Përbën një cirk të madh kompleks akullnajor të formuar në rreshpe. Është e gjatë 800 m, e gjerë deri në 230 m. Ka formën e një amfiteatri gjigand me fund të sheshtë dhe shpate të thepisura. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, didaktike, ekologjike, turistike dhe kulturore

8. Bjeshka e Zonjave në Gramë.Ndodhet në bjeshkën e Gramës, në masivin e malit të Korabit, në afërsi të fshatrave Vrenjt e Zimur, në lartësi nga 1700 m deri në 2200 m mbi nivelin e detit. Përbën një shpatullim të madh akullnajor të formuar në rreshpe. Është i gjatë 1000 m, i gjerë deri në 200-300 m. Ka formen e nje katërkëndëshi te çrregullt dhe të një ballkoni të madh natyror. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, didaktike, ekologjike, turistike dhe kulturore.

9. Gryka e Setës.**Ndodhet në sektorin e mesëm të rrjedhjes së Setës (degë e Drinit të Zi) 700 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një kanion në gëlqerorët e Triasit të Sipërm–Jura e Poshtme, të formuar nga veprimtaria erozive e lumit me të njëjtin emër, pjesa më e ngushtë dhe më e thellë). Është i gjatë rreth 1.5 km, i thellë rreth 150 m dhe i gjerë rreth 4-7 m. Ka shpate të thepisura. Në të njëjtën kohë përbën edhe një ekosistem interesant karstik. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike e biologjike, didaktike, ekologjike dhe kulturore**

10. Gryka e Madhe- Lurë.**Ndodhet në sektorin e mesëm të rrjedhjes së Malle Lurës (degë e Drinit të Zi), 380 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson kanion në gëlqerorët e Triasit të Sipërm-Jura e Poshtme, të formuar nga veprimtaria erozive e lumit me të njëjtin emër. Është i gjatë rreth 1.3 km, i thellë rreth 50 m dhe i gjerë rreth 6 m. Ka shpate të thepisura. Në të njëjtën kohë përbën edhe një ekosistem interesant karstik. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike e biologjike, didaktike, kulturore, ekologjike dhe turistike.**

11. Shllinasi.Ndodhet në Malin e Bardhë, në afërsi të fshatit Vrenjt, 1200 m – 1500 m mbi nivelin e detit. Përbën një masiv shkëmbor me përbërje gjipsi dhe kripe guri. Është e gjatë deri në 900 metra, i gjerë deri në 250 m dhe e lartë deri në 200 m. Në të shkojnë dhitë e egra për të lëpirë kripën. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, didaktike, ekologjike dhe kulturore.

12. Guri i Kërçinit. **Ndodhet në afërsi të fshatit Kerçisht, 2000 m mbi nivelin e detit. Përbën një gur gëlqeror të Kretës së Sipërme, me formë të veçantë të formuar në gëlqerorët. Sipërfaqja e tij është 12.5 ha. Në të organizohen festa fetare me origjine pagane. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, didaktike, ekologjike dhe kulturore.**

13. Rrafshi i Korabit.**Ndodhet afër fshatit Radomirë, 1900 m mbi nivelin e detit. Përbën një cirk të madh kompleks akullnajor të formuar në rreshpe. Është i gjatë 1000 metra, i gjerë deri në 200 m. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, didaktike, ekologjike, turistike dhe kulturore.**

14. Morenat e Fushë Lurës.**Ndodhen afër fshatit Fushë Lurë, në malin e Lurës, 1100 m mbi nivelin e detit. Përbëjnë depozitime morenike të akujve kuaternarë, të ardhura nga cirku kompleks i Liqenit të Madh. Kanë shtrirje në trajtën e një brezi të çrregullt 1.3 km të gjatë, 350 m të gjerë. Kanë vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, didaktike, ekologjike, turistike dhe kulturore.**

→

cyan magenta yellow black

ekonomi

Edukata e ulët mjedisore dhe mungesa e informacionit është jo vetëm një problem i përgjithshëm për zonat e mbrojtura por është dhe një problem specifik për rrethin e Dibrës.



Pamje nga Kalaja e Dodës

15. Cirku i Kurorës së Lurës. Ndodhet në malin e Kunorës së Lurës, 1830-2000 m mbi nivelin e detit. Përbën një cirk të madh akullnajor të formuar në magmatikë. Është i gjatë 900 m, i gjerë deri në 350 m. Ka formën e një kolltuku gjigand me disa forma më të vogla karstike. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, didaktike, ekologjike dhe kulturore.

16. Kodra e Parave. Ndodhet në afërsi të fshatrave Blliçe e Kukaj, 493 m mbi nivelin e detit. Përbën një kodër karakteristike në formën e një kupole dhe forme të veçante (vezake). Legjenda e thotë se në këtë kodër të parët kanë fshehur thesarin. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, didaktike, ekologjike dhe kulturore.

***17. Fusha e Pelave*.Ndodhet në Parkun Kombëtar të Lurës, në lartësinë 1580 m mbi nivelin e detit. Si formë relievi përbën një cirk të cekët akullnajor, që për një kohë ka qenë e mbuluar nga një liqen glacial, i cili më pas u tha. Në të njëjtën kohe fusha e Pelave përbën edhe një habitat interesant të llojeve të ndryshme të livadheve alpine. Ka bukuri mahnitëse. Ka vlera shkencore,gjeologjike, gjeomorfologjike, biologjike, didaktike, ekologjike dhe kulturore.**

a. **Hidromonumentet.**

Në kategorinë hidromonumente janë cilësuar: liqene akullnajore karstike, burime të mëdha dhe interesante karstike, minerare dhe termominerare, shpërthime avulli të nxehtë apo gazi të djegshëm ujëvara, ligatina etj.

1. Liqeni i Luleve. Ndodhet në Parkun Kombëtar të Lurës, në lartësinë mbi 1580 m të malit të Kunorës së Lureës, i vendosur në një cirk të madh kompeks akullnajor. Përbën një liqen akullnajor, me sipërfaqe rreth 1.45 ha. Ka ujë të pastër si kristali dhe të ftohtë. Gjatë dimrit ngrin në sipërfaqe. Është i pasur me një botë të gjallë të larmishme dhe formon një ekosistem interesant të liqeneve alpine me bukuri të rrallë. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike, estetike, didaktike, ekologjike dhe kulturore. Në vitet 1997-2003, ka patur dëmtime të mëdha nga zjarri, shkulje të drurëve nga erërat dhe prerje pa leje në pyllin që e rrethon.

2. Liqeni i Zi.Ndodhet në lartësinë mbi 1630 m të malit të Kunorës së Lurës, i vendosur në një cirk të madh kompleks akullnajor. Përbën një liqen akullnajor me sipërfaqe rreth 3 ha. Dallohet për thellësinë më të madhe se të liqeneve të tjerë akullnajore të Lurës. Ka ujë të pastër si kristali dhe të ftohtë. Gjatë dimrit ngrin në sipërfaqe. Është i pasur me një botë të gjallë të larmishme dhe formon një ekosistem interesant të liqeneve alpine. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike, estetike, didaktike, ekologjike dhe kulturore. Në vitet 1997-2003, ka patur demtime të mëdha nga zjarri, shkulje të drurëve nga erërat dhe prerjet pa leje në pyllin që e rrethon.

***3. Liqeni i Madh*.Ndodhet në parkun Kombëtar të Lurës, në lartësinë mbi 1600 m të malit të Kunores se Lures, i vendosur në një cirk të madh kompleks akullnajor. Përbën një liqen akullnajor me sipërfaqe rreth 12 ha. Ka ujë të pastër si kristali dhe të ftohtë. Gjatë dimrit ngrin në sipërfaqe, ndërsa gjatë verës mbulohet nga zambakë të mëdhenj e të bardhë. Është i pasur me një botë të gjallë të larmishme dhe formon një ekosistem intersant të liqeneve alpine. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike, estetike, didaktike, ekologjike dhe kulturore.**

***4. Liqeni i Zi - Radomirë*.Ndodhet në afërsi të fshatit Tejz (Radomirë), në masivin e malit të Korabit në lartësinë mbi 1460 m, i vendosur në një cirk të madh kompleks akullnajor. Përbën një liqen akullnajor, me siperfaqe rreth 0.8 ha. Ka ujë të pastër si kristali dhe të ftohtë. Gjatë dimrit ngrin në sipërfaqe. Është i pasur me një botë të gjallë dhe formojnë një ekosistem interesant të liqeneve alpine. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike, estetike, didaktike, ekologjike dhe kulturore.**

5. Liqenet e Kacnisë.Ndodhen në afërsi të fshatit Kacni (Komuna Selishtë), në shpatin lindor të malit të Balgjajt në lartësinë mbi 1700 m. Janë të vendosura në disa cirqe të mëdhenj komplekse akullnajore. Përbëjnë liqene akullnajore karstike, burime të mëdha dhe të gjerë 20-35 m. Kanë ujë të fohtë e të pastër si kristali. Gjatë dimrit ngrijnë në sipërfaqe. Janë të pasur me një botë te gjallë dhe formojnë një ekosistem interesant të liqeneve alpine. Kanë vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike, estetike, didaktike, ekologjike dhe kulturore.

***6. Ujëvara e Pocestës.*Ndodhet në zonën e Maqellarës në shpatin lindor të malit të Deshatit, në afersi të fshatit Pocest në lartësinë 1500 m. Uji del përgjatë një të çare të madhe në shkëmbin e thepisur gelqeror, duke formuar kështu një burim të madh karstik dhe ujëvarën e famshme me lartësi 13 m. Zhurma e ujit dëgjohet në një distance mjaft të madhe. Krijon një pamje me bukuri mahnitese. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike, estetike, didaktike, ekologjike dhe turistike.**

7. Uji i Ftohtë. Ndodhet në afërsi të fshatit Vleshë, në lartësinë 800 m mbi nivelin e detit. Përbën një burim karstik me prurje mjaft të madhe që del në kontaktin litologjik midis gëlqerorëve dhe rreshpeve. Ka ujë të pastër dhe shumë të ftohtë. Krijojne një mjedis shumë tërheqës. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, kulturore, didaktike dhe turistike.

***8. Burimi karstik i Kërçinit*.Ndodhet në malin e Kërçinit, në afërsi të fshatit Kërçisht, në lartësinë 1670 m mbi nivelin e detit. Përbën një burim karstik me prurje të madhe që del në kontaktin litologjik midis gëlqerorëve dhe terrigjenëve. Ka ujë të pastër dhe të ftohtë. Krijon një mjedis shumë tërheqës. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, kulturore, didaktike dhe turistike.**

9. Kroi i Mbretit-Sekarol . Ndodhet në afërsi të fshatrave Radomirë e Ceren, në lartësinë 1200 m mbi nivelin e detit. Përbëjnë një burim karstik, që dalin në kontaktin litologjik midis gëlqerorëve dhe terrigjenëve. Ka ujë të pastër e të ftohtë. Krijon një mjedis shumë tërheqës. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, kulturore, didaktike dhe turistike. Ka nevoje për një restaurim të plotë pasi aktualisht është vetëm një burim i thjeshtë uji dhe nuk ka krua.

10. Burimi termomineral i Llixhave të Peshkopisë. Ndodhet në lindje të qytetit të Peshkopisë, në krahun e djathtë të përroit me të njëjtin emër. Janë burime termominerare me temperaturë rreth 40 ºC, me përmbajtje kripërash dhe gazrash të tretura në to. Kanë rëndësi shkencore, sidomos në fushën e gjeologjisë dhe të hidrogjeologjisë sepse lidhen me shkëputjen e madhe tektonike krahinore dhe bëhet fjalë për lëvizje aktive tektonike. Objekti ka edhe vlera kuratve, didaktike e turistike.



Gipsi përballë Fshatit Bellovë

11. Burimet e Bellovës. Ndodhen në afërsi të fshatit Bellovë, në lartësinë 620 m mbi nivelin e detit. Përbëjnë disa burime karstike, që dalin në kontaktin litologjik midis gjipseve të Permianit të Sipërm - Triasi i Poshtëm dhe rreshpeve paleozoike. Kanë ujë të pastër dhe të ftohtë. Krijojnë një mjedis shumë tërheqës. Kanë vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, kulturore, didaktike dhe turistike.

***12. Burimi i Sopanikës*.Ndodhet në afërsi të fshatit Çidhën e Poshtme, në lartësinë 400 m mbi nivelin e detit. Përbën një burim karstik me prurje 150 l/sek, që del në kontaktin litologjik midis gëlqerorëve dhe terrigjeneve. Ka ujë të pastër dhe të ftohtë. Krijon një mjedis shumë tërheqës. Kanë vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, kulturore, didaktike dhe turistike.**

b. **Biomonumentet.**

Në kategorinë e biomonumenteve janë përfshirë dukuri të rralla nga bota e gjallë si: drurë, grupe drurësh me kurorë interesante apo moshë të hershme; habitate të përbëra nga shoqërime karakteristike bimore të virgjëra ose të gjallesave të rralla, të rrezikuara, endemike.

***1. Krasta e Pocestit*.Ndodhet në afërsi të fshatit Pocest, 1500 m mbi nivelin e detit. Përbën një habitat të formuar në një territor me përbërje gëlqerore dhe me bimësi të veçante dhe të larmishme (shkozë, ah, lajthi, panjë, frashër, mollë e vodhe të egër, dëllinjë, trendafil i eger etj). Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, didaktike, ekologjike dhe kulturore.**

2. *Boroviku i Begjunecit-Rabdishtë*. Ndodhet në afërsi të fshatrave Begjunec e Rabdisht, 785-1350 m mbi nivelin e detit. Përbën një habitat të formuar në një territor me përbërje gjipsore dhe me bimësi të veçante dhe të larmishme (pishë e zezë, ah, lajthi, panjë, frashër, dushk etj). Ka edhe kafshë të rralla si kaproll. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, biologjike, didaktike, ekologjike dhe kulturore.

3. Hartinat e Lurës. Ndodhen në Parkun Kombëtar të Lurës, në afërsi të fshatit Fushë Lurë, 1600 m mbi nivelin e detit. Përbën një grup drurësh me trung dhe kurorë të veçante (trekëndëshi) me lartësi 20-30 m, diameter te trungut rreth 40- 50 cm dhe moshe 30 - 70 vjeçare. Kanë vlera shkencore, biologjike, ekologjike, kulturore, didaktike dhe turistike. Por duhet të theksojme se disa vite më parë edhe hartinatkanë qenë dë mtuar dhe nuk ruhet statusi i Zonës së Mbrojtur.

4. Rrapi i Kërçishtit. Ndodhet në fshatin Kërçisht i Poshtëm (Komuna Maqellarë) në qendër të fshatit, 50 m poshtë xhamisë së fshatit në lartësinë 700 m mbi nivelin e detit. Mosha e tij është rreth 250 vjeçare. Nuk është i dëmtuar. Ka vlera shkencore, gjeomorfologjike, biologjike, didaktike, ekologjike, kulturore e fetare.

5. Pisha e Blliçes. Është e llojit pishë e zezë. Ndodhet në fshatin Blliçe, në lagjen e Blliçes së Poshtme, në lartësinë 475 m mbi nivelin e detit. Mosha e saj është rreth 150 vjeçare. Nuk është e dëmtuar pavarësisht se pothuaj çdo vit preket nga proçesionaria e pishës. Ka vlera shkencore, gjeomorfologjike, biologjike, didaktike, ekologjike, kulturore e fetare.

6. Ahu i Blliçes. Ndodhet ne fshatin Blliçe, në lagjen e Blliçes së Poshtme në lartësinë 475 m mbi nivelin e detit. Mosha e tij është rreth 170 vjeçare. Nuk është i dëmtuar. Ka vlera shkencore, gjeomorfologjike, biologjike, didaktike, ekologjike, kulturore e fetare.

7. Lisi i Dobit. (Lisi i Bunarit) ndodhet në afërsi të fshatit Fushë-Muhurr (Komuna Muhurr). Nuk është i dëmtuar. Përfaqëson dru me lartësi mbi 25 m, diametër të trungut rreth 110 cm e perimetër mbi 320 cm, moshë mbi 160 vjeçare, me 30 degë e kurorë ombrellore me perimetër mbi 78 m.Ka vlera shkencore, gjeomorfologjike, biologjike, didaktike, ekologjike, kulturore e fetare.

8. Lisi Kabe. Gjendet në lagjen Kabe të komunës Qendër-Tomin, 650 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson dru me lartësi mbi 20 m, diametër të trungut mbi 140 cm, perimetër mbi 420 cm dhe moshë mbi 140 vjeçare. 25 degët e tij formojnë kurorë ombrellore me perimetër 55 m. Nuk është i dëmtuar. Ka vlera shkencore, biologjike, didaktike, estetike e turistike.

9. Vakufi i Sinës së Epërme. Gjendet afër fshatit Sinë, Komuna Arras. Përfaqëson pyll (2 ha), me drurë mbi 25–30 m të lartë dhe diametër trungu mbi 70 cm). Pylli nuk është dëmtuardhe ruhet si vakef.Në këtë vakëf ka disa dure dushku me moshë 150 vjeçare. Ka vlera shkencore, gjeomorfologjike, biologjike, didaktike, ekologjike, kulturore e fetare.

10. Rrobulli i Lurës. Ndodhet në Parkun Kombëtar të Lurës, në afërsi të fshatit Gur-Lurë, 1583 m mbi nivelin e detit. Përbën një dru rrobulli (Pinus leucodermis), me trung dhe kurorë të veçantë me lartesi 30 m, diametër të trungut rreth 1.5 m – 1.8 m dhe moshë rreth 500 vjeçare. Ka vlera shkencore, biologjike dhe ekologjike, kulturore, didaktike dhe turistike.

11. Rrapi i Çidhnës. Ndodhet në fshatin Çidhën e Poshtme (Komuna Arras). Në fakt aty janë tre drurë të vjetër të llojit Plepi të Zi, pranë një burimi me ujë të pastër e të ftohtë. Këto drurë nga populli thirren me emrin "Rrap" duke u nisur nga madhësia e mosha e tyre. Ka vlera shkencore, gjeomorfologjike, biologjike, didaktike, ekologjike, kulturore e fetare.

12. Vakufi i Çangës-Kovashicë. Ndodhet në afërsi të fshatit Kovashicë (Komuna Maqellarë). Ky është një pyll dushku me origjine llastarore, me moshë rreth 25-30 vjeçare, që mbrohet nga fshati si vakuf, vend varrezash. Kemi mendimin që të mos trajtohet si monument natyre sepse aty është vene dorë nga njeriu

ZONË E MBROJTUR E BURIMEVE TË MENAXHUARA: LUZNI-BULAÇ.

Në ish Institutin e Pyjeve është gjetur vetëm një harte e heliografuar, mbi bazën e të cilës është bërë propozimi për shpalljen zonë e mbrojtur si dhe sipërfaqja e saj prej 5900 ha, gjë që nuk përputhet me shumën e sipërfaqeve të përfishira në këtë harte. Nga shumatorja e sipërfaqeve të ngastrave sipas hartës, rezulton se sipërfaqja totale përveç tokës së bukës e ngastrave të kësaj zone është 5696 ha nga të cilat 1526 ha i kanë kaluar rrethit të Bulqizës në korrik te vitit 1992, dhe vetëm 4170 ha i kanë mbetur rrethit Dibër. Kjo zonë ka mbetur e tillë sipas emrit të vjetër të ekonomisë pyjore "Luzni-Bulaç" para se të bëhen planet e inventarizimit të vitit 1985.

Me rastin e kryerjes së inventarizimit të fundit te pyjeve të vitit 1985, ish ekonomia pyjore "Luzni-Bulaç" u nda në dy Ekonomi Pyjore: në "Luzni" me sipërfaqe gjithsej 1288 ha dhe në "Muhur-Sine" me siperfaqe gjithsej 3897 ha . Në vitin 2008, nga këto dy ekonomi pyjore, e gjithë zona që ka patur statusin e zonës së mbrojtur, me vendime të veçanta Qeverie u ka kaluar në pronësi komunave Luzni dhe Muhurr pa marrë parasysh statusin e veçantë të tyre.

Këtu duhet të theksojme se gjendja e pyjeve në këto komuna vitet e fundit ka përmirësime, ndërsa pak më e degraduar paraqitet gjendja në pjesën e Luznisë, veçanërisht baseni i përroit të Kusarës, ku si pasojë e mos mbrojtjes nga kullotja e terrenit të zhveshur e të pjerrët, shpesh herë ka shkaktuar dëme dhe përmbytje të shtëpive dhe të tokës së fshatit Katund i Ri.

Zona ka motive natyrore tërheqësë për turistë si kullota e pyje të rinj si dhe nje rrjet hidrografik të dendur. Nuk njihet si një zonë e frekuentuar dhe e kërkuar nga turistët.

PROBLEMET E TRASHËGIMISE NATYRORE.

Si kudo në Shqipëri edhe këtu problemet e trashegëmise natyrore janë nga më të ndryshmet. Ndër problemet kryesore mund të rendisim:

- Vakufi i Çangës-Kovashicën edhe pse aty është vene dorë ndjeshëm nga njeriu, ekziston ende në listën e trashëgimisë natyrore
- Shumica e monumenteve me vlerë nuk kanë infrastrukturën e duhur për tu vizituar nga turistët.
- Fusha e Pelave megjithëse është një peizazh i rralle që nuk ka pësuar dëmtime, problem mbetet mbikullotja.
- Prerja e pyjeve pothuajse kudo por veçohen ato të Lurës, rreth liqeneve të Kacnisë etj. ka bërë figurë negative tek turistët.
- Mungojnë orjentimet gjatë rrugëve automobilistike për turistët që vijnë për pushime në këtë zonë.
- Zjarret e shumta ku përmenden ato të vitit 2007 dhe ato të këtij viti (2012) në Lurë kanë bërë që të shkrumbohen sipërfaqe të mëdha pyjesh ahu e pishe.
- Mbipeshkimi është një problem tjetër në lumin e Drinit të Zi ku përdoren metoda të jashtëligjshme.
- Gjuetia e paligjshme dhe në kohë të papërshtatshme ka bërë që të zhduken edhe kafshë endemike si Lynxi i Lurës.
- Mungesa e një plani për depozitimin dhe menaxhimin e mbeturinave.
- Edukata e ulët mjedisore dhe mungesa e informacionit është jo vetëm një problem i përgjithshëm për zonat e mbrojtura por është dhe një problem specifik për rrethin e Dibrës.

Burimet e shfrytëzuara

Qiriazi, Perikli dhe Sala, Skënder: *"Monumentet e Natyrës së Shqipërisë", Tiranë 2006*
Ligj nr. 8906, datë 06.06.2002 *"Për zonat e mbrojtura"*
Ligj nr. 9734, datë 14.5.2007 *"Për turizmin"*
MTKRS *"Strategjia Sektoriale e Turizmit 2007-2013"*
Ligj nr. 7665, datë 21.01.1993 *"Për zhvillim e zonave që kanë përparësi turizmin"*
Vendim Nr.898, datë 21.12.2011 *"Për shpalljen e ekosistemit natyror malor Korab-Koritnik: Park Natyror"*
Daci, Fatos: *"Enciklopedia e Dibrës"*, Vol.I, AlbGraf, Maj 2006.
Bashkia Peshkopi: *"Plani lokal i veprimit për biodiversitetin"*, Peshkopi 2010.
Bashkia Peshkopi *"Peshkopia"*, Guidë turistike, Tiranë 2010.
Plani i Zhvillimit Strategjik: *Bashkia Peshkopi dhe 14 komunat e Rrethit Dibër".*
Ashiku, Abdurahim: *"Po Dibrës! Jo Skavicës!"*, Botimet M&B, Tiranë 2010.
AECID: *"Potencialet dhe tendencat e zhvillimit bujqësor të Dibrës"*, Peshkopi 2009.
Materiale të marra nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor Dibër, Shtator 2012.
Materiale të marra në Këshillin e Qarkut Dibër në Drejtorinë e Zhvillimit Rajonal. Maj 2013.
UNDP: *"Nxitja e zhvillimit rajonal nëpërmjet objektivave të mijëvjeçarit. Qarku Dibër".*
Axhemi, Sokol: *"Lura-Morfologjia dhe morfogjeneza e pjesës qëndrore"*, Camaj-Pipa 1997.
Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë: *"Gjeografia Fizike e Shqipërisë"*, Vëllimi I dhe II, Tiranë 1991.
Doka, Dhimitër dhe Draçi, Bilal: *"Gjeografia e Turizmit"*, Tiranë 2006.
Dollma, Merita dhe Pazari, Florina: *"Potenciali turistik në Qarkun Dibër dhe menaxhimi i tij"*. Tiranë 2010.
Lidhja e Historianëve Shqiptarë Dibranë: *"Dibra dhe etnokultura e saj"*, Vëllimi I dhe II, Dibër e Madhe 1995.
Shoqata Lidhja e Intelektualëve Dibranë: *"Rruga e Arbërit"*, Dita 2000, Tiranë 2007.
Federate e pyjeve dhe kullotave komunal, Qarku Dibër: *"Visit in the croën of Peshkopi"*, 21 October 2011.
Ajazi, Sali: *"Nikoll Kaçorri, Nënkryetar i Qeverisë së Vlorës 1912"*,

cyan magenta yellow black

Rruga e Arbërit nr. 90

Me rastin 102 vjetorit të lindjes

kulturë

Migjeni - nënvizim i disa njohurive për të

Nga **ALI R.BERISHA**

Sot Migjeni ynë i madh, krenaria jonë, kolosi i letrave shqipe, njëri ndër poetët më të famshëm e kështu edhe ndër më të rëndësishmit e letërsisë sonë moderne, mbush 102 vjet nga dita qe ka lindur. Shpërthimi i tij si poet e shkrimtar që në moshën e re, bërja e tij i njohur, po ashtu që në moshën e re si dhe vdekja e tij gjithashtu në moshën e re, kanë bërë që ai të shkëlqejë si meteor në letërsi dhe të ngrihet në një simbol të shkëlqimit rinor, të vargut të lirë, por edhe të mjerimit e dhembjes. Asnjë shkrimtar, më dendur se Migjeni nuk është marrë si poet-simbol nga ana e të rinjve, pikërisht për dy poezitë e tij emblematike Rinisë dhe Poema e mjerimit. Ai po ashtu është marrë si simbol dhembjeje për të rinjtë; ai nuk arriti të kënaqej as trupërisht, as shpirtërisht: vuajti në fëmijëri, vuajti gjatë shkollimit dhe vuajti edhe në moshën kur do të duhej të rehatohej një herë e mirë. Ishte kjo rruga e një fati të keq, i cili e përcolli deri në ditët e fundit të jetës, për të mbyllur sytë në një spital të Italisë. Edhe prindërit e tij si familje u tërhoqën zvarrë nga Dibra e gjer në Shkodër qoftë duke ikur nga armiku, qoftë për të kërkuar bukën e gojës. Migjeni deri sa vdiq qe tepër i ndjeshëm, hall-ligë e i sëmurë, por pas vdekjes shëmbëllesa e tij u bë uragan i letërsisë - legjendë e vargut të lirë dhe heshtar i prozës simbolike. Jetoi pak, madje shumë pak, mirëpo jetoi aq sa arriti të shndërrohej në ndërgjegje të një krijimtarie shpërthyese me risitë dhe frymën mbushulluese që shkëlqeu. Ai nuk arriti të jetojë tërësisht i lirë si njeri, por mëtesa e tij ishte që ta çlironte vargun poetik dhe ashtu të çliruar t'ia hap rrugën për të depërtuar në botën e madhe jashtë atdheut. Vepra e tij letrare tanimë është përkthyer në mbi 20 gjuhë të botës. Gjatë periudhës shumë të shkurtër krijuese ai shkroi dy vepra letrare: Vargjet e lira dhe Novela të qytetit të veriut. Veprimtari e vogël kjo për nga vëllimi, por shumë e madhe nga pesha, brendia dhe reflektimi i zërit poetik. "E ç'rëndësi ka vëllimi, kur e tëra është aty? E shqetëson fëminia, adoleshenca dhe rinia, prandaj i flet zotit dhe njeriut." (Rinush Idrizi). "... yllësia e vargjeve migjeniane ndriti shekullin e kaluar dhe do vazhdojë të ndrisë edhe në shekujt e ardhshëm ... ai është poet i brezit të ri. i atyre, që sap o kanë marrë lapsin dhe kanë nisur të formëzojnë në vargjet e tyre modeste, jetët, Atdheun ... ëndrrat ... " (Agim Pipa) Jeta e tij ka patur përplasje të brendshme, zëri i së cilës dëgjohet përmes "melodive të këputura" dhe një rebelimi tematik i një lirike, që sot quhet - migjeniane: Pesha e fatit, Këngët e mjerimit, Baladë qytetëse, Nën flamujt e melankolisë, Lagja e varfun, Melodi e këputun, Recital' i malsorit, Blasfemi, Kanga skandaloze, por edhe Kangët e rinisë – si thirje, si shpresë, e të tjera deri te klithma e brendshme: "O grue, që të ndesha në dit'n e fatkobit tem, / Grue a hyjneshë, e mbështjellun n'errsi të natës." Ka dëshmi se ai



kishte një të dashur të cilën në shkrimet e tij e quante Dhembje. Është folur e shkruar edhe per idetë sociopolitike të poetit. Në disa vepra kushtuar Migjenit ka pasur pretendime t'i mveshin këtij poeti ide komuniste, pra ta bëjnë komunist pa qenë fare. Mendimet e tilla i ka hudhur shkencërisht posht edhe Kadareja në veprën Migjeni ose uragani i ndërprerë. Në shkrimet e Migjenit nuk përmenden autorë që kanë qenë ideologë a letrarë të asaj ideologjia. "Nëse është i ndikuar nga Niçe dhe Shopenhaueri,, nuk mund të ketë qenë i ndikuar edhe nga ata që shkruanin sipas modelit Bolshevik. Dhe kur paralajmëron ardhjen e njeriut të ri, është i sigurt se ai njeri do të jetë një qenie që pa dhembje e sentimentalizëm e me grusht graniti do ta mposhtë te keqen. Shtytja krijuese e tij gjendet në zhgënjimin, pesimizmin, rezignimin, dëshpërimin e tij, në raport me realitetin shoqëror, e jo në literaturë bolshevike." (Mustafa Ferizi). "Përkundër, fryma e adhurimit të Niçes është një fakt që gjendet me tepri në tekstet e autorit. Ky fakt nuk zbeh vlerën e krijimtarisë, madje në një kuptim i jep asaj dimensione reale..." (Behar Gjoka). I cituam këtu pak mendime me qëllim që të shikojmë edhe anën tjetër të shkrimeve tjetër fare nga ato që kanë mbushur faqe të tëra të literaturës për ta shpërfaqur sa më reale figurën e këj njeriu të madhe, këtij kolosi të letrave shqipe të periudhës së modernizmit në letërsi. Ai ishte vërtet modern edhe në jetë siç ishte në shkrime duke e mveshur e ushqyer qenien e vet me stoicizëm ndaj sëmundjes vdekjeprurëse e me dashuri ndaj jetës, ndaj njerëzve, në përgjithësi pa dallime e kulmërisht e donte shume edhe njerëzimin me emërtimin univers. Në asnjë rast Migjeni nuk është përfolur me konotacione negative nga ana e shkrimeve në gjuhë të tjera, siç ka ngjarë sa e sa herë me njerëz tanë të mëdhenj. Pas vdekjes fizike të Migjenit fillon pavdekësia e tij, ka thënë Nasho Jorgaqi. Vepra e bëri të pavdekshëm, ajo e futi dhe e bëri të pashqitshëm në mbamendjen e kombit. Ajo është kundruar, analizuar dhe vlerësuar nga çdo anë, duke krijuar vepra të tëra nga autorët me eminentë të letrave tona. Vepra letrare e këtij dhembshuraku, në çerekun e pare të shkullit të kaluar e ka krijuar kthesën në letërsinë shqipe. Ajo ka tronditur vrullshëm letërsinë tonë, duke u bërë edhe shembull frymëzimi për letrarët e rinj. Ai (krahasueshëm me Poradecin) mbetet një prej figurave letrare më të shquara në kështjellën e poezisë shqipe, në kapërcyllin drejt një letërsie përmbajtësisht e frymërisht më të re. Poezinë ai e njohu jo vetëm si frymëzim por edhe si art. "Kryesorja në art është artistikja që me talent të zbulojmë esencën shoqërore, morale e psikologjike të jetës intime, të njerëzve dhe të marrdhanieve të tyre." (Letër dërguar "Botës së re") Migjeni e deshi shumë njeriun (fëmijën e veçmas të varfërin), lirinë, atdheun, letërsinë, arsimin natyrën. Vepra e tij letrare është thelbësisht një shpërthim vullkanik, më tepër i brendshëm por jo vetëm me dashuri të brendshme. Në veprën e tij jeta hyri si një mendim i ngulët, që u bart nën motivin e shqetësimit të thellë për dinjitetin njerëzor. Njeriu ishte për të universi konkret e i pranishëm, ishte një vetvete... (Rinush Idrizi). i paharruar për ata që e kanë njohur, për ata me të cilët ka kaluar ditët-shkollore, ose ka bashkëjetuar e veçmas i paharrur për nxënësit dhe komunitetin e Vrrakës e të Pukës, ku ka punuar si mësues. Ata që e kanë njohur dhe kanë patur kontakte me te, kanë folur me pathos e me mall për personalitetin e tij. Tekstet e disa poezive të tij janë shfrytëzuar nga kompozitorë për të bërë kompozime muzikore.

> Dibra, vendlindja dhe vendjetesa e prindërve të tij, duhet ta shënojë këtë përvjetor, për ta bërë Migjenin akoma më të përkujtuar. Na takon ne ta kujtojmë dhe t'i këndojmë veprës dhe shëmbëlltyrës së tij dhe për çdo përvjetor t'i ndezim familjarisht nga një qiri...

Dhjetra shkolla e institucione kulturore e artistike mbajnë me krenari emrin e tij. Edhe pseudonimi i tij MIGJENI i krijuar prej tij është përdorur e përdoret nga prindër anekënd trojeve shqiptare për të emërtuar fëmijët e tyre me ketë sintagme shume të bukur. Asnjë shkrimtar si ai nuk ia ka dalur të prek emocionalisht pikat më të ndjeshme të jetës e të botës shqiptare. Dhe ky fenomen akoma është në ngritje. Prandaj ka lindur shumë me vend ideja që edhe Dibra, (vendlindja dhe vendjetesa e prindërve të tij me Krahinën e saj) ta shënojë këtë përvjetor, për ta bërë Migjenin akoma më të përkujtuar. Na takon ne ta kujtojmë dhe t'i këndojmë veprës dhe shëmbëlltyrës së tij dhe për çdo përvjetor t'i ndezim familjarisht nga një qiri, kurse si shoqëri t'i ngrisim ndonjë përkujtimore apo t'ia përkujtojmë emrin dhe veprën e tij me emërtime të ndryshme të ndonjë institucioni, asociacioni apo shoqate.

Peje 13 tetor 2013

BULQIZË

Sindikatat kërkojnë pallatin e kulturës

Pronësia mbi Pallatin e Kulturës në Bulqizë, ka çuar në një përplasje të fortë mes Konfederatës Sindikale të Shqipërisë me bashkinë e këtij qyteti. Rrënjët e këtij konflikti janë të hershme kur me vendimin civil nr. 341 datë 04.10.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, i lënë në fuqi dhe nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendim nr. 217 datë 24.01.1996, që detyron palën e paditur Bashkinë Bulqizë, të lirojë ambientet bibliotekë dhe 4 zyra që ndodhen në ambientet e brendshme të Pallatit të Kulturës kati i dytë. Mbi bazën e këtij vendimi, përmbaruesi privat Shpëtim Allamani, bazuar në "Urdhërin e Ekzekutimit" të vendimit civil nr. 341 datë 10.04. 2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqëor Dibër, kishte vënë në dijeni palën kreditore KSSH-në dhe atë debitore Bashkinë Bulqizë, që më 14.10.2013, të bëhej ekzekutimi vullnetar i dispozitivit të këtij vendimi. Por, ekzekutimi i këtij vendimi ka hasur në kundërshtimin kategorik të bashkisë Bulqizë, pasi bashkia disponon çertifikatën e pronësisë mbi Pallatin e Kulturës, lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Bulqizë, me nr.288841 datë 25.09.2013, e cila bazohet në një vendim të Këshillit të Ministrave nr. 5 datë 04.01.2013 "Për miratimin e pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi të Bashkisë Bulqizë. Ndërkohë KSSH-ja bazohet në Dekretin e Presidentit nr.204 datë 05.06.1992, i cili është shfuqizuar me ligjin nr. 8340 datë 06.05.1998. Nga ana e KSSH-së në këtë debat ka marrë pjesë edhe presidenti, Kolë Nikollaj, i cili pasi nuk ka mundur të gjejë gjuhën e mirëkuptimit me bashkinë, ka kërkuar nga përmbaruesi privat zbatimin forcërisht të urdhërit të ekzekutimit.

Ndërkohë ka patur edhe paqartësi në zbatimin e urdhërit të ekzekutimit, pasi sipas këtij urdhëri duheshin liruar biblioteka dhe 4 zyra të pa specifikuara kur në katin e dytë ndodheshin 6 zyra dhe mungonte një plan-vendosje e zyrave që duheshin liruar. Këtë situatë e ngatërronte edhe më keq, kryesindikalisti Nikollaj kur deklaronte se duhet liruar i gjithë kati i dytë, gjë kjo që nuk konfirmohej nga vendimi gjyqësor dhe urdhëri i ekzekutimit. Kryesindikalisti Nikollaj, duke parë se është krejt e pamundur zbatimi vullnetar i këtij urdhër-ekzekutimi, vijonte të kërkonte me insistim nga përmbaruesi privat , Shpëtim Allamani, lirimin forcërisht të ambienteve. Madje krejt i tensionuar, kryesindikalisti Nikollaj, forcërisht ka thyer derën e bibliotekës së qytetit minator të Bulqizës, duke lënë një shije të hidhur jo në respekt të figurës së tij. Në këtë moment ka ndërhyrë policia bashkiake, e cila nuk ka lejuar veprimet e mëtejshme të përmbaruesit për hapjen e zyrave të tjera forcërisht, pasi bashkia dispononte certifikatën e pronësisë, e cila ligjërisht i jep asaj pronësinë mbi këtë ndërtesë. Për rreth 4 orë kanë vijuar përplasjet e mosmarrëveshjet mes palëve, ku më në fund është bërë një përpjekje edhe nga policia e rendit në mbështetje të përmbaruesit privat, por përplasja me policinë bashkiake dhe komunitetin, i çoi palët në dialog, ku u ra dakord mes tyre shtyrja për 10 ditë e ekzekutimit të këtij vendimi.

Ngjarja e rëndë la një shije akoma edhe më të hidhur edhe për faktin se ndodhi një ditë para festës së "Kurban Bajramit" kur dihet mirëfilli se banorët e trevës së Bulqizës, i nisin në këtë ditë festimet me therjen e kurbanëve. Edhe pse me rastin e kësaj feste të madhërishme të "Kurban Bajramit" u kërkua që konflikti të shtyhej, kryesindikalisti Nikollaj, nuk dha asnjë lloj mirëkuptimi në këtë drejtim. Ndërkohë disa minatorë i kujtuan dhe kërkuan kreut të konfederatës që të kthejë shikimin edhe nga minatorët sindikalistë, jo vetëm nga pronat e sindikatës, pasi hallet dhe problemet e tyre skanë të sosur, ku ndër më kryesoret mbeten kushtet e sigurisë në punë për ta, përfshirë edhe rritjen e pagave. Kështu ata kërkuan që kryesindikalisti të ndërhynte për të rikthyer në punë katër minatorët që prej katër muajsh janë pushuar nga puna padrejtësisht nga ana e firmës.

Janë sindikalistët minatorë të Bulqizës, që nën drejtimin e kryesindikalistit Nikollaj, tha ish kryesindikalisti i kësaj miniere, Dilaver Përkoxha, që realizuan në fillimkorrikun e 2011-tës, grevën 3 mujore të kulmuar me dy greva urie njëra prej të cilave 1500 metra brenda në nëntokë, pikërisht për kushte të sigurisë në punë dhe rritje pagash dhe nuk fituan asgjë, përveçse rritjes së reputacionit për KSSH-në dhe vetë kryesindikalistin Nikollaj. Sipas Dilaver Përkoxhës, dy sindikatat; si konfederata dhe ajo e pavarur, nuk po i mbrojnë sa e si duhet minatorët, për të mos thënë fare. Kjo pasi kushtet e sigurisë në punë për ne minatorët, vijojnë të jenë tejet skandaloze, përfshirë edhe pagat që nuk kanë njohur rritje prej më shumë se pesë vitesh. Përkundër kësaj, në të gjitha rastet e aksidenteve të ndodhura në minierë me humbje jetësh të shokëve tanë minatorë, fajet e përgjegjësitë janë mbuluar së bashku me viktimat dhe në asnjë rast nuk ka dalë përgjegjësia e vërtetë. Katër minatorët e larguar pa asnjë faj nga puna, vijon në fjalën e tij, Përkoxha, po vuajnë në varfëri të tejskajshme dhe kryesindikalisti në vend që të vijë në Bulqizë dhe të negociojë me firmën për rikthimin e tyre në punë, për tu dhënë mundësi që edhe ata të festojnë me fëmijët e tyre "Kurban Bajramin", ai vjen e interesohet për tu marrë atyre edhe Pallatin e Kulturës.

Hysen Likdisha

intervistë

Intervistë e pabotuar me skulptorin dibrano-tiranas Muharem Turkeshi:
Nuk e ndaj dot Dibrën e Madhe nga Tirana

Qytetet tona duhet të jenë **galeri arti**: Sa më **shumë vepra** nën qiellin e hapur

Nga **REXHEP TORTE**

Skulptorin Muharem Turkeshi nuk është më mes nesh. Autorin e shtatores së Skenderbeut në Dibër, të Ismet Jasharit në Orizare, të shtatores së trimëreshës shqiptare Sulltanja në Gostivar, dhe të qindra veprave të tjera të ekspozuara anekënd Shqipërisë, e takuam kohë më parë në Tiranë dhe zhvilluam me të një bisedë të ngrohtë, familjare, të çiltër, siç ai dinte të bënte. Për arsyet shëndetësore të miat nuk kisha mundur ti shihja materialet e intervistës së zhvilluar me të, por rasti i ndarjes nga jeta të skulptorit Turkeshi, më detyroi që bisedën e fundit me të ta ndaj me lexuesin. Sepse Muharrem Turkeshi nuk ishte skulptori i ideve politike, por ishte skulptori që i merrte idetë e veta nga zgjuarsia, tradita dhe kultura popullore. Ai ishte skulptori i popullit.



PRINDËRIT E BRAKTISËN DIBRËN E MADHE NGA DHUNA SERBE

Skulptori Muharem Turkeshi i lindur në Tiranë në vitin 1933 por me prejardhje dibrane , tregon plot mallëngjim se kryengritja e dibranëve në vitin 1913 kundër okupimit serb dhe Lufta e Parë Botërore, ishin shkaku i eksodit të prindërve të tij nga Dibra e Madhe për në Tiranë. Siç kanë treguar prindërit dhe fisi i tij kjo luftë serbe ndaj shqiptarëve ka qenë me qëllime shfarosëse dhe shkatërruese për identitetin shqiptar, për ndjenjën atdhetare dhe për dinin dhe imanin shqiptar, duke krijuar kriza dhe dyndje të mëdha.

Ishte kohë plot fatkeqësi, thotë Muharem Turkeshi, kur fëmijët kishin mbetur jetimë, pasi hanxharët serbë ua kishin vrarë prindërit. E vetmja mundësi shpëtimi për këta bonjakë ishte rruga e mërgimit për në thellësi të tokave shqiptare. Këtë rrugë e ndoqi edhe Ramiz Turkeshi, i cili vajti deri në Durrës. Një pjesë e familjes sonë asokohe kishte vendosur të bëjë përpjekje të rezistojë e të mos e lëshojë vendlindjen, por ishte gjë e pamundur dhe ky emigrim vazhdoi, kështu që pas disa vitesh nga gjendja e vështirë në Dibër të Madhe, u detyruan të emigrojnë në Tiranë në vitin 1924 edhe vëllezërit e tjerë të familjes sonë si Ismeti, Nebiu, së bashku me gjyshin tim Bajram dhe gjyshen Shiqirije Turkeshi. Të gjitha familjet dibrane të emigruara në Tiranë te trashëgimtarët e tyre kanë përcjellë mikpritjen e ngrohtë të banorëve të atëhershëm të Tiranës, ku gjetën mbështetje të jashtëzakonshme edhe pse më shumë shpirtërore se sa materiale, sepse edhe kushtet ishin të tilla. Në Tiranë dibranët gjetën strehën dhe dyert e hapura, siç ishin familja e Shaqir Reçit, Ibrahim Shabës, familja e valltarit maestro Besim Zekthi etj. Dibranët mundoheshin vetë ta sigurojnë ekzistencën, me duart e veta e për të mos u bërë barë e nikoqirëve. Shumica e dibranëve kishin si mjeshtëri zejet e ndryshme, por ishin edhe mjeshtër të kultivimit të zarzavateve dhe prodhimeve të ndryshme bujqësore, me çka siguronin edhe idarellëkun e tyre aq të domosdoshëm.

Edhe babai im Ismet Turkeshi ishte bahçexhi shumë i vyer. Ai merrte tokën me qira dhe me punë dhe djersën e tij vit pas viti krijonte dhe siguronte ekonominë shtëpiake imediate. Kjo vazhdoi deri në vitet 1943-44 kur mbi bazën e reformës agrare në Shqipëri , atij iu dhurua toka për ushtrimin e kopshtarisë, të cilën e ushtroi me zell deri në vitin 1962 kur edhe ndërroi jetë.

KARVANET SILLNIN MALLRA DHE MBANIN LIDHJET ME DIBRËN

Komunikimi i karvaneve tregtare ndërmjet Dibrës së Madhe dhe Tiranës ishte shumë i zhvilluar. Ky komunikim ishte i lashtë dhe kalonte shtigjeve këmbësore të Rrugës së Arbërit. Nga Dibra e Madhe sillnin gështenja, arra, bylmetëra, patate, pastërma dhe gjëra artizanale. Kjo rrugë zgjaste dy ditë udhëtim me kuaj dhe mushka të ngarkuara me mall. Hani i parë ku pushonin dhe këndelleshin karvanet ishte Hani i Sinës, pastaj rruga vazhdonte luginave malore, pas malit të Skenderbeut, te Guri i Bardhë, ndërsa pjesa më e rrezikshme ishte vendi i quajtur Shkalla e Tujanit, rrugë e gdhendur në shkëmb graniti që kalonte shpatit të malit, poshtë së cilës ishte gremina në të cilën po të rrëshqiste kali ose mushka me mall nuk mund të shpëtonte gjallë. Pas kësaj rruga kalonte nëpër Bajram Curr dhe arrinte në Tiranë te Pazari i Vjetër ku shkarkohej malli, ndërsa kuajt e mushkat pushonin te Hani i Bajram Kallmetit ku karvani bënte stacionimin. Të zotërit e karvaneve pasi shisnin mallrat e tyre, me paratë e fituara nga Tirana për në Dibër të Madhe blinin sheqer, oriz, vajguri, vaj ulliri, tekstile dhe prodhime mesdhetare. Këto karvane veç mallrave sillnin edhe lajme duke mbajtur gjallë lidhjet e ndërsjella mes Dibrës së Madhe dhe Tiranës.

Janë të njohura edhe sot e kësaj dite familjet e shquara nga Dibra e Madhe të vendosur në Tiranë si familjet Tërshana, Erebara, Dibra etj.

Ky emigracion i detyruar dhe masiv i dibranëve në Tiranë asokohe e shtoi dukshëm numrin e banorëve, duke sjellë edhe urtësinë, doket, profesionet dhe kuzhinën e pëlqyer dibrane. Kjo prani kaq e madhe e dibranëve në Tiranë bëri që disa dibranë të zënë vende të rëndësishme edhe në postet udhëheqëse fetare dhe administrative, kështu që dibranët patën ndikim të konsiderueshëm edhe në shpalljen e Tiranës kryeqytet të Shqipërisë.

Të dhënat historike flasin se edhe komunikimi fetar dibran me sjelljet e tij ishte i emancipuar dhe solidar. Kjo pati ndikim pozitiv në këtë drejtim. Dibranët shërbenin në institucionet ekzekutive të shtetit dhe në ato fetare në fusha të ndryshme. Kështu lindën figurat e shquara si arkitekt Gani Strezimiri, Irfan Tërshana etj.

DËSHIRA PËR ARTIN MË TROKITI HERËT

Duke folur për hapat e para drejt artit, skulptori Muharem Turkeshi, tregon se, "shijet e para për të bukurën mu fiksuan nga pazaret e begatshme me mallra të Dibrës së Madhe dhe Tiranës. Qysh i vogël vëmendjen time e tërhiqnin vendet ku shiteshin bilbilat, vorbat dhe shtambat prej qeramike. I shikoja me gëzim dhe me kureshtje të madhe. Më kënaqnin edhe prodhimet e zejeve, siç ishin opingat e punuara prej lëkure.

Edhe loja e fëmijërisë sime nëpër kopshtin plot zarzavate, sidomos pas ujitjes, kur më joshte balta e butë për të bërë figurina të ndryshme. Kjo ma nguliti në mëndje dekantimin e argjilës së praruar. Të gjitha këto mbresa u inçizuan në mendjen time dhe dëshirën time, e të dyja së bashku shpërthyen kur në vitin 1947 fillova një kurs dizajni. Puna dhe talenti im në këtë kurs më bëri të shquar te dashamirësit dhe miqtë e mi, të cilët më përgëzonin dhe entuziazmonin, duke përsëritur se unë e kam vendin për në liceun artistik. Kjo ishte vendimtare që ngjalli vendosmërinë time për tu bërë nxënës në Liceun Artistik të Tiranës, që sapo ishte themeluar si vazhdimësi e Shkollës së vjetër të vizatimit.

Pas kryerjes së Liceut Artistik shkova të punoj në një kooperativë artizanatesh ku punonin shumë mjeshtër të talentuar. Me themelimin e Institutit të Lartë të Arteve në vitin 1959, u regjistrova dhe mbarova grupin e skulpturës. Pas kësaj edhe pse më caktuan të shkoj të punoj në Kinostudio, unë sërish preferova të shkoj të punoj në kooperativën artizanale.

Gjersa isha nxënës i Liceut Artistik, një mjeshtër pedagog hungarez, autor i derdhjes së monumentit të Skënderbeut në bronz në Krujë, së bashku me pedagogun Janaq Paço autorin e monumentit të Skënderbeut në Prishtinë, u ndalën para punimit tim në plastikë dhe shprehën shumë fjalë miradie.

Gjithmonë ndjeja sikur më shumë filozofoja se sa ekzekutoja idenë në plastikë. Ishim pa eksperiencë dhe pedagogët e ndryshëm sillnin mendime të ndryshme. Odhise Paskali një ndër pedagogët më të mirë, asnjëherë nuk na ndërpriste gjatë procesit të punës, por këshillat e nevojshme na i jepte secilit veçmas në fund të orës së mësimit.

Pasioni dhe puna e vazhdueshme më jepte gjithnjë e më shumë rezultate. Moto të punës e kisha thënien e Da Vinçit, se talenti përbën 90 përqind punë.

Në kohën e Liceut Artistik ishte mendimi të shkoj të studioj jashtë, por nga makinacionet me biografitë e kohës kjo nuk u realizua.

Në kohën kur isha në majën e krijimtarisë gumëzhinte arti i realizmit socialist, tematika e politizuar, proletariati, pompoziteti i luftërave dhe i punës në sistemin socialist. Unë nuk mbeta pa u influencuar nga kjo, por megjithatë në shpirtin tim, gumëzhinte tema familjare, edukimi familjar, shoqëror. Këto ishin tema më ngacmonin, i bëja me dëshirë dhe sukses, e që më vetonin nga pompoziteti e politika. Kur kompozoja ndonjë valle në skulpturë, personalitetet udhëheqëse të kulturës më thoshin pse merresh me këto "karikaturash", krijo ndonjë temë heroi. Por shpirti im nuk ndahej nga dëshirat e mia. Punimet më të shquara të veprimtarisë sime janë temat apolitike, ato të përditshmërisë, fëmijët si lulja më e bukur e jetës. Temën e fëmijëve e ilustroja edhe në revistën "Fatosi" asaj kohe.

Në Galerinë e Arteve në Tiranë ruhet portreti në bronz i Etlevës. Kësi portretesh të fëmijëve kam edhe në galerinë e Vlorës, Lushnjës etj. Kjo temë intime më çonte edhe në veprimtarinë artizanale të vendit. Më shumë më pëlqente një shtambë apo vazo e bukur se sa një portret heroi i punës. Kështu arrita të kryej punimet që janë ekspozuar në galeritë e arteve si "Poçari", "Daj Ceni i Priskës", "Isa Boletini", "Idriz Seferi", "Said Najdeni", "Ibe Palikuqi", "Karadaku", si dhe Monumentin kombëtar Varrezat e dëshmorëve në Librazhd, Monumentin e minatorit në Memaliaj, Kompleksi monumental i minatorit në Valijas.

Punimet e mia kanë zënë vend në Enciklopedinë botërore të artizanatit, ku përfaqësohet Shqipëria në fushën e arteve figurative. Punimet e mia janë ekspozuar në ekspozita kolektive në Turqi, Izrael, Kroaci, Greqi, Egjipt etj."

SHTATORJA E SKENDERBEUT, E ISMET JASHARI DHE SULLTANJA MA NGROHIN SHPIRTIN

Në demokraci ne artistët ndjehemi plotësisht të çliruar nga ndjesia e telekomandës moniste që ushtrohej në krijimtarinë tonë .

Hapja e kufijve ma dha mundësinë që në Dibrën e Madhe ta punoj shtatoren e Skënderbeut, në Orizare shtatoren e Ismet Jasharit dhe në zonën e Kërçovës shtatoren e trimëreshës shqiptare Sulltanja. Autorësia ime në këtë tre vepra skulpturore ma ngrohën shpirtin tim krijues.

Unë për herë të parë në Dibër të Madhe kam ardhur në vitin 1990. Tani vazhdoj të vij rregullisht edhe disa herë në vit, së bashku me bashkëshorten time Afërdita dhe me vajzat tona Etlevën, Ilirën dhe Emirën, të cilat e kanë në shpirt artin figurativ dhe muzikën.

Vendosja e monumenteve të Skënderbeut në Prishtinë, Dibër dhe Shkup, paraqet një etapë të emancipimit politik dhe kulturor të shoqërisë shqiptare.

Në qytetet tona duhet të ketë sa më shumë kësi veprash arti të vendosura nën qiellin e hapur, për t'i bërë qytetet tona si galeri arti. Nuk ka gjë më të bukur dhe prezantuese kur vizitorit duke shëtitur nëpër një qytet i krijohet mundësia të shpreh edhe vepra arti, që shërbejnë si ambasadore të vazhdueshme të prezantimit të kulturës sonë.

Tirana dhe të gjitha qytetet shqiptare duhet skulpturave tua japin vendin e tyre në zgjidhjet arkitektonike.

Ndërtimi i gradaçelave të larta është egërsia më e madhe e shëmtimit që ia bëjmë ambientit ku jetojmë", na tha në fund të bisedës skulptori Muharem Turkeshi.

Biografi e shkurtër

Muharrem Ismet Turkeshi u lind në Tiranë më 25 Maj 1933. Punoi në fillim si dizenjator në Muzeumin Arkeologjik Kombëtar. Mbaroi Liceun Artistik "Jordan Misja" në vitin 1952 në degën skulpturë. Në vitin 1968 mbaroi studimet në Akademinë e Lartë të Arteve. Punoi 40 vjet në ndërmarrjet artizanale, ndërkohë në vitet '80-'90 dha mësimë skulpture në shkollën e mesme artistike "Jordan Misja". Punoi me shumë dashuri, në mënyrë të veçantë fabulën popullore shqiptare. Është autor i shume monumenteve në të gjithë Shqipërinë dhe Maqedoninë. Është themelues dhe shumë i njohur në qeramikën me motive nga fabula popullore.

Ka marrë pjesë në shumë ekspozita kombëtare dhe ndërkombëtare si në konkursin kombëtar në Galerinë e Arteve në 1963, në ekspozitat ndërkombëtare në Vjenë (1970), Turqi (1975), Siri (1976), Zagreb (1997), Athinë (1998), etj.

Ka fituar çmimin e parë në konkursin kombëtarnë Galerinë e Arteve në vitin 1985 dhe çmimin "Naim Frashëri" në konkursin e skulpturës aplikative.

Është autor i shtatores së Skënderbeut në Dibër, autor i shtatores së Ismet Jasharit në Orizare të Kumanovës, autor i skulpturës së Sulltanes në Gostivar si edhe autor së heroinës Ibe Palikuqi.

Muharrem Turkeshi ndërroi jetë më 15 shtator 2013 në Tiranë, dhe u përcoll për në jetën e përtejmë në prani të familjarëve nga Dibra dhe Tirana si edhe në praninë e artistëve, miqve dhe shokëve të shumtë.

Rruga e Arbërit nr. 90

recensë

SHËNIME PËR LIBRIN E DOKTOR ISLAM CANIT
"ÇIDHNA DJE, SOT, NESËR", Tiranë, 2012

Çidhna *që na jep* **nder** *të gjithëve*

Nga: **Prof.dr. Hajri SHEHU**

Unë nuk e kam parë e shëtitur gjithë Çidhnën. Si unë, ndoshta edhe të tjerë. Me librin e doktor Islam Canit, tashmë edhe e kemi parë e shëtitur. Të gjithën. Çidhnën e të gjitha kohëve. Me librin e doktor Islam Canit, Çidhnën e kemi mu përpara syve. Me visoret (peizazhet) e saj të bukura: me male dhe me kodra, me lugina dhe me qafa, me suka dhe me fushë, me pyje dhe me zabele, me përrenj dhe me kroje, me mollë dhe me rrush, me diell dhe me dritë - me gjithçka të mirë që toka ka për njerëzit. Me librin e doktor Islam Canit kemi mu përpara syve të gjithë njerëzit e Çidhnës: burra e djem trima, gra e vajza burrnesha, fëmijë të hedhur e të shkathët. Tek të gjithë sheh atë njeriun e zgjuar, para të cilit duhet të përgatitesh të jesh po aq i zgjuar e i hollë, po deshe të hysh në bisedë me të. Unë e kam parë dhe shijuar këtë zgjuarsi. Do ta them pak më tej.


Doktori flet për vise e për visore. Por edhe për rrugë e për shtegtime. Dhe, a e dini deri ku i çon çidhnakët? Deri në ishullin grek, Kythnos! Jo me ikjet e tanishme. Herët. Shumë herët. Ka bërë rrugë doktori deri atje. Jo për kureshtje, por për vërtetesë. Ka kërkuar Odisenë dhe ishullin Kidhna. Dhe e ka gjetur Kidhnën. Kidhnën e atjeshme. Në libër na flet për Kidhnën e këtushme, për Çidhnën e tij. Doktori nuk u ndahet udhëve. Ai do të bëjë udhë përsëri për në Çidhën. Pas disa vjetësh doktori do ta bëjë udhën për në Çidhën në "Rrugën e Arbrit". E pret, siç e presim të gjithë ne. Ajo do të jetë për librin "Çidhna nesër".

Në librin e doktor Islamit, bukuria e Çidhnës shkon një me një me historinë e saj. Dëshmitarë të kësaj historie janë sot emrat e vendeve (toponimet): Gjuri i Luftës, Fusha e Topit, Kalaja e Stelushit, Kalaja e Volezes, Thekanushi, Ferra e Pashës... Dhe historia shkon një me një me bëmat e njerëzve të saj (kujtojmë Sali Demirin, Shaban Lushën, Osman Pacin, Hoxhë Kutën, Selim Nokën, Haxhi Nokën, Murat Kaloshin, Riza Lushën, Dervish Lushën, Selman Alinë etj.). Dhe me kuvendet e burrave të mençur. Në Çukë të Arrasit, te Ferra e Pashës etj. Dhe, kuvendi më i rëndësishëm ishte "Kuvendi i burrave të dheut", ku merrnin pjesë edhe paria, edhe vegjëlia. Ishin kuvende më demokratike e më popullore se ato të Athinës së lashtë. Kuvendet, - thotë autori, - bëheshin në vende të shenjta. Kjo do të thotë se kuvendet dhe vendimet që merrnin ato vlerësoheshin si të shenjta. Për besa-besë. Për punë të mëdha. Për zgjidhje të mëdha.

Libri na çon në retrospektivë, në të kaluarën – e largët e jo të largët, te njerëzit e shkuar, te vepra e tyre, te lufta e tyre për liri e për pavarësi – si pjesë e së tërës, si pjesa bashkë me të tërën. Doktori kërkon me dhembje të thellë Oenën e lashtë, Oenën e harruar, qytetin ilir në Çidhën. Me dhembje të thellë kujton ata mijëra që u prenë nga shpatat e pushtuesit. Me krenari të natyrshme atdhetare kujton Fushën e Thatë të Çidhnës, ku Skënderbeu me trimat e tij kryqëzoi shpatat për të parën herë me pushtuesin. Autori rreshton beteja e fushëbeteja. Në të gjitha këto, lexuesi nuk sheh, thjesht Çidhnën e vetëm Çidhnën. Sheh shumë më shumë se kaq. Sheh Shqipërinë.

Në librin e doktor Islamit, bukuria e visoreve të Çidhnës shkon një me një me njerëzit e saj e me punën e njerëzve të saj. Janë ata njerëz që çanë shkëmbinjtë e gjallë e të stërmëdhenj për të hapur kanalin për ujërat e Setës. Dhe kanali i pruri ujërat e kristalta të Setës deri përkëtej Drinit, te Fusha e Thatë. Kur egërsohet, Seta e pushton Drinin. Ajo vjen gjithë rrëmbim e uturimë. Në kanal ajo erdhi e shtruar dhe e qetë.

Atëherë u bënë shumë reportazhe. U fol shumë në radio. Por, përpara asaj pune vigane, reportazhet e gazetave dhe të radios ishin të zbehta. Aty ka histori të mëdha pune e trimash. Si në legjenda. Duhej mposhtur e pushtuar shkëmbi. Sali Noka e të tjerë si ai do të lidheshin me litar për të hapur gropat për mina. Ku i kanë vënë këmbët ata njerëz para se të bëhej gjurmëtorja (traseja) e



kanalit?! Po më tej e më pas? Si lëviznin ata njerëz e ku strehoheshin kur plasnin minat gjëmimtare e thërrmohej shkëmbi? Të Çidhnës ishin. Nga Çidhna. Nga Dibra. Doktori na i sjell në libër ato ditë pune e ato çaste gëzimi kur erdhi uji, si të kishte ardhur sot. Lexoni në libër ato fjalët e asaj gruas së moshuar çidhnake, kur e pa dhe e preku ujin në kanal. Ishin fjalë zemre e mahnie. Po pse, a vetëm kanali i Setës qe punë e vepër e madhe? Jo. Shumë e më shumë. Edhe qindra e qindra hektarë pemëtore përtej e përkëtej Drinit. Fotografia, që është pjesë e kapakut të librit është dëshmitare e atyre hektarëve dhe e fjalëve të doktorit.

Në Çidhën respektohet shumë njeriu i punës. Në faqen 207 të librit lexuesi njihet me zanatçinj të përmendur dhe me vlerësimin e autorit për ta dhe për punën e tyre. Por, për dikë që nuk e di, le të mësojë sa shumë vlerësohet e respektohet farkëtari i katundit e me kë barabitet ai.

Çidhnakët janë të ndershëm. Nderi dhe ndershmëria janë tipari numër një i tyre. Te nderi dhe te sedra as nuk të prekin, as nuk të lejojnë t'i prekësh. Nderi (në kuptimin më të gjerë të fjalës) dhe njeriu i ndershëm përnderohen. Shih në libër, p.sh., citime nga kanuni i Skënderbeut.

Diku nga fillimi i këtyre shënimeve të mia për librin thashë se çidhnakët janë të zgjuar. Fjalët e thëniet e mençura të burrave të Çidhnës njihen përtej Çidhnës e përtej Dibrës. Abaz Kaloshi, Adem Hoxha, Ali Krrashi, Demir Lusha, Dervish Lusha, Elez Kaloshi, Elez Noka, Ferë Doka, Halil Pashnjari, Hamit Cerri, Hazis Raska, Mane Kacani, Mudë Hasi, Qazim Noka, Qazim Përnezha, Ramadan Hoxha, Ramadan Krrashi, Riza Lusha, Sadin Tola, Sefedin Doçi, Selim Kaloshi, Selim Leshi, Selim Noka, Sulë Rusi, Tahir Zogu, Vesel Lusha, Vesel Prifti etj. e kishin fjalën e tyre gur të rëndë e gur themeli. Thëniet e tyre meritojnë të mblidhen e të botohen në një libër si sentenca, si fjalë fluturake, si aforizma (kujtojmë, p.sh., bisedën e Demir Lushës me vezirin e Shkodrës). Në parantezë: Të gjithë emrat që citohen në këto shënime, ose përmenden në librin e doktor Islamit, ose janë nga ç'kanë thënë të tjerët për Çidhnën, ose unë i kujtoj nga leximet e mia e bisedat që kam pasur me çidhnakë, me bashkëfshatarët e mi etj. Jam i bindur që duhet të ketë edhe shumë çidhnakë të tjerë të urtë. Libri na çon te kjo urtësi e tek odat e urta të Çidhnës, me bisedat e replikat e tyre të holla. Libri na çon edhe tek antropologjia e çidhnakëve e për çidhnakët (shih, p.sh., në f. 186). Edhe te pleqësia e tek interpretimet e holla kanunore e zgjidhjet e mençura të mosmarrëveshjeve (kujtojmë interpretimet e zgjidhjet e Selim Nokës e të Dervish Lushës). Për njerëzit e sotëm doktori do të shkruajë në librin e ardhshëm. Që të kthehem te fillimi i thënies sime: Unë e kam parë dhe shijuar vetë këtë zgjuarsi. Kam njohur shumë çidhnakë.

> Libri është si një enciklopedi për Çidhnën. E, jo vetëm për Çidhnën. Më së pari, sepse të mirat gjithmonë janë përcjellë e përcillen më tej. E mira shtegton. Edhe në hapësirë, edhe në kohë. Dhe Çidhna ka përcjellë e rrezatuar gjithnjë. Kujtojmë jo vetëm Skënderbeun, por edhe Kuvendin e Arrasit. Në libër përmenden edhe shumë ngjarje të tjera madhore.


Kam njohur edhe fëmijë. Madje, shumë. Në vitin 1966, pas një viti pune në Peshkopi, më transferuan për pak kohë mësues në shkollën 7-vjeçare të Fushë-Alies. Mësues. Para nxënësve. I vështroja e njëri më dukej më i shkathët se tjetri. Në oborr kur luanin. I vështroja dhe njëri më dukej më i zgjuar se tjetri. Në klasë.

Çidhnakët janë trima. Në librin e doktorit, për trimërinë flasin fushëbetejat. Unë e kam parë dhe shijuar trimërinë e çidhnakut te fëmijët. Përsëri si mësues i vitit 1966. I vështroja nxënësit dhe njëri më dukej më trim se tjetri. Kur? Kur më përshëndesnin në mëngjes me atë përshëndetjen "Mirëmëngjes, mësues!". Ishte një përshëndetje shumë krenare e shumë trimërore. Edhe ngritja e dorës kur përshëndesnin. Edhe intonacioni kur flisnin. Ata donin medoemos ta tregonin veten dhe trimërinë. Në Çidhën, kur nuk të njohin e nuk të dinë, kur je djalë a fëmijë, të tjerët të drejtohen me "I kuj je mor traim? Kah shkoke kshtune mor traim?" Atje, në Çidhën, fëmijët nuk qajnë kur rrëzohen në lojë a diku tjetër, madje edhe kur gërvishten a gjakosen e në njëfarë mënyre shohin gjak, sepse më të mëdhenjtë, sidomos nënat, u thonë në atë çast: "U, m'u rraitsh! Ho se rraitesh!" Dhe ata nuk qajnë se rriten! Me siguri, ata nxënësit e mi i kishin përvetësuar këto shprehje me mendje dhe me zemër. Nëse tre janë faktorët që përcaktojnë karakterin e njeriut, atëherë të tre veprojnë në Çidhën: trashëgimia (gjenet), mjedisi, edukata. Dhe ajo që kam menduar atëherë ka qenë: "Këta fëmijë, me këta sy e me këto duar, mund ta marrin botën në krahë." Nëpër rreshta e midis rreshtave, këta çidhnakë i sheh në tërë librin e doktor Islamit.

Edhe dera e çelur është trimëri. Këtë të vërtetë e kam mësuar nga im atë. Ai ka qenë imam në Arras deri në vitin 1967. Unë e pyeta një herë si larg e larg se ku rrinte në Ramazan një muaj të tërë në një katund të huaj. "Mu nuk m'njaftojn nett t'ua boj qefin t'krejtve se hahen kush e kush të m'thairrje ma para. Po, a t'boj ni paitje, - m'u kthye. A mun ma xhojsh (= gjesh): 'Cailli (= cili) osht ma traim në bot?'". Dhashë disa përgjigje e përkufizime, por mbeti i pakënaqur. "Nuk e ke xhet, - më tha. Ma traimi n'bot, - vijoi im atë, - osht ai si i thot me t'parën her maikit 'Bujrëm!', kur i thairrën maiki n'kurt "or filoni!' Çkshtau jon çidhnakt". E mora përgjigjen. (Në parantezë: krahasoni sot syrin magjik në ndonjë derë qytetari). Dhe një fjalë e një profesori shkodran. Zija Shkodra. Ishte punonjës i vjetër shkencor në Institutin e Historisë, të Akademisë së Shkencave. Unë isha punonjës i ri shkencor në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë. Të dy Institutet ishin në një ndërtesë. Vitet '70 ishin. Si nga fundi i gushtit, punonjësit ktheheshin nga pushimet e verës. E pyeta një herë profesorin në ç'plazh kishte qenë. "Kam kenë në Setë, - më tha, - te vendi yt". Unë u befasova dhe shfaqa habi. "Po, po, mos u habit, - më tha, - shkoj atje çdo vit. Marr çadrën (e kishte fjalën për tendën) dhe a e di ku e ngreh? Mu aty në zallin e Setës, aty ku Seta bashkohet me Drinin. Më pëlqen Seta. Më pëlqen peshku i Setës". Po..., - desha ta pyesja, - ku hante. Profesori e kuptoi dhe s'më la ta mbaroja pyetjen. "Edhe peshkun, edhe hajen i kam me arrasit. Janë mikpritsa të mëdhaj. Asgja s'më mungon". Dhe vijoi: "A njihni ndonji, meqë jeni nga Peshkopia?". "Po, - i thashë. Kështu janë të gjithë çidhnakët. I çmojnë shumë mikun dhe miqësinë. E çmojnë shumë derën e çelme". Kam njohur, vërtet vetë shumë të tillë, kur kam bërë një ekspeditë gjuhësore në Kastriot. Por lexoni librin e doktor Islamit, sidomos pjesën që ka të bëjë me traditat dhe me zakonet e Çidhnës, ta njihni më mirë edhe mikpritjen çidhnake. Zgjidh dru lisi (e thënë simbolike në Çidhën për një fejesë), - thuhet në libër. Zgjidhe mikun më të mirë se vetja (e thënë pa simbolikë). Dhe për mbushamendjen tonë, doktori citon Sami Frashërin: "Miqësia është si drita e shkreptimës; sa më i errët të jetë vendi, aq më shumë ndriçon". Të tilla thënie janë të gjithmonshme.

Çidhna është krahina më e madhe e Dibrës, - thotë autori. Si të tillë, ai e përshkruan gjeografikisht në librin I. (Në parantezë, "Çidhna dje, sot, nesër" ndahet në pesë kapituj, a në pesë libra, sipas emërtimit të autorit). Domosdo ky gjeografizim është si një hyrje. Gjeografinë e Çidhnës e Çidhnën i kemi aty. Aty ku janë e ku mund t'i shohë gjithkush. Çidhna përfshin fshatrat Grykë - Nokë, Mustafe, Sinë, Arras, Kodër - Leshe, Fushë - Alie, Laçes, Kandërr, Kastriot, Kuke, Brest, Blliçe, Rrenz - me dy mbiemërtime: Çidhna e Epërme e Çidhna e Poshtme. Çidhnën e kemi aty ku janë Pllau, Seta (Artatusi i dikurshëm), Vokseta, Krojet e Kronzës, Drini, muzeu i Gjergj Kastriotit... Autori do historinë e Çidhnës. Do atë që duhet t'u thuhet të tjerëve. Do të tregojë. Dhe tregon. Dhe në librin II flet për histori: për parahistori dhe antikitet. Në librin III flet për Oenën, për qytetin ilir Oena ("oena" - pëllumbi "oena capensis"). Sipas Tit Livit, - thotë autori, - tri qyteza të mëdha kanë qenë: Uskana, Oena dhe Draudraku. Qyteti i Dibrës, - vijon autori, - është vazhdim i qytetit ilir të Oenës. I kërkon gjurmët ilire të qytetit të Oenës në periudhën romake e bizantine. I kërkon edhe sot. Sot, Oenën e njëjtëson (identifikon) me rrënojat e Kalasë së tij, me rrugët e Kalasë e për në Kala, me toponime – Kepi i Gjytetit etj. Në librin IV janë kastriotët. Dhe autori thotë se Çidhna është vendbanimi i vjetër i kastriotëve. Gjergji lindi në familjen e madhe të kastriotëve. Autori zgjedh mbiemrin "e madhe". Është vlerësimi i bukur e kuptimplotë popullor: derë e madhe, derë e dëgjuar, derë e fisme. Dhe dera e kastriotëve bëri vërtet emër në historinë e kombit. Diku më tej, kur përmend Sinën, autori bën një pyetje interesante: Artatusi (Seta) a i ndan apo i bashkon Çidhnën e Sinën? Është një pyetje e hollë retorike, një pyetje që e ka përgjigjen vetë: Artatusi i bashkon Çidhnën e Sinën. Nuk mund të jetë ndryshe. Është si e tëra bashkë me pjesën. Në Sinë është lagjja ku ka lindur Gjergj Kastrioti. Dhe ku ka ecur e ku ka luajtur Gjergji. Është Kroi i Tanzot. Është Thana e Gjergjit. Është Muzeu i Kastriotëve. E, kësisoj, Sina është Cidhën. As Drini nuk ndan. Këtej Drinit janë Kastrioti, Hasi i Thatë a Fusha e Hasit, Kalaja e Volezes, që e njohim si Torvioll ("tour = kala; viol = voleze" shpjegon M. Koltraka), Kalaja e Gjonit, Troja (lagje), Kroi i Kastriotit, Kisha e Kastriotëve, Kuket, Çeliasi (ku, siç thotë profesor Kristo Frashëri, u rrit Gjergji) etj. Kësisoj, edhe këtej Drinit përsëri është Çidhën. Çidhnën me Sinën i përbashkojnë historia, Skënderbeu, veshja, zakonet, traditat, folklori, miqësitë, kënga ...

Ndër emrat e vendeve që lidhen me Gjergjin - Skënderbeun e që përmenden në libër, duam të përveçojmë Thanën e Gjergjit. Emërtimi tingëllon si të ishte fjala për kep a për lis, për gojëdhënë për kepa a për kapërcim kepash nga Gjergji e jo për një thanë, të cilën botanistët e fusin te shkurret. Mirëpo, ai është shumë domethënës e shumë kuptimplotë: Trualli i Skënderbeut ruhet me detaje në kujtesë. Dhe me dashuri. →



Pamje nga Çidhna.
Foto © B.Karoshi

Libri është edhe si një album. Një album pa fotografi, por me copëza jete e historie. Ai është kështu edhe si një thyezim (mozaik) i bukur. Ai mund të bëhet edhe një skenar i bukur filmi dokumentar. Dhe meqë jemi te mozaiku: Doktor Islami është specialist në mjekësi (ndër të tjera, një patolog shumë i zoti). Ai nuk është gjuhëtar dhe nuk e ka për shumë detyrë të shikojë në shkrimet e tij frazën , fjalinë, pikat, presjet... Kjo është detyrë e redaktorit gjuhësor. Çfarë dua të them? Dua të them që ne gjuhëtarët duhet t'u rrimë pranë njerëzve që shkruajnë. Ata kanë dijen. Ne kemi redaktimin gjuhësor e letrar. Të bashkëndihmojmë (kontribuojmë).

Ja, kjo është Thana e Gjergjit - jo e të tjerëve. Ta ruajmë se është e Gjergjit! T'ia ruajmë se vjen Gjergji! Ajo ta sjell aq pranë, aq afër në kohë Skënderbeun, sa duket sikur ai të ketë qenë aty veç para pak vitesh e pastaj të ketë ikur! Edhe Kroi i Tanzot na e sjell Gjergjin aq pranë, aq afër. Edhe e tërë Sina. Është afri, kujtesë, dashuri dhe filozofi e popullit për prijësin.

Në anët e mia tregohet një mënyrë tjetër kujtimi e dashurie për Skënderbeun. "Koparanet (= kajuket, jakucet), - përcillte fjalën e të moçmëve Murat Hysa nga Vlesha në vitet '60, - kan kon t'bardha. I kan nxhie t'zeza kur vdiç Skënerbegi për t'majt zi. Për ta bo ma prekse dhaimtën, - shpjegonte ai më tej, - koparanes i shtauen kuklaken (= një copë katërkëndëshe shajaku, e qepur te jaka, me dy kopsa në dy cepat e sipërm për ta mbërthyer e vënë në kokë kur bie shi, që në njëfarë mënyre, ngjan me kapuçin e xhupit të sotëm), e mërthejshin ene e vishin n'kraie". Lexuesi mund ta imagjinojë qëndrimin heshtjemadh, me koparanen e kuklaken e zezë e zindjellëse të dibranëve për vdekjen e prijatarit. Ishte zi burrash. Për Burrin. Për Burrin e Dheut.

Në librin V rimerret Çidhna. Me pyetjen: Qëkur njihet Çidhna? Me të dhëna sipas Defterit turk të vitit 1467. Me fiset e Çidhnës sipas Defterit. Me toponime (shih, p.sh.: Fusha e Pllumave, Kepi i Pllumave, Maja e Pllumave, Shpella e Pllumave). Me tradita e zakone – të djeshme e të sotme. (Lexoni, p.sh., në faqen 248 për traditat dhe zakonet për nishanet e nuses. Aty gjen lëndë jo vetëm etnologu, por edhe sociologu). Çidhna vjen para nesh me gjelbërimin masiv të krahinës, me cicërimat e cinkthit (trishtilit), me erërat e forta, me gjëmimin e Setës, të Saponikës dhe të Voksetës, me ritet e veprimet mbeturinore pagane, me djegien e brirëve të bagëtive për t'u mbrojtur nga fatkeqësitë e natyrës, me njerëz të bëshëm - me fe e me besë.

Në librin e doktor Islamit, bukuria e visoreve të Çidhnës shkon një me një me jetën e njerëzve. Dhe me jetesën e njerëzve. Dhe me dëshirat e përpjekjet për një jetesë dinjitare. Të hershme e të vonë. Të djeshme e të sotme. Në libër sheh qytetarinë e lartë në veshje e në paraqitje: kuti fakfuni për duhan (burrat); kopsa të praruara me argjend (gratë); gajtanë të kuq për të lidhur flokët (vajzat); shami të kuqe me lule (nuset). Shajak burrat; shajak gratë. Brez burrat; brez gratë. Te gratë, brezi është i kuq. Te gratë mbizotëron e kuqja. Është ngjyra e gjakut.

Anglezët thonë: "The only medicine that a family can keep in the house is cheerfulness". (I vetmi ilaç që një familje mund ta mbajë në shtëpi është gëzueshmëria). Ky ilaç është në shtëpitë çidhnake. Çidhnakët janë gëzimtarë, janë entuziastë. Jo vetëm në punë, por edhe në oda. Jo vetëm me biseda, por edhe me këngë. Me këngë, atëherë, kur nuk kishte radio e televizor. Por në oda dasmash, edhe tani. Janë këngë trimërie. Dikur, ato shoqëroheshin me lauri - një lloj lahute, që, siç thotë autori i librit, përdorej në zonat mbi lumin Drin e deri në Mat, Krujë e malësi të Tiranës e edhe tek arbëreshët e Italisë. A mund të ketë shtegtuar lauria nga Çidhna në Krujë, siç (mendohet se) ka shtegtuar "i" e diftonguar (tipi *shai, paik*) nga Çidhna e Dibra në të folmen e Krujës? Etnografët mund ta thonë. Gëzimi e gazmendi është edhe në valle. Pëlqehen vallet dyshe, - thotë doktori. Në libër ai përmend këngëtarë e vallëtarë më në zë - Adem Hoxhën, Abaz Nokën, Shaqir Canin, Rexhep Canin, Hamit Cerrin, Selman Krrashin, Zyber Priftin etj.

Më tej, në librin për jetën e etnografinë çidhnake na vijnë: Pëllumbi, si pjesë zbukurimore a vizatimore në mantelin e kuqërremtë të grave. (Të jetë ai pëllumbi oena?). Darka e Diellit (në libër, Festa e Diellit), më 25 - 26 dhjetor. (Një emërtim sa i bukur, aq edhe shkencor. Për ta përcaktuar saktë atë pozicion të Diellit e atë Darkë , është Shkalla e Diellit. Është shkalla që të çon në Kala. Matjet me anë të kësaj shkalle janë kronometrike.). Një pe në krah ose në gisht si shenjë unaze, kur vajza mbërrin pjekurinë dhe gërshetat – një para gjoksit e një pas shpine. (Për simetri? Për bukuri? Sido që të jetë është, vërtet paraqitje e bukur). Dita e Verës, më 14 mars. (Me lule kukreku. Është lulja e parë e pranverës. Është bima me lule të gjelbra e të merme. Në gjuhën standarde quhet taçe. Ajo të thotë se toka ka filluar të ngrohet. Prandaj mbille elbin! Bashkë me elbin, edhe grurin e vermë! Elbi mbillet shpejt e piqet shpejt. Dikur ishte buka e të varfërve.). Shëngjergji, më 6 maj. (Kur vajzat shpalojnë gërshetat. Në luhajë (kolovajzë), ditën e Shëngjergjit, pa gërsheta. Gërshetat, duket janë një lloj disipline e rregullshmërie për vajzat e për festë pranvere duhet të ketë një si lirshmëri, një si dehashpirt). Por festa më e madhe në jetën e njeriut është, sigurisht dasma. Di (mbase, doktori do ta thotë në librin tjetër që po përgatit) që shumica e dasmave në katund a në krahinë bëhen në një ditë, për Shëmrai (Shëmri), më 23 gusht. Si organizohen kaq shumë njerëz e kaq shumë dasma në një ditë - është, vërtet për t'u lakmuar. Por këtu duhet të jetë e bukura, e madhërishmja: Të gjithë në festë. Të gjithë në dasmë. Të gjithë në valle. Të gjithë me nuse e me dhëndurë. Dhëndurë e nuse këtu. Dhëndurë e nuse atje. Pse, a ka më mirë se kaq? A ka simfoni më të madhe se kjo?

Kanuni i Skënderbeut. Edhe ai zë vend në libër sepse ka pasë zënë vend në jetën e çidhnakëve. Do të përmend vetëm dy nga ato norma të kanunit që citon autori i librit, për të njohur më tej Skënderbeun dhe çidhnakët: "1. Djali *i vetëm* nuk vritet. 2. Djali *i pamartuem* nuk vritet?" (Nënvizimet janë të miat – H.Sh.). Në të dyja rastet, në kanunin e Skënderbeut madhështohet jeta, gjallërimi, riprodhimi njerëzor. Në Çidhën nuk fiket dera. Por më tej se Kanuni, çidhnaku ka falur. Dihen raste me emër. Kjo është zemërmadhësia e njerëzishmëria. Me siguri, doktori di shumë e më shumë për këtë sjellje të lartë njerëzore e për këtë moral të lartë njerëzor e do të na i përshkruajë ndoshta edhe si tregime a si letërsi. Çidhnakët janë egërshanë, por jo të egër. Kjo është e bukura tjetër.

Libri "Çidhna dje, sot, nesër" është si një enciklopedi. Për Çidhnën e për çidhnakët. Por, edhe përtej Çidhnës e përtej Dibrës. Është si një enciklopedi e një lloji të veçantë. Aty ka gjeografi, histori, folklor, etnografi, tradita, zakone etj. në trajtë shpalimi. Libri është si një enciklopedi sepse gjithkush – ambientalisti, historiani, sociologu, etnografi, folkloristi, gjuhëtari, etimologu etj., sipas profesionit e dëshirës gjen atë që do. Për një specolog ka 17 shpella në Çidhën, ndër to, edhe Shpella e Akullit. Për një sociolog ka një përfushje të gjerë historike – sociologjike. Për një gjuhëtar ka fjalë e shprehje të panjohura popullore (p.sh., *përkresë* / e opingës, *çok, kusarthi*, *cukale* / cukalet e shtëpisë, *çirçe*, *bishtalak* etj.). Për një etimolog ka toponime (*Artatus, Kastrush* / Kalaja e Kastrushit*, Kronëza, Rokoçelja, Troja* etj.) e mikrotoponime (*Faqeza*, *Fushas*, *Mëzez*, *Arrëza* etj.) dhe antroponime (emra e mbiemra njerëzish / shih te fiset, faqe 225 - 237 e në të gjithë librin). Për një etnograf ka shumë e më shumë. Le të shikojë, për shembull, fejesën e dikurshme që përshkruhet këndshëm në libër. Për një arkeolog është Oena, që për doktorin është një copëz shpirti e pathënë.

Libri është një si enciklopedi për Çidhnën. E, jo vetëm për Çidhnën. Më së pari, sepse të mirat gjithmonë janë përcjellë e përcillen më tej. E mira shtegton. Edhe në hapësirë, edhe në kohë. Dhe Çidhna ka përcjellë e rrezatuar gjithnjë. Kujtojmë jo vetëm Skënderbeun, por edhe Kuvendin e Arrasit. Më 1920, në shtëpinë e Riza Lushës, Kuvendi nxori një qeveri. Në libër përmenden edhe shumë ngjarje të tjera madhore.

Libri është edhe si një album. Një album pa fotografi, por me copëza jete e historie. Ai është kështu edhe si një thyezim (mozaik) i bukur. Ai mund të bëhet edhe një skenar i bukur filmi dokumentar. Dhe meqë jemi te mozaiku: Doktor Islami është specialist në mjekësi (ndër të tjera, një patolog shumë i zoti). Ai nuk është gjuhëtar dhe nuk e ka për shumë detyrë të shikojë në shkrimet e tij frazën , fjalinë, pikat, presjet... Kjo është detyrë e redaktorit gjuhësor. Çfarë dua të them? Dua të them që ne gjuhëtarët duhet t'u rrimë pranë njerëzve që shkruajnë. Ata kanë dijen. Ne kemi redaktimin gjuhësor e letrar. Të bashkëndihmojmë (kontribuojmë). Me formën (me frazën, me fjalinë, me pikat, me presjet...). Përmbajtja është e tyre. Së dyti, në libra të tillë - me shumë tema e nëntema, me shumë ngjarje, vende e njerëz, me shumë copëza të ngjyrshme - duhet të ketë në fund një tregues (indeks). Lexuesi e lexon me kënaqësi një libër si ky i doktor Islamit. Por, pas leximit të parë, lexuesi mund të ketë nevojë t'i referohet në çaste të caktuara, për çështje të caktuara, për emra të caktuar etj. (Një shembull: Në librin "Çidhna dje, sot, nesër" thuhet se në Çidhën kanë qenë 18 kisha. Lexuesi do të gjejë me të shpejtë ku kanë qenë ato kisha. Ku do t'i gjejë? Tek treguesi, te fjala kishë.). Kjo do të thotë që libra të tillë janë edhe libra tryeze e referimi. Për këtë arsye e duan domosdo treguesin. Së treti, libra të tillë janë libra kulture në kuptimin më të gjerë të fjalës. Kulturë është banesa çidhnake (unë kam parë në Çidhën dy banesa me sharapoll) e veshja. Kulturë janë gatesat. Edhe zejet. (Në librin e doktor Islamit thuhet se në Çidhën ka pasur shumë zeje popullore. Atje bëheshin pjesë metalike për mullirin e kafesë, por edhe për pushkë dhe për orë muri, bëheshin vegla bujqësore e çarqe për kafshë të egra, brisqe rrojtari e kuti duhani, çifteli e lauri, djepe e fyej... Çidhna ishte e vetëmjaftueshme në gjithçka.). Edhe gjetjet arkeologjike (doktori flet në libër për qytetin e Oenës; arkeologu popullor, Halil Gjeçi të tregon monedhën me "Oenë"). Kulturë janë orenditë shtëpiake, shqiponja a pëllumbi, gdhendur në oxhaqe, djepe etj. a qëndisur në veshje. Kulturë e madhe është folklori: kënga, vallja, balada (në librin për Çidhnën është një pjesë e baladës së Bardhok Ndrekës, që autori e krahason me baladën çame të Tanës), përralla etj. Kulturë janë lojërat popullore. Edhe dasmat e këngët e dasmës. Edhe fjalët e urta e proverbat (ato janë sintezë e urtësisë popullore). Edhe besimet popullore. Edhe toponimet. Edhe të tjera. Dhe, e lashë për në fund, si më të veçantë e për ta spikatur: Kulturë e madhe është e folmja. Gjuha është kulturë në kuptimin më të përgjithshëm të fjalës. Atëherë, një fjalor me fjalë e me shprehje popullore nga Çidhna do të ishte një vepër e madhe. Çidhna është si Ujëvarat e Niagarës. Doktori na ka treguar udhën për te këto ujëvara. Le të ecim në këtë udhë e të shkojmë tek ujëvarat. Dhe jo vetëm tek ujëvarat e Çidhnës. Ujëvara ka edhe në Lurë, Muhurr, Katër Grykët, Reç e Dardhë, Katundet e Epra, katundet e Qendrës, Maqellarë, Shupenzë, Zerqan, Bulqizë, Sllovë, Kala e Dodës etj. - gjithkund në Dibër. Edhe në Dibër të Madhe. Ta mbledhim visarin e kulturës popullore. Të mbledhim fjalët, shprehjet e fjalët e urta popullore për një fjalor të përgjithshëm të të folmeve të Dibrës. Me vlerë të pallogaritshme gjuhësore, por edhe kulturore, sepse fjalorët japin edhe tablonë jashtëgjuhësore. T'i mbledhim të gjitha toponimet - historike e të tanishme. Të vazhdojmë si deri tani të mbledhim folklor. Të gjurmojmë për gojëdhëna e legjenda. Tani vetëm të mbledhim. Që të mos harrohen, që të mos na humbasin këto vlera. Brezat e brezatarët shkojnë e vijnë, por ne të nxitojmë për tek ata që ikin. Por jo me një shimatës përpara ujëvarave. Mbase, edhe me një organizim mbarëdibran. Mbase, edhe me një botim të përvitshëm.

Në të gjithë librin autori thotë mendimin e vet. Thotë, kur ia do puna edhe mendimin e të tjerëve. Dhe citon. Shqiptarë dhe të huaj. Është mënyrë shkencore e të shkruarit. Dhe, për ndonjë që nuk e ka lexuar ende librin, le të shohë citimin: Luigj Benusi ka vërtetësuar vazhdimësinë iliro - shqiptare me anë të grupeve të gjakut. Një fakt tjetër i madh për ne iliro - shqiptarët.

Libri mbyllet me një epilog. Është në faqen 278. Katër faqe më parë është "Zanat dhe Çidhna ime". Vëreni: "Çidhna ime". Është e thënë dashurie dhe nderimi. Kështu thonë, sigurisht të gjithë çidhnakët. Kurse ne dibranët e tjerë themi: "Kjo asht Çidhna jonë". Është Çidhna që na jep nder të gjithëve.

botime

Libri i Shaban Sinanit dëshmon se albanologjia, ashtu si çdo degë tjetër shkence, nuk mund të ngrihet në një stad të ri pa njohuritë, dijet e kontributin e "të parëve", të atyre që kanë kontribuar para nesh.

Përqasje kritike mbi studimin monografik të studiueses së njohur

Mbi librin "Miti i malit në letërsinë shqipe" të Dr. Rovena Vatës

Nga Mentor HOXHA*



Autori: Rovena Vata
Titulli: Miti i malit në letësinë shqipe
Gjinia: Studime
Redaktor: Naim Zoto
Botues: "Naimi"
www.botimenaimi.com
ISBN: 978-9928-109-55-2
Nr. i faqeve: 320
Çmimi: 1000 lekë/10 euro

Shtëpia botuese "Naimi" ka hedhur në qarkullim studimin monografik "Miti i *malit* në letërsinë shqipe", shkruar nga Dr. Rovena Vata, punjonjëse në Qendrën e Studimeve Albanologjike. Redaktor i librit është Naim Zoto, recensues Prof. dr. Zeqirja Neziri dhe Prof. dr. Laura Smaqi, kopertina nga Dorina Muka. Libri ka 302 faqe dhe kushton 700 lekë (7 euro). Për ta bërë sa më të plotë dhe sa më shkencor këtë studim, autorja ka punuar gjatë. Krahas intuitës meditativo-kreative, ajo ka shfrytëzuar edhe 600 libra shkencorë dhe artistikë nga studiues dhe shkrimtarë të njohur shqiptarë e botërorë. Në libër janë 544 referenca nga bibliografi dhe burime të ndryshme. Konkluzionet e këtij libri janë publikuar në 17 faqe anglisht. Autorja analizon mitin e *malit* në veprën letrare të katër autorëve të shquar shqiptarë: Gjergj Fishta, Ernest Koliqi, Migjeni dhe Martin Camajt. Krahas këtyre autorëve, zj. Vata, jep edhe një vështrim të përgjithshëm historik të mitizimit të *malit* gjatë procesit letrar shqiptar që nga krijimtaria anonime popullore deri te letërsia e kultivuar bashkëkohore.

"Janë bërë shumë studime për të gjithë autorët e lartpërmendur, por asnjë tezë në nivel doktorature nuk është marrë me mitin e malit, me malin në krijimtarinë e tyre, paradigma e të cilit mbizotëron e ka vend të madh në letërsinë shqipe",-shkruan Prof. Dr. Shaban Sinani në studimin me titull *"Ikje prej mitit të malit: shkrimtari që e ktheu letërsinë në qytet: një vështrim antropologjik,* në Malësia, Montenegro. Nr. 8/2013.f. 70-80. Nisur nga ky artikull i udhëheqësit shkencor të punimit të saj, Rovena me librin "Miti i malit në letërsinë shqipe", është përpjekur të mbush pikërisht këtë boshllëk të studimeve letrare, duke u dhënë studiuesve të letërsisë dhe më gjerë një libër me vlera të mëdha shkencore. Ky libër është një udhërrëfyes dhe një medium shkencor edhe për të gjithë historianët, studentët e gjuhës e të letërsisë dhe nxënësit e shkollave.

Në këtë punim, miti i malit është trajtuar e hetuar në dy aspekte: Si lëndë letrare mirëqenë në trashëgiminë tonë të pasur si dhe në rrafshin historik-krahasues në autorë përfaqësues dhe në periudha të ndryshme historike.

"Struktura e studimit paraqitet mjaft efikase për të realizuar qëllimin e synimin e shprehur. Niset me Mitin e malit në Kanunin e Lekë Dukagjinit, e më pas në letërsi. Mali si traditë në letërsinë e vjetër: Buzuku, Budi, Bogdani, Bardhi. Miti i malit në letërsinë romantike, duke u përqëndruar në vijim tek 4 autorë: Fishta, Koliqi, Migjeni e Camaj si dhe në vija të përgjithshme në letërsinë e Realizmit",-shkruan pedagogia dhe studiuesja e njohur e letërsisë Prof. dr. Laura Smaqi në pasthënien e këtij libri. Ky libër është vlerësuar edhe nga studiuesi i njohur Prof. dr. Zeqirja Neziri, pedagog në Universitetin "Shën Cirili dhe Metodi"në Shkup. Në pasthënien e këtij libri ndër të tjera ai shkruan: *"Miti i malit në antropologji e letërsi (gojore ose të shkruar) vazhdimisht ka tërhequr vëmendjen e studiuesve, qofshin këta të huaj ose vendës. Edhe më parë janë bërë studime në fusha të veçanta për praninë e këtij miti në veprën letrare ose në ndonjë tregim, novelë, poemë a roman të ndonjë autori, por në studimet mitologjike: teorike e historike letrare shqiptare kanë munguar studime të mirëfillta shkencore me një shtrirje kaq të gjerë të lëndës dhe me një hulumtim të rrëmuar kaq shumë në thellësi".*

Studimi është i ndarë në tetë kapituj: I. Miti i malit në Kanunin e Lekë Dukagjinit. II. Mali si traditë në letërsinë e vjetër (Buzuku, Budi, Bogdani, Bardhi). III. Miti i malit në letërsinë romantike. IV. Miti i malit dhe romantizmi i shek. 20-të, Gjergj Fishta (Mali, malësori, mitet IV.1. Mali dhe kodi në letërsinë e Gjergj Fishtës. IV.2. Letërsia e Fishtës si letërsi etnografike. IV.3.Leknia si metonomi e atdheut. IV.4. Malësori i Lahutës në vështrimin e të huajve. IV.5. Karakteri romantik i veprës dhe gërshetimi i besimeve. IV.6. Lahuta si epos historik: oraliteti). V. Kodi, mali dhe kanuni: V.1. Mali i "pashmangshëm" te Koliqi. V.2. Koliqi mes kodit kanunor dhe kodit civil. V.3. Paradigma e malit të Koliqit). VI. Ikja prej mitit të malit: Migjeni, fundi i romantizmit: VI.1. Ikja prej mitit të malit. VI.2. Mali si mit i refuzuar në krijimin migjenian. VI.3. Kthimi i letërsisë në qytet). VII. "Mali pa kod" në veprën e Camajt: VII.1. Ikja prej kodit si fenomen estetik: VII.2. Biografizmi në letërsinë e Camajt. VII.3. Kodi i malit perceptimi ose semantika e tij. VII.4. Mali si dhimbje. VII.5. Mali si fatalitet) dhe VIII. Rikthimi i mitit të malit në letërsinë e realizmit socialist. Objekti kryesor i autores ka qenë analizimi i malit në disa rrafshe dhe këndvështrime të ndryshme, si vertikalitet, mbijetesë, referencë, ide, koncept, fuqi, mister, qëndrueshmëri, mbrojtje, figurë mashkullore, krenari, pengesë, ,traditë, legjendë, adhurim, kod, komunikim me hyjnoren dhe si rimarrje kritike e tij. Ajo është nisur nga studimet mbi mitin antropologjinë, filozofinë, gjuhësinë, historinë, nisur nga disa metoda: hermeneutike, komparative, semiologjike, biografike e sociologjike, semiologjike, antropologjike. Punimi është kryer në dy rrafshe kryesore: në rrafshin e antropologjisë kulturore dhe në rrafshin e studimeve letrare (letrare-historike, semiologjike, strukturaliste).


Në hyrje të këtij libri, ndër të tjera, autorja shkruan: *"Në letërsinë shqipe, që nga krijimtaria anonime popullore deri te letërsia e kultivuar bashkëkohore, mali tematizohet shpesh, si vendngjarje, por edhe me ngarkesa të tjera të natyrës simbolike, etnocentrike, mitike etj. Ndërkaq, mund të pohojmë se në studimet tona letrare mali me paradigmat e tij letrare-artistike është bërë objekt studimesh të njëanshme, duke u përqëndruar në interpretime kryesisht sociologjike-simbolike, të kryera nën prizmin e patetikës atdhetare, liridashëse. Duke vërejtur këtë lloj mangësie në studimet tona letrare, kjo monografi synon të marrë në shqyrtim rrafshin tematik, studimet e këtij rrafshi, duke u bazuar në aspektet ideore dhe formale, për të mbërritur në elementet tipike, motivore dhe artistike të përmbajtjes. ...Me anë të kësaj pune do të trajtojmë këtë mit në prerje sinkronike e kronologjike në disa autorë qendrorë, po ashtu edhe si e gjejmë në Kanunin e Lekë Dukagjinit, në letërsinë e vjetër shqipe, në letërsinë romantike si dhe rikthimin e mitit të malit më letërsinë e realizmit socialist . Pjesën më të madhe të punimit e zënë katër autorë të letrave shqipe: Gjegj Fishta, Ernest Koliqi, Migjeni dhe Martin Camaj. Përcaktimi i mënyrës se si na vjen miti i malit tek këta autorë është me rëndësi për studimet tona albanologjike dhe më gjerë, por njëherësh paraqet vështirësi të ndryshme, të karakterit objektiv; si trashëgiminë studimore e albanologjike.*

Sipas autores, kjo monografi u realizua falë idesë dhe sugjerimeve të vazhdueshme të udhëheqësit shkencor të tezës së saj doktorale Prof. dr. Shaban Sinanit, ndaj së cilës ajo i shpreh konsideratën dhe mirënjohjen më të lartë. Gjithashtu, falënderon Qendrën e Studimeve Albanologjike, drejtuesin e saj, prof.dr. Ardian Marashi, Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, departamentin e Studimeve Letrare, për mbështetjen dhe mundësinë që i kanë dhënë në realizmin e këtij studimi shkencor. Por, natyrisht këtë libër të parë, ajo ua dedikon prindërve të saj, të cilët gjithmonë e kanë nxitur dhe përkrahur në udhën e saj krijuese dhe shkencore.

**Master Shkencor në "Studime letrare"*

LIBRI I RI I PROF. DR. SHABAN SINANIT, BOTIMET "NAIMI"

Një enciklopedi albanologjike



Autori:
Shaban Sinani
Titulli:
Pyetje
në albanologji
- autorë dhe teza
Gjinia: Studime
Redaktor:
Naim Zoto
Botues: "Naimi"
www.botimenaimi.com
ISBN:
978-9928-109-55-2
Nr. i faqeve: 320
Çmimi:
1000 lekë/10 euro

Libri më i ri që studiuesi Shaban Sinani i paraqet lexuesit, nën titullin "Pyetje në albanologji - autorë dhe teza", ashtu si tërësia e studimeve të tij (mbi 20 tituj librash të publikuar deri tani), përveç vlerave shkencore, përbën një kontribut për theksimin e origjinalitetit në kërkimet shqiptare, në një kohë kur pikërisht origjinaliteti në një pjesë të madhe të studimeve të sotme është mjegulluar.

Libri "Pyetje në albanologji", i sapopublikuar nga shtëpia botuese "Naimi", merret me autoritete, argumente e probleme të hershme e të sotme të albanologjisë. Krahas identifikimit të imët të kontributeve të këtyre autoriteteve (A. Buda, Dora d'Istria, Hasan Ceka, De Rada, Lef Nosi, Mahir Domi, Qemal Haxhihasani, Shaban Demiraj, Tahir Dizdari, Vexhi Buhara, Matteo Mandalà, Maximilian Lambertz, Milan Šufflay etj.); krahas tezave e hipotezave të tyre për çështje të tilla, si origjina e kombit shqiptar, historia dhe gjuha e tij, eposi, folklori etj., autori, me modesti dhe me një stil elegant rigoroz, duke marrë shkas prej pikënisjes, ofron të dhëna, gërsheton njohuri ndërdisiplinore, hedh teza e hipoteza të reja, duke na bërë të kuptojmë jo vetëm zotësinë e tij, por duke zbuluar vlera të reja tek ata për të cilët shkruan.

Ndryshe nga disa grupe studiuesish, që nuk kanë shkruar qoftë dhe një rresht në nderim të personaliteteve të të njëjtit urdhër, ose të tillëve që kujtojnë se mund të mbingrihen duke mohuar e errësuar punën e para-ardhësve; apo të tjerëve ende, që, sipas shijes së pragmatikës ditore, duan të zh-vlerësojnë dijen dhe dijetarët për hesap të orientimit, ky libër i Shaban Sinanit dëshmon se albanologjia, ashtu si çdo degë tjetër shkence, nuk mund të ngrihet në një stad të ri pa njohuritë, dijet e kontributin e "të parëve", të atyre që kanë kontribuar para nesh.

Nuk është e rastit që autori i librit ka përfshirë këtu edhe disa figura që ishin mënjanuar, si: Lef Nosi, Haxhi Shehreti i Delvinës, Dora d'Istria, Margaret Hasluck; apo të dhënat e zbuluara prej tij mbi kontin Junku të Krajës, një familje patronimike shqiptare, duke i vlerësuar si burime të dhënash me vlera të shumëfishta etnologjike, gjuhësore, folkloristike dhe historike.

Libri i Shaban Sinanit "Pyetje në albanologji - autorë dhe teza", ndonëse duket si kushtim një yllësie personalitetesh, në fakt, me dijen e pasur që ofron jo për jetën apo biografinë e njërit a tjetrit, por për shumë enigma dhe probleme të etnosit dhe eposit, historisë dhe gjuhës së shqiptarëve, mund të vlerësohet edhe si një enciklopedi albanologjike e autorit.

Lexuesi që i ka dëgjuar apo dëgjon shpesh emra të tillë si A. Buda, Dora d'Istria, H. Ceka, De Rada, Lef Nosi, M. Domi, Q. Haxhihasani, Sh. Demiraj, T. Dizdari, V. Buhara, M. Mandalà, M. Lambertz apo Sufflay por kërkon të dijë më shumë dhe më saktë për kontributin e tyre në kulturën shqiptare mund ta ketë këtë libër si referencë serioze. Jo vetëm kaq, por mund të shohë se si tezat e hipotezat e tyre plotësohen e forcohen nga dijet e autorit të librit dhe të tjerëve që kanë punuar ndërkohë.

histori

Kryengritja e shtatorit e vitit 1913, e cila u shkaktua nga vendimet e padrejta të Konferencës së Londrës, kishte për synim bashkimin dhe çlirimin kombëtar.

Rezistenca antiserbe në shtator të vitit 1913

Nga **REZEHANA HYSA**

Në shtator të vitit 1913 Dibra u bë qendra kryesore e kryengritjes antiserbe që u përhap nga Gjakova deri në Ohër. Populli dibran u bëri qëndresë të fortë trupave pushtuese serbe dhe kundërshtoi aneksimin e kësaj krahine nga Mbretëria serbe . Prijësit më në zë të kësaj lëvizjeje konsideroheshin Mersim Dema, Elez Jusufi, Suf Xhelili, Qazim Lika, Sefedin Pustina, e shumë luftëtarë të tjerë të cilët i treguan diplomacisë europiane se vendimet e konferencës së Londrës për aneksimin e viseve shqiptare nga shtetet fqinje janë të padrejta dhe se duhet korrigjuar.

Qeveria e Vlorës pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë u ballafaqua me probleme të shumta territoriale të bartura si nga okupimi pesëshekullor otoman po ashtu edhe nga pasojat e Luftërave Ballkanike. Andaj ajo qe e detyruar që krahas njohjes dhe forcimin e shtetit të ri shqiptarë në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare, të luftojë edhe për çlirimin e shumë territoreve shqiptare të cilat kishin mbetur jashtë kufijve administrativë të Shqipërisë, si rezultat i pushtimit nga shtetet fqinje me Shqipërinë. Andaj kundër kolonizimit të tokave shqiptare dhe gjenocidit të ushtrive të shteteve fqinje, krerët më në zë të luftrave antiosmane dhe antiserbo-greke, të mbështetur nga popullata shqiptare u mobilizuan për çlirimin e popullit shqiptarë nga shtetet fqinje me të.

KRYENGRITJA E SHTATORIT TË VITIT 1913

Konferenca e ambasadorëve në Londër më 1913 ndonëse e pranoi krijimin e shtetit të ri shqiptarë, por la jashtë saj në mënyre krejt arbitrare gjysmën e territorit shqiptarë dhe gjysmën e popullsisë shqiptare gjegjësisht Kosovën dhe viset e tjera të banuara me shqiptare si Plavën, Gucinë, Shkupin, Kumanovën, Tetovën, Gostivarin, Dibrën, Kërçovën, Strugën, Ohrin etj. ndërsa çamërinë dhe viset e tjera në jug iu dhanë Greqisë. Vise që konsideroheshin se u pushtuan gjatë luftërave ballkanike por që fatkeqësisht u njohën edhe nga Konferenca e ambasadorëve në Londër. Si rrjedhojë e këtij Vendimi famëkeq për shqiptarët, kudo në viset shqiptare u ndje një pakënaqësi e madhe ngase qeveria serbe kishte vendosur në mënyrë arbitrare një kufi tjetër "strategjik"dhe që kalonte gjatë luginës së Drinit përfshirë pjesërisht edhe Matin. Duke justifikuar mbajtjen e kësaj zone me nevojën e mbrotjes nga sulmet e të ashtuquajtura të shqiptarëve. Kësisoj autoritet serbe morën masa shtrënguese për ti detyruar banorët shqiptarë të zonës"strategjike"të kërkonin bashkim me Serbinë. Madje një fenomen shumë i theksuar në këtë periudhë qe edhe konvertimi i fesë me dhunë prej musliman dhe katolikë në orthodoks si një nga format më të egra të dhunës politike dhe që kishte për synim asimilimin dhe shkombëtarizimin e kombit shqiptarë. Në këto rrethana kryengritja shqiptare ishte e pashmangshme. Krimet serbe i nxitën kryengritësit dhe tërë popullin shqiptarë që ti kundërviheshin me të gjithë forcat pushtuesve serbë. Kryengritja filloi në shtator të vitit 1913 në Dibër. Udhëheqësit më në zë të kësaj krahine u konsideruan Mersim Dema, Elez Jusufi, Halil e Llan Kaloshi, Sefedin Pustina, Suf Xhelili, Qazim Lika e shumë e shumë të tjerë, të cilët i organizuan kryengritësit duke i tërhequr me luftime nga vija në vijë me qëllim që tu jepnin kohë popullatës shqiptare gjegjësisht grave dhe fëmijëve që të evakoheshin në thellësi të viseve të ndryshme shqiptare. Në ndërkohë krerët udhëheqës të kryengritjes dhe populli i Dibrës i kishin kërkuar Qeverisë së Vlorës që të bënte përçapje diplomatike deri te Fuqitë e Mëdha për të ndërpre ndërhyrjen e ushtrisë serbe në tokat e Shqipërisë autonome ngase ushtria e Kral Petrit kryente masakra të pashembullta kundër popullsisë së pafajshme të Dibrës vetëm e vetëm se kërkonin të jetonin të lirë në trojet e veta etnike qysh para se sllavët barbarë të zbritnin nga Uralet.

Një muaj para se të fillon kryengritja gazeta "Përlindja e Shqipërisë" ndër të tjera shkruante se:"përfaqësuesit e viseve verilindore të Shqipërisë, patën një takim me kryeministrin e Shqipërisë Ismail bej Qemali, , mbi gjendjen në Malësinë e Dibrës dhe masat që duhet ndërmarrë për pengimin dhe depërtimin e ushtrive serbe në këtë krahinë të Shqipërisë. Edhe pse Qeveria e Vlorës ishte në përkrahje të plotë të kryengritësve shqiptarë , por i shmangej prononcimit publik ngase jo vetëm që duhet të respektonte vendimin e Konferencës së Londrës, por edhe ngaqë një konfrontim i ri ndërshtetëror do të rrezikonte seriozisht qenien e shtetit të ri shqiptarë . Andaj ajo u detyrua që këtë nismë të kryengritësve shqiptarë ta mbështesë por pa me u ekspozuar shumë. Më 2 shtator 1913 ushtria serbe bombardoi dhe dogji qytetin e Dibrës së madhe. Pas tetë ditësh mbreti i Serbisë Pjetri i I-rë miratoi propozimin e ministrit të luftës, Vili Bozhanoviq, për mobilizimin e Divizionit të Moravës me regjimentin e I-rë dhe të II-të të zmadhuar të fanterisë kundra kryengritësve shqiptarë. Më 14 shtator 1913 shtypi sërb shpalli zyrtarisht mobilizimin e këtij divizioni kundër Shqipërisë. Për të ju kundërvu ushtrive sërbe të cilat po masakronin popullsinë e pafajshme të rrethit të Dibrës me rrethinë, më 21 shtator 1913 me një shpejtësi të jashtëzakonshme u krijuan shtabet luftarake shqiptare për drejtimin e luftimeve, të cilët u grupuan në tri drejtime dhe atë:Grupi i parë i udhëhequr nga Elez Jusufi, Selman Alia, Halil Kaloshi, me 200 malësorë, me drejtim Peshkopinë, Maqëllarën, Dibër e Madhe. Grupi i dytë, i prirë nga Mersim Dema, Bajram Buci, Hasan Koci, Ramadan Kanxha që do ti sulmonin forcat sërbe në qytetin e Dibrës dhe do të marshonin në drejtim të Trebishtës-Strugës-Ohrit dhe grupi i tretë i udhëhequr nga Suf Xhelili, Qazim Lika, Misim Ahmeti në drejtim të kalasë së Dodës dhe pasi të bashkohen me forcat e Ramadan Zaskocit do të marshonin në drejtim të Prizrenit. .

Krerët e kryengritjes antisërbe të shtatorit të vitit 1913 e kishin të vështirë ngase trupat sërbe numëronin diku 6800 ushtarë dhe me armatim të fortë ndërsa forcat kryengritëse dibrane ishin diku 300 vetë për çdo drejtim dhe në përfundim të kryengritjes diku rreth 6000 vetë. Më 22 shtator 1913 kryengritësit dibranë të përkrahur nga popullata dibrane e sulmuan fortë ushtrinë serbe sa që kjo e fundit u detyrua të tërheq ushtrinë nga Dibra por me humbje të mëdha. . Të entuziazmuar udhëheqësit e kryengritjes anti serbe, Mersim Dema, Elez Jusufi, Selman Alia, Halil dhe Haxhi Kaloshi takohen më parësinë e qytetit të Dibrës së Madhe, Sefedin Pustinën, Riza Beun, Sadulla Strazimirin, e shumë patriot të tjerë, ngritën flamurin kombëtar shqiptarë dhe formuan qeverinë e përkohshme të Dibrës me kryetar Sefedin Pustinën. Ndërsa më 23 shtator 1913 krerët e kryengritjes shqiptare iu drejtuan Qeverisë Provizore të Vlorës nëpërmjet prefekturës së Elbasanit për armë dhe municion me qëllim që ti rezistonin ndonjë fuqie të madhe sërbe që mund ta sulmonte atë. Në ndërkohë Aqif Pashë Elbasani i dërgon Mersim Demës një sasi municioni deri sa qeveria e Vlorës të mobilizohet dhe të dërgonte armët e kërkuara krerëve të kryengritjes dibrane. Ndërkaq gazeta"Srpsko Norne" e Beogradit, botonte kërcënimet e mbretit Pjetër në Këshillin e Ministrave për një ekspeditë ndëshkimore në Shqipëri.

Më 26 shtator 1913 kryengritësit shqiptarë hynë në Strugë, ku iu bashkangjitën edhe shumë struganë të tjerë të prirë nga Abdullah Gajdrini (Rushiti), Demir Lena, Riza Hajro etj. Pas shumë përpjekjesh e çliruan Strugën madje po në të njëjtën ditë e çliruan edhe Ohrin dhe u nisën për në Resnjë. Ndërkaq krahu tjetër i kryengritësve , mori Mavrovën dhe hyri në Gostivar, ndërsa një ditë më vonë më 27 shtator 1913 kryengritësit dibranë kishin nën kontroll malet e Petrinës, malet e Jamës(Kërçovë), hanet e Mavrovës dhe në Jug të lumit Bistra para qytetit të Prizrenit. Për fitoren e dibranëve kreu i Qeverisë Provizore të Vlorës Vebi bej Dibra njoftonte se burrat e përmendur janë ndarë në tri krahë njëri për në Gostivar që pushtoi Mavrovën, tjeri për Kërçovë kaloi Lapushnikun dhe krahu i tretë po i afrohen Strugës.

Për rezistencën e kryengritësve shqiptarë raportuan shumë konzuj të huaj. Kësisoj Konzulli austriak në Durrës, Hombarstel në një telegram dërguar Vjenës më 28 shtator 1913 njoftonte se "shqiptarët paskan zënë rob diku rreth 300 serbë, 20 topa dhe sasi të mëdha municioni. Ndërsa konsulli Italian në Beograd, Pijemonti njoftonte Romën se deri më sot trupat serbe janë 500 të vdekur dhe 100 të plagosur. Shqiptarët që bëjnë luftë shoqërohen prej grave të tyre të cilat kanë ushqim për burrat në luftë.

Kryengritja e shtatorit e vitit 1913, e cila u shkaktua nga vendimet e padrejta të Konferencës së Londrës, kishte për synim bashkimin dhe çlirimin kombëtar. Ajo filloi më 20 shtator në Dibër dhe u shtri në Strugë u përhap në Kosovë në rrethet e Pejës, Gjakovës, Prizrenit, Drenicës e deri në afërsi të Prishtinës. Numri i kryengritësve arriti në disa mijëra vetë. Ata çliruan Peshkopinë, Ohrin, Strugën, Gostivarin. Por kryengritja pas përleshjeve të ashpra me ushtrinë serbe u shtyp. ngase divizone të reja ushtarësh i detyroi kryengritësit si ato të Dibrës po ashtu edhe ato të Kosovës të tërhiqen. Edhe pse kryengritja u shtyp me gjak qëndresa shqiptare vazhdoi edhe më tej gjatë vitit 1914. Kundër kryengritësve shqiptarë përveç ushtrisë serbe mori pjesë edhe ushtria malezeze e cila u përqendrua në Gjakovë. Ushtria serbo-malazeze mori peng njerëz, dogji fshatra, shpërnguli me dhunë dhjetëra mijëra njerëz por nuk mundi të shuante dëshirën e popullit shqiptarë për çlirim e bashkim kombëtar. Për terrorin serbë dhe malazezë të ushtruar ndaj popullit dibranë, shkruajtën shumë gazeta të kohës si gazeta italiane "Corrier Della Puglia", gazetat shqiptare "Përlindja e Shqipërisë", "Liria e Shqipërisë", "Kalendari kombiar", në të cilat u pasqyrua qartë djegia e 80 fshatrave shqiptare, therja dhe hedhja gjallë e 2554 burrave, grave dhe fëmijëve shqiptarë të moshës mbi 12 vjeçare, rrëmbimi i mijëra bagëtive, plaçkitja e pasuritë dhe dërgimi i tyre në Beograd etj. . Edhe ata të cilët mbijetuan një pjesë u detyruan ta braktisin vendin për shkak të mbijetesës dhe represaljes të paparë të ushtrive sërbo-malazeze.

PËRFUNDIM

Në shtator të vitit 1913 Dibra u bë qendra kryesore e kryengritjes antiserbe që u përhap nga Gjakova deri në Ohër. Populli dibran u bëri qëndresë të fortë trupave pushtuese serbe dhe kundërshtoi aneksimin e kësaj krahine nga Mbretëria serbe . Prijësit më në zë të kësaj lëvizjeje konsideroheshin Mersim Dema, Elez Jusufi, Suf Xhelili, Qazim Lika, Sefedin Pustina, e shumë luftëtarë të tjerë të cilët i treguan diplomacisë europiane se vendimet e konferencës së Londrës për aneksimin e viseve shqiptare nga shtetet fqinje janë të padrejta dhe se duhet korrigjuar. Masakrat serbo-malezeze të shtatorit të vitit 1913 dhe qëndresa e shqiptarëve zunë një vend të konsiderueshëm në raportet e konsujve të huaj dhe në editorialet e shtypit të huaj dhe vendas madje Fuqitë e Mëdha pranuan masakrat e ushtrive serbo-malazeze ndaj kryengritësve dibranë. Pas shumë përpjekjesh dhe luftimesh Dibra në shtator të vitit 1914 u lirua nga serbët.

1. Fjalor enciklopedik, Tiranë, 1985, faq. 665
2. Historia e popullit shqiptarë, Tiranë, 1996, faq, 145
3. Po aty..., , faq. 145
4. Moisi Murra, Mersim Dema, Mbret i Maleve, Tiranë, 2003, faq. 133
5. Gazeta"Përlindja e Shqipërisë"Vlorë, 21/4, Vjeshtë e I 1913, nr. 16 (Cituar sipas Moisi Murrës Mersim Dema mbret i maleve, Tiranë, 2003, faq. 124
6. Gazeta zyrtare"Srpska Norme"12/25 shtator 1913 nr. 199(cituar sipas Mosi Murrës, "Mersim Dema, mbret i maleve"Tiranë, 2003, faq. 121
7. Po aty. faq. 124
8. Po aty., faq. 125
9. Liman Rushiti, Revista Jehona, nr. 6, Shkup, 1993, faq. 98 (Cituar sipas Moisi Murra"Mersim Dema, mbret i maleve"Tiranë, 2003, faq. 127)
10. Zekria Cana, Populli shqiptarë në kapërcyell të shek. XX, Prishtinë, 1990, faq. 175-176
11. Gazeta"Srpko Norne", nr. . 199, Beograd, 25 shtator, 1913(cituar sipas Mosi Murrës"Mersim Dema, mbret i maleve, Tiranë, 2003, faq. 132)
12. Mersim Dema, v. p. e cituar, faq. 128-129.
13. Po aty. . . faq. 130
14. Fjalori enciklopedik shqiptarë, Tiranë faq. 561
15. Historia e popullit shqiptarë, Tiranë, faq. 145
16. Mersim Dema, v, p. e cituar, faq. 138

Rruga e Arbërit

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORËT

Të nderuar bashkëpunëtorë,

Për të pasur një bashkëpunim të suksesshëm, ju lutemi të kini parasysh disa kritere për materialet që sillni pranë redaksisë.

- Shkrimet duhet të jenë të daktilografuara, jo më shumë se 1500 fjalë (10000 karaktere, përfshirë hapsirat). Shkrimet duhet të përmbajnë shkronjat "ë" dhe "ç". Shkrimet me më shumë fjalë, do ti nënshtrohen procesit të redaktimit.
- Fotografitë për shkrimin duhet të jenë me diçiture dhe më emrin e fotografit.
- Materialet me karakter aktual dhe problematikën e ditës kanë përparësi botimi.
- Materialet historike, recensat apo portretet, nuk do pranohen për botim, n.q.s. ato konstatohen se janë botuar në ndonjë media tjetër apo rrjete sociale.
- Shkrimet duhet të jenë origjinale dhe të respektojnë të drejtat e autorit.
- Shkrimet duhet të sillen nëpër nëpërmjet Postës Shqiptare në adresën e gazetës, postës elektronike në e-mail <**rrugaearberit@gmail.com**>, ose mund tu dorëzohen personave të autorizuar nga redaksia.
- Shkrimet që janë jashtë platformës së gazetës, nuk botohen dhe redaksia nuk është e detyruar të japë shpjegime për çdo rast.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, ju përcjellim konsideratat më të mira për bashkëpunimin e deritanishëm.

Për sqarime më të hollësishme mund të na kontaktoni me email në adresën <**rrugaearberit@gmail.com**>

Redaksia.

Rruga e Arbërit nr. 90

studim

Në Çidhën mbi Qaf Kala ndodhet kalaja e Skënderbeut ndoshta kalaja e parë e ndërtuar nga gjyshi i tij Pali, i cili më pas mori në zotërim fshatrat Sinë dhe Gardh, përfshi Gardhin e Epër në Çidhnën e Vogël

Kontributi i çidhnakëve për pavarësi

Nga **MUSTAFA TOLA***

570 vjet më parë më 28 nëntor 1443, Gjergj Kastriot Skënderbeu ngriti në Krujë flamurin e lirisë me shqiponjën dykrenore, flamurin e të parëve të tij dibranë, nga Krahina etno-kulturore e Çidhnes. Kjo date e rendesishme shenon edhe nentorin e pare te lirise se shqiptareve.

Në fjalën para popullit të Krujës dhe luftëtarëve të tij Dibranë tha:

"Armët nuk jua solla unë, por ju gjeta të armatosur, Lirinë e pashë e se e keni kudo, në kraharor, në ballë, në shpatat e në ushtat" (M. Barleti, Bot. II, f. 94).

Me 300 luftëtarë kthehet nga beteja e Nishit, natën e të 7-tes ditë në Dibër ku në fshehtësinë më të madhe thirri disa nga të parët e vendit (M.B. f. 65, bot. II) të cilët me besim pranuan kërkesat e Skënderbeut.

Sigurisht burrat me të cilët bisedonte, këshillohej e merrte vendimet, ishin nga njerëzit e tij të gjakut e të origjinës çidhnake. Pasi mori edhe rreth 300 luftëtarë të tjerë dibran veç atyre që e shoqëruan nga Nishi, u nis për në Krujë, ku më parë kishte dërguar me pak burra Hamzan.

Pasi mori Krujën dhe territoret që i kishte lënë i ati – Gjon Dibrani, vazhdoi punën për mbledhjen e Kuvendit të princave shqiptarë në Lezhë.

Më 2 mars 1444, nga Kuvendi u formua Besëlidhja e Lezhës më një ushtri të përbashkët sipas angazhimit të Princave Shqiptarë nën komandën dhe flamurin e Skënderbeut. U themelua kështu shteti shqiptar pas shtetit të Arbrit, kesaj here në territor më të gjerë.

Me origjinë dibrane të Kastriotëve janë marrë historianë si Kristo Frashëri, Fatmir Hadri etj, si dhe studiuesit dibranë Ali Hoxha, Haziz Ndreu, Besnik Kbej, Fatos Daci, Murat Koltraka etj, prandaj nuk do ndalem në këtë trajtesë.

Por nuk mund të rri pa përmendur se në krahinën e Çidhnës janë të gjitha bashkë ato që kërkohen nga historianët e ndryshëm copa-copa, nëpër territoret shqiptare me dëshirën e mirë për të patur secili të vetin Heroin Kombëtar, apo me qëllimin e keq për ta ngatërruar e vështirësuar unifikimin e shqiptarëve për origjinën dibrane të Kastriotëve, pikërisht nga krahina e Çidhnës, pjesë e së cilës janë edhe fshatrat Sinë, Gardh i Poshtem, Gardhi i Eper(perfshin territori mbi Sinën e Epër dhe Katunin e Epër në Sherxheth të Cidhnës së Poshtëme e Qafe Kalan), dhe fshatrat Kastriot e Kukaj me CELIASIN ngjitur, në të dyja anët e Drinit të Zi , kufi me Krahinen se Cidhnës ndodhen edhe Mazrekat. Banorë të vjetër të Maleve të Zeza që shtrihen në të dy anët e Setës me qendër në AS, AZ (ose Arras) me trojet e vjetra në Çidhën te poshtme dhe trojet e Mzeze në Sinë të Epër, me fushën e përbashkët të Hasit në Kastriot, 1-2 km larg Drinit, apo arat ne Has (lagjia Sule) ngjitur me Salbatren ne Fushë Alin e sotme pjesë e Cidhnës.

Toponimet e shumta për Kastriotët dhe memoria e transmetuar me gojën e popullit nëpër odat çidhnake për Skënderbeut e Kastriotet, përfshi mendimin e historjanëve të shumtë mes të cileve edhe atë të Prof. Kristo Frashërit, nuk lënë vend për dyshime. Prandaj jo rastesisht në SINE është ndërtua edhe Muzeu i Vendorigjines së Kastriotëve.

Në Çidhën mbi Qaf Kala ndodhet kalaja e Skënderbeut ndoshta kalaja e parë e ndërtuar nga gjyshi i tij Pali, i cili më pas mori në zotërim fshatrat Sinë dhe Gardh, përfshi Gardhin e Epër në Çidhnën e Vogël, ku ndodhet Pusi i vjetër i Dukës, dhe më tej Pal Pus dhe Pusi i Palit në Sinën e Epër , territoritore keto të tokës së të parëve të Kastrioteve, të vendosur në Malet e Zeza qe fillojne ngjitur me Drinin e Zi në aneën e tij përendimore, me Guri i Zi, Hala e Zezë, Majat e Zeza, Kroji i Zi, Pylli i Zi, hurdhat e Mzeze, Gjurra e Mzeze, Prroi i Mzeze, Trojet e Mzeze etj. etj. Gjon Kastrioti fillimisht i zgjeroi territoret në drejtim të Dibrës dhe Matit. Në Mat kufi me krahinen e CIDHNES, ndërtoi kalanë e Stelushit që kontrollonte e dominonte Matin, 2 orë me në jug, të Qafë Kalasë (Kalaja e parë e Kastriotëve). ende e pastudjuar dhe pa eksploruar , edhe sot per arsye të terrenit të vështirë ku ndodhet dhe interesimit të pakët të historianëve. Pas vdekjes së Gjon Kastriotit në kalanë e Stelushit të Matit ka banuar e shoqja e Gjonit, Vojsava me vajzën



Mustafa Tola te Muzeu i Skënderbeut në Lezhë

Mamica, por kjo e dhënë është shumë pak, dhe nuk përbën argument për të pretenduar origjinën matjane të Kastriotëve. Sigurisht Barleti kur përmend Matin, ka parasysh Ematian e dikurshme, siç shënohet edhe në përkrenaren e Skënderbeut:- Princi i Ematias, ku përfshihet edhe Dibra me gjithë territoret e Penestisë dhe ato Maqedone.

Krahina e Çidhnës shpeshherë, është përfshirë e copëtuar ose jo në territore të ndryshme administrative, si periferi e tyre, për ta patur më të mundur nënshtimin dhe administrimin e saj. Pushtusit shpesh e kane coptuar Krahinen e Cidhnes per ti prishur strukturën e vet organizative tradicionale, si mal e krahinë që vetëqeverisej, pa ju nënshtruar atyre, Në të gjitha kohërat CIDHNA i ka ngjarë një krateri vullkanik që vetem përkohësisht mund të jetë shuar, por herë pas here është riaktivizuar duke ndezur shpesh edhe zjarrin e kryengritjeve ndërkrahinore e mbarëkombëtare.

Herë pjesë e Balshajve e me vone e pashallëkut të Bushatllinjve të Shkodrës. Herë pjesë e pashallëkut të Prizrenit, Manastirit, e Pashallëkut të Ohrit, apo te Janines me Ali Pashën. Ndonjëher edhe e ndarë mes pashalleqeve të ndryshme, per ti hequr mundësin Cidhnës që të organizohej në kryengritje si e bashkuar.

Kjo ndarje ndodhi edhe pas 29 nëntorit të vitit 1944, kur u nda në katër pjesë me 4 administrata të ndryshme, Reç, Muhurr, Shumbat dhe Kastriot, si pasojë e luftës së Fush -Alies dhe Sinës që krahina Çidhën beri kundër forcave partizane në korrikun e vitit 1944. Megjith perpjekjet, armiqte kurrë nuk arritën të shkatërrojnë organizimin e saj të mbrendshëm dhe ta shuajnë në shekuj qëndresën e kësaj krahine martire, si mali më i madh e më i rëndësishëm ndër 9 malet e Dibrës.

Kujtojmë me këtë rast qëndresën e jashtëzakonshme që banorët e qytetit të lashtë Oene (Cidhna e Lashte), të cilin edhe historiani K. Frashëri në librin "Historia e Dibrës" (f. 61) e disa studiues të tjerë, e percaktojnë si Gjiteti i Çidhnës, ku mbreti maqedon Perseu, kreu mbi banoret në vitin 168 p.e.r. një masakër të t'merrshme, për rezistencën e gjatë dhe humbjet që pësoi per ti pushtuar. Sipas Tit Livit;- Oenea mbrohej nga njëra anë prej lumit Artati ("Seta" sipas K.Frashërit.) dhe nga ana tjetër prej një mali shumë të lartë.

Artati ndoshta është quajtur Seta, në rrjedhën e poshtme te saje ndodhet fshati Arras ngjitur me lumin Drinin e Zi. Nga lumi Artati besojmë se fshati ka marrë edhe emrin, dikur një fshat bashke me Zallë e Kodër Leshe, i ndarë në mes prej tij.

Gjithë burrat u vranë, gratë dhe fëmijët u zunë rob, të tjerët ju lanë ushtarë për plaçkë.

Oenea sipas Titi Livit përveçse kishte një pozitë të mirë ishte edhe rrugëkalimi për në krahinën e Labeateve ku sundonte mbreti Gent.

Në territorin e Çidhnës, në terrenin e vështirë dhe shkëmborë të maleve të zeza, ndodhen mbi 30 shpella me dimensione të ndryshme, të përshtatshme për strehimin e shumë banorëve. Ne to janë strehuar ndërkohe në luftëra banorët vedas për rezistencë, tërreni i tyre i veshtire nuk është pushtuar kurrë nga këmba e ushtareve të huaj.

Territori i gjerë i krahinës me kullota të pasura e pyje, me fusha e laguna pjellore, me burime ujore të shumta e të mrekullueshme, ka tërhequr vazhdimisht banorë nga krahinat e tjera. Sa herë që pas masakrave, popullsia vendase është pakësuar, ka ndodh pas tyre ripopullimi i Krahines se Çidhnës. Kështu ka ndodhur edhe pas masakrës tjetër të vitit 1466 që bëri Sulltan Mehmeti II mbi CIDHNEN, i cili pasi mori me tradhëti e pabësi kalanë e Çidhnës, kreu masakrën e t'merrshme ku shkoi në thikë 8000 burra, veç grave dhe fëmijëve. Kjo ndodhi sigurisht pas një qëndrese të fortë nga çidhnakët, dhe në shenje hakmarrje e urrjejte për Skëndërbeun mbi njerëzit e tij të afërt, meqë dështoi në rrethimin e dytë të Krujës gjatë kthimit për Kostandinopojën pasi la më parë Ballaban Bashën me 80.000 ushtarë për të vazhduar rrethinën e Krujës.

M. Barleti shkruan (f. 629, botim II) Në udhë e sipër ai (Mehmeti) joshi me premtime e të holla të shumta disa popullsi të Kaonis dhe vise të Skënderbeut që quheshin Ridna. Prej tyre 8.000 burra, veç grave dhe fëmijëve, tirani i shkoi në thikë...(Po aty, f. 631 M.B.). Tek fjala e Skëderbeut drejtuar princave shqiptarë, vazhdon...;- "Mehmeti... duke u larguar që këndej si ndonjë i xhindosur... vrau dhe zhduku me hekur 8.000 burra nga të mitë, pa zënë në gojë gratë dhe fëmijët... Këto po te ishin gjallë, dhe ti kisha unë tani, me siguri që nuk do të ishte aspak nevoja të lypja ndihmën e tjetërkujt.

Nga këto fjalë merr më shumë kuptim origjina çidhnake e Skënderbeut, dhe e fisit te Kastriotëve si banore të krahines sonë.

Më 17 janar 1467, vdiq në Lezhë kryetrimi legjendar Gjergj Kastrioti që zhvilloi për 25 vjet 30 beteja kundër turqve dhe humbi vetëm 1, atë të Beratit. Ai mbeti legjendë dhe frymëzimi i gjallë për lirinë e shqiptarëve.

Pas vdekjes së Skënderbeut, duket sikur rezistenca e shqiptarëve u shua, por më 1560 megjithëse dokumente për kryengritjet e mëparshme mungojnë, vetë Sulejmani i Madhërishëm i pohon ato në një ferman që i drejton sanxhakut të Ohrit, në përgjigje të letrës që kadilerët e Dibrës, Matit me Koçi Çaushin, i kishim dërguar më 27 shkurt 1560, Ai shkruan:-

Ju i dërguat shkresë Portës sime, me të cilën raportonit se u grumbulluan më se 500 profetë (të krishterë, K. Frashëri.) fshatarë nga Reçi, Dardha, Vlashaj, Pregë e Keden (Çidhna, K. Frashëri) dhe Lurë prej nahijes së Dibrës së Poshtme, të cilët prej një kohe janë të dëgjuar për kryengritje. Sulltani jep urdhra për shtypjen e kryengritjes, për t'u marrë pasurinë dhe arrestuar familjet për t'i shitur si skllevër në treg.

Malësorët e Çidhnës Epër dhe Çidhnës Poshtë nuk u paraqitën në regjistrimin e vitit 1560 dhe vazhdojnë të mos paguajnë taksa.

Më 1602 përfaqësuesit e Çidhnës, Jozef Kastrioti, Martin Manësi e Gjon Çidhna morën pjesë në Kuvendin e Dukagjinit në Mat, ku u betuan të marrin pjesë në kryengritje kundër turqve. Vini re 3 firmëtar te kuvendit perfaqesues te Dibres nga krahina e Cidhnes,sigurishte jo rastesisht.

Edhe në vitet 1690, 1711, 1712 malësorët e Çidhnës, Reçit e Dardhës i gjejmë përsëri në kryengritje, për t'mos ju bindur pushtuesit duke kundërshtuar me armë pagesën e taksave.

Man e Mustaf Tola pas shtypjes se kryengritjes dolën kacak në male dhe u vendosen më pas në Shtushaj, të ndihmuar nga Troci i Reçit.

Zaim Ahmet pas kthimit nga burgu i Nishit, organizon fshatarët çidhnakë si Gjon Hoji, Sekbrani Prendin e Papa Meskin përsëri në kryengritje që gjithashtu shtypet.

Në Dibër gjatë viteve 1700-1830 vazhdon anarkia feudale me përplasjet midis oxhaqeve dhe bujqve e fshatarëve të zonave malore e fushore të Dibrës së Sipërme e Poshtme dhe midis oxhaqeve e pushtetit qendror osman.

Oxhaqet e Hoxhollit dhe Karasanit më 1795 cilësohen si kryengritës nga pushteti Qendror.

Më 1790 ndihmuan Karamahmut Pashën kundër Malit të Zi, por kur Pasha u pajtua me Sulltanin dibranët u kthyen kundër tij.

Më 1793 nuk pranuan të binden as Ali Pashë Tepelenes, dhe dibranët i thyen forcat e tij në Merovisht afër Strugës ku u dalluan luznakët. Porta për t'i nënshtruar Dibrën e Epër e kaloi në vartësi të sanxhakut të Ohrit, ndërsa Dibrën e Poshtme nën sanxhakun e Manastirit. Por nuk pati sukses dhe përsëri më 1815 ngarkoi Mustafa Pashë Bushatlliun ti shtypte, që gjithashtu nuk pati sukses dhe pashallëku i shkodres u shua me 1831.

Më 1821 rreth 800 malësorë të maleve të Dibrës, prej tyre shumë Çidhnakë shkuan në Janinë në ndihmë të Ali Pashë Tepelenës kundër ushtrive turke, ku shkruan faqe të shkëlqyer heroizmi me qëndresën e tyre në momentet e fundit.

Kënga:

T'kisha pas ma shumë Dibranë
Ato brejtshin hekur me dhëmbë
Janinën turkut s'ja kisha lënë.

Rezistenca e armatosur e pashallëqeve të Shkodrës e Janinës e dobësoi perandorinë Osmane, por nga shembja e tyre përfituan grekërit që fituan më 1821 pavaresin, kurse serbët, malazezët, rumunët e bullgarët fituan autonominë nacionale. Ndërsa shqiptarët mbetën si më parë pa të drejtë nacionale.

Më 1833 në shkurt krahina e Çidhnës nën udhëheqjen e Vesel Lushës e Sali Nokës kundërshtuan me armë regjistrimin. Armata turke mobilizoi 8.000 ushtarë për shtypjen e kryengritjes. Vesel Lusha, Sali Noka u strehuan në Mat, pasi u shtyp kryengritja.

Më 1836 përsëri malësorët çidhnakë i gjejnë në kryengritje bashkë me Reçin dhe Katër Grykët e Murrës, që mungojnë në regjistrim.

Malësia Dibrane vazhdonte të ishte e organizuar si më parë në 9 male, që vetëqeveriseshin sipas traditave dhe nuk paguanin taksa e nuk jepnin ushtarë.

Turqia shpalli në nëntor 1839 reformat e Tanzimatit. Osmanët u përpoqën të vendosin adminsitratën e tyre edhe në malet e Dibrës për të marrë ushtarë e vjelur taksat, por dibranët nuk pranuan.

Më 1844 vjen për të shkelur Dibrën Hajredin Pasha me 12000 forca. Më 18 shtator niset nga Tetova dhe hyjnë në Dibër më 23 shtator. Por rezistenca që ndodhi në grykën e Radikës dhe frika e rezistencës së madhe që priste nga malet e detyroi të bëjë 1 muaj përgatitje në Dibër.

Besëlidhjet krahinore në Dibër tashmë kapërcejnë kuadrin e ngushtë lokal dhe merrnin përmasa ndërkrahinore midis Maleve dhe fushës.

Besa u lidh në Kuvendin e Maleve tek Kalaja e Grazhdanit.

Më 23 tetor 1844 forcat turke sulmuan Gjoricën, për të thyer malësorët e maleve dibran, të cilët u vunë në mes 2 zjarresh, të sulmuar në shpinë edhe nga forcat e Xhemal Pashë Sakatit të Matit (A. Matkoviski, f. 72).

Pas luftimesh të ashpra malet u thyen, por përsëri ato i ruajtën venomet e tyre.

Lufta u zhvillua e përgjakshme, pati të vrarë e të plagosur me mijëra në të dy anët. Ajo u përjetësua në këngën e popullit, me disa variante.

Në variantin e vjetër thuhet:

"900 varret kush i bani
Sal Demajri e Sheh Zerqani"

Luftimet u udhëhoqën nga Sal Demiri Alia, Cen Leka, Salë Markja dhe Sheh Mustafa i Zerqanit.

Në odat dibrane thuhej se luftën kundër Hajredin Pashës e bani Sal Demajri me pushkë, e sheh Zerqani me bukë (meqë shkriu pasurinë për luftën, duke furnizuar luftëtarët me ushqime).

Konsulli rus M. Hitrov shkruan më 1864. Banorët e Dibrës së Epër paguajnë disa tatime e taksa dhe vetëm 2 kishin pranuar të jepnin rekrutë... përkundrazi banorët e Dibrës së Poshtme nuk japin as tatime as nizame. Sipas Hitrovit dibranët edhe pse kishin kaluar 100-200 vjet në fenë islame, ishin të lidhur ngushtë me banorët katolikë të Mirditës.

Më 1866 përsëri Çidhnakët zhvillojnë një betejë të përgjakshme kundër truqeve në Fushë Ban, ku pihatin (munden) 3 ordi turke.

Më 1872 çidhnakët përsëri luftojnë kundër Demir Pashës, thyejnë forcat turke dhe vazhdojnë luftimet në kullat e Hasan Shinit në Brest të Epër.

(Vijon në numrin e ardhshëm)

Manastiri njëqind vjet pas Shpalljes së Pavarësisë

Nga **QENAN HASANI**, *Manastir*



Qyteti që deri në çlirimin pas Luftës së Dytë Botërore ishte i banuar me shumicë shqiptare e që kishte dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm, jo vetëm në ruajtjen e identitetit kombëtar, por edhe në krijimin të shtetit të parë sovran.

Manastiri, sipas të dhënave statistikore të vitit 1908, pra në vitin e Kongresit të Alfabetit, ka numëruar gjithsej 87.532 banorë nga të cilët, 31 mijë ose 35.4 për qind kanë qenë të përkatësisë etnike shqiptare. Si qendër vilajeti në të është sistemuar korparmata e tretë e imperisë osmane dhe 12 konsuj të shteteve më me ndikim në Europë, që ka qenë edhe shkaku i vërtetë që këtu janë zhvilluar shumë aktivitete, jo vetëm të shqiptarëve, por edhe të popujve tjerë. Sipas të dhënave historike, të gjithë rilindësit shqiptarë strehim dhe terren të sigurtë për veprim kanë gjetur mu në këtë qytet, ku edhe kanë qenë të inkuadruar edhe në institucionet shtetërore dhe luftarake të sundimtarëve osmanë. Këtu, në vitin 1905 themelohet Komiteti i fshehtë për Çlirimin të Shqipërisë, i cili pastaj themelon nënkomitete në të gjitha qytetet shqiptare në Shqipëri dhe Kosovë. Disa muaj para mbajtjes së Kongresit, themelohet edhe Klubi qëndror "Bashkimi", i cili merr për sipër bashkimin të të gjitha klubeve shqiptare që vepronin në vend dhe diasporë dhe organizon mbajtjen e Kongresit të Alfabetit. Sipas historianit manastiras, prof. dr. Reshat Nexhipi, kjo periudhë është e artë." Periudha që nga themelimi i Komitetit të Fshehtë për Çlirimin e Shqipërisë, për të vazhduar me themelimin e Klubit "Bashkimi" dhe konvokimi i Kongresit të Alfabetit, që ishte rezultat i reagimit me kohë të atdhetarëve shqiptarë pas shpalljes së Hyrijetit, është periudha e artë, jo vetëm për Manastirin, por edhe për historinë shqiptare në përgjithësi", shprehet Nexhipi." Një rol të jashtëzakonshëm në mobilizimin e shqiptarëve ka luajtur edhe shtypshkronja universale e Qiriazëve, të cilët ishin edhe më të vendosur në luftën për ruajtjen e gjuhës dhe shkrimit shqip, si nëpër shkolla, ashtu edhe nëpër kisha e xhami, në të cilën u botuan mbi 300 mijë libra", shton Reshati. Nuk duhet harruar se në këtë periudhë, në gjimnazin e Manastirit, zëvendësdrejtor ka qenë atdhetari Bajo (Bajram) Topulli, vëllai i luftëtarit Çerçiz Topulli. Shtyllë e vërtetë ka qenë edhe koloneli, kryefarmacisti i Korparmatës së Tretë, Halit Vreto Bërzeshta, i cili së bashku me Bajo Topullin themelojnë Komitetin e Fshehtë.

"Hapja e shtypshkronjës së parë universale, e cila shtypte libra në 13 gjuhë, jo që intensifikoi luftën e atdhetarëve për ruajtjen e identitetit, por edhe bëri bujë të madhe në mesin e ndërkombëtarëve, të cilët filluan të interesohen për situatën e shqiptarëve", thotë Reshat Nexhipi, i cili, në një moment do të shprehet: "Kjo periudhë është e papërsëritshme në historinë e popullit shqiptar. Këtë e them me përgjegjësi të plotë, nga se, edhe vetë akti i shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, zanafillat i ka në Manastir, aty gatuhej ajo bukë", përfundon ai.

DEPËRTIMI I USHTRIVE SERBE, FATALE PËR ETNOGRAFINË E MANASTIRIT.

Nëse periudhën që nga themelimi i Komitetit të fshehtë, themelimi i klubit "Bashkimi", organizimi i Kongresit të Alfabetit dhe themelimi i shtypshkronjës Universale, të cilën e falimentuar serbët për arsye se pronarët ishin shqiptarë[, e quajtëm periudhë e artë, periudha pas fillimit të Luftërave Ballkanike e deri në fillimin e LNÇ-së, është periudha më e zymtë, për të gjithë shqiptarët, por më shumë për shqiptarët e Manastirit. Nën trysnin e serbëve, shqiptarët e konfesionit islam i nënshtrohen masakrave, kurse për të shpëtuar kokat nga thikaxhinjt serbë, edhe shpërnguljes masovike për në Turqi respektivisht fillon zbatimi i separateve të Akademisë Serbe për zhdukjen e shqiptarëve.

Edhe më tragjike ishte situata e shqiptarëve ortodoksë, të cilët sipas të dhënave në Manastir kanë qenë rreth tetë mijë, i janë nënshtruar asimilimit, përmes kishës dhe martesave, duke i ndaluar edhe të flasin gjuhën të tyre shqipe. Edhe ata të cilët ia kanë dalë të mbajnë në kujtesë përkatësinë të tyre etnike e fetare, ruajtur gjuhën shqipe, edhe sot e gjithë ditën, në dekadën e dytë të milenioumit të tretë druajnë të deklarohen si shqiptarë (rasati i pasardhësve të Qiriazëve si dhe rasti i pianistes Meri Kavkaleva, të cilës i kërcënohen se deklarohet se është shqiptare dhe se dëshiron të flasi gjuhën të saj amtare!) Edhe pse u orvatëm të sigurojmë të dhëna të sakta për numrit të shqiptarëve të shpërngulur në Anadoll, edhe myftinia nuk ishte në gjendje të na thotë të vërtetën.

Në Luftën Nacionalçlirimtare shqiptarët e Manastirit që në fillim morën pjesë aktive, kështu që luftëtarët e parë (edhe në mesin e maqedonasve) ishin Nafi Sulejmani nga fshati Tërnovë dhe Fahri Ibrahimi nga fshati Xhinxhapolë (Iniyheopolë), ky i fundit u vra në fshatin Lubojnë për të shpëtuar flamurin e radhës "Dame Gruev", kurse i pari u bë edhe komandant i Brigadës IV (VII) Sulmuese shqiptare, me të cilin, shpeshherë kishim diskutuar për pjesëmarrjen e shqiptarëve në këtë luftë, ai pendohej thellë. Në një moment na pat thënë: "Komunizmi kryekëput është regjim antishqiptar. Të gjithë ata që iu bashkëngjitën kësaj lufte, kanë luftuar në atë të gabuar. Ne shqiptarët

Ishte dashur të luftojmë për tokat tona. Në fillim të "çlirimit", intelektualët shqiptarë të qytetin të Alfabetit, për herë të fundit kanë ngritur flamurin kombëtar[me rastin e shënimit të 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit në vitin 1946."Ky trend do të vazhdonte edhe në ditët e sotme, nëse nuk prisheshin marrëdhëniet ndërshtetërore midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë", shprehet Reshat Nexhipi me një dozë të shtuar të nostalgjisë.

Edhe maqedonasit, nën ndikimin të Beogradit, ia filluan politikës antishqiptare, kështu që, që nga viti 1953 e deri në vitin 1965, sipas të dhënave të myftiut të Manastirit, Pllumi Veliu, për në turqi janë shpërngulur gjithsej 38 mijë muslimanë, shumica e të cilëve, mbi 80 për qind kanë qenë shqiptarë."Se në çfarë kushtesh kanë jetuar dhe janë shpërngulur shqiptarët, do të shërbehem me një të dhënë

konkrete, nëse serbët ia dolën të shkatërrojnë 30 xhami, po aq ia dolën të shkatërrojnë edhe komunistët" thotë Veliu. Pas kësaj, fillon edhe diskriminimi i shqiptarëve të Manastirit vazhdon me egërsirë edhe më të madhe pas ngjarjeve të Kosovës më 1981 –shin. Pushtetarët ua kufizuan të drejtën për jetë shqiptarëve, kur miratuan një vendim për ndalim të shitjes, respektivisht blerjes së mallit të patundshëm shqiptarëve, me motivacion të ndërpresin shqiptarizimin të brezit gjatë kufitar për, kinse, krijimit të kushteve për krijimin të Shqipërisë së Madhe. Ky ishte edhe një presion i llojit të vet për t'i detyruar shqiptarët të braktisin vatrat e tyre stërgjyshore, kështu filluan të shpërngulen masovikishtë për në Australinë të largët, ku, nëse këtu kemi 5000 shqiptarë, atje i kemi dy fish më shumë, e kështu siç kanë marrë punët, së shpejti ky numër do të jetë edhe i tre fish, ndoshta edhe katër fish më i madh.

Pluralizmi politikë, në fillim nga shqiptarët e Manastirit, jo që u prit me entuziazëm, por edhe me bindje se këtu përfundojnë diskriminimet. " Ishte ky një moment kur u shkarkuam nga barra se këtu përfundojnë vuajtjet e shqiptarëve, dhe se në sistemin shumëpartiak dhe demokracinë e paralajmëruar, shqiptarët e Manastirit do t'i realizojnë, të paktën, të drejtat më elementare.", shprehet prof.dr.Reshat Nexhipi. "Ata pak intelektual që ishim, edhe përkundër ndjekjeve, ia dolëm të themelojmë fillimisht degën e PPD-së, pastaj edhe pas shumë dekadash ta ripërtërim emrin e Klubit "Bashkimi", duke themeluar kështu SHKASH-në "Bashkimi", e cila sot, mjerisht, edhe nuk funksionon", shprehet i revoltuar prof.dr.Reshat Nexhipi. Paraqitja në skenë edhe të partive tjera, sikur negativisht ndikuan në jetën e shqiptarëve të Manastirit, të cilët, edhe pse të mbetur me pakicë ekstreme, për do interesa materiale, filluan të përçahen, kështu që në kuadër të këtyre 20 viteve pluraliste, për shqiptarët e Manastirit vite të arta ishin dy vitet para të kryengritjes shqiptare, kur në institucionet dhe ndërmarrjet shtetërore u zgjodhën gjashtë drejtor dhe dy zëvendësdrejtorë, të cilët punësuan më se 50 veta.

Edhe jeta kulturore dhe arsimore ishte në një nivel tjetër. Shumë fëmijë shqiptarë iu kthyen shkollës shqipe. Organizoheshin manifestime kulturore e muzikore. Por, kjo nuk zgjati shumë. Pas dy vitesh, më 2001 –shin filloi kryengritja, pas së cilës, edhe pse në pushtet hymë me një marrëveshje për barazi të plotë, ndodhi që shqiptarët e Manastirit t'i nënshtrohen diskriminimit edhe më të theksuar, kështu që sot, autoritetet e pushtetit lokal, as që i përmendin shqiptarët, e jo edhe të interesohen për nevojat dhe kërkesat e tyre, ky edhe është një ndër shkaqet që manastirasit, me viza të blera, edhe përkundër vullnetit të tyre, udhëtojë drejtë Australisë.

Do të ishim të padrejtë, nëse nuk protestojmë se, e vetmja fitore gjatë këtyre viteve të pas konfliktit, është themelimi i Muzeut të Alfabetit, i cili, i atillë siç është, vetë objekti flet për një të kaluar të bujshme të këtij qyteti që popullit shqiptarë ia dha pasurinë më të madhe, shkrimin e gjuhës shqipe.

Rizvan Alla me Sokore...

Nga **DESTAN RAMA**

Zerqani, ky emër i bukur vjen përpara nesh si një muze i fuqishëm magjik.Themi kështu, sepse këtu gërshetohen e lidhen së bashku bukuria e magjishme e natyrës, bukuria dhe mrekullia njerëzore, trimëria, zgjuarësia, mençuria e mbi të gjitha krenaria, si vete malet qe e rrethojnë.

Në mesjetë njihej me emrin "Tamadia" e me pas Zerqan, vend i arte. Pozicioni i volitshëm gjeografik, klima e mrekullueshme, uji që ngjall njeriun, pemët, dimri me borë por i butë, vera e freskët, e bëjnë këtë vend të mahnitshëm. Sa here vjen pranvera, ashtu si kudo, edhe këtu gjallëron jeta; bari e çel syrin e mbyllur gjatë dimrit, pema çel sythin e fjetur, kafshët ndërrojnë qimen, bretkosa nis kuaket, bilbili nuk e kursen atë të emblin zë e strehët e shtëpive zhurmojnë nga bishtgërshërat. Bashkë me këta gëzon pafund zerqanasi. Shpirti i tij ngopet me ajrin e freskët, bukurinë e luleve e mrekullinë e natyrës. Kështu ndodhi atë ditë të bukur marsi në shtëpinë e Hasan Allës nga Zerqani. Bashkë me ringjalljen e natyrës u ringjall edhe jeta në familjen e tij. Erdhi në jetë djali, që ata ia vunë emrin Rizvan. Kjo ndodhi në vitin 1819.

Vitet iknin e Rizvani i vogël hidhte shtat e rritej çdo ditë. E përkëdhelte dhe e donte shume gjyshja e tij e dashur. Ajo i tregonte përralla të bukura me kuçedra, qeros e diva, në të cilat triumfonin gjithmonë më të fortit, me të mençurit, më të shkathtët. Këta bënë të mundur edukimin e djaloshit me ndjenjen e atdhedashurisë dhe të krenarisë se ishte zerqanas, grykamadhas e shqiptar. Ai u betua se kështu do të vdiste.

U rrit djali. I kaloi të njëzetat. Hasani, babai i tij, e martoi. Rizvani, si shumë të tjerë, i detyruar nga kushtet e vështira ekonomike, shkoi në kurbet. Atje nuk e harroi vendlindjen e tij. Kuptoi më mirë se ç'ishte armiku, cilat ishin qëllimet, dhe se ç'përgjigje donte ai. Këta dhe të tjera si këta, i diskutonte me shokë, patriotë, atdhetarë, intelektualë atje në vendin e largët që e kishte emrin "Kurbet".

Atë ditë, fund tetori 1844, kur sapo kishte mbushur 25 vjeç u kthye nga kurbeti. U ndodh në shtëpinë e tij, kur u dha sinjali, sipas planit të luftës, se armiku kishte ardhë në prag të derës. Armë nuk kishte. Veshi mangoren e zezë të bërë prej qashnaje, mori sokoren në dorë e mprehu mirë e mirë si të donte me pre dru dhe doli. Në shtëpi la nusen e re dhe djalin foshnje në djep. E ndali vrapin në llogore, në frontin e luftës, në kodrat e Çerenecit. Si dragua u hodh mbi ushtrinë osmane. Sokorja e tij, ashtu si shpata e Skënderbeut, e bërë prej hekuri vringëllonte mbi shpatat dhe kokat e osmanllinjve. Ata binin në tokë me të zotin si të ishin prej kashte. A thua kishte marrë me të vërtetë krahët e shqiponjës, të skifterit apo të ndonjë shpendi tjetër të fuqishëm. Për rreth tij dëgjoheshin ofshamat e rënkimet e ushtarëve turq. Në qoftë se ndonjëri prej tyre tentonte të ngrihej, e priste sokorja bishtgjatë dhe e mprehtë, që ishte një hekur i dheut, por që korrte me dorën e fuqishme të Rizvanit për mbrojtjen e atdheut.

Por në fund u vra. Tamam si në legjenda. U këputën krahët e shqiponjës, ashtu siç këputet shkëmbi nga mali i thepisur. Gjaku i tij i paster u bashkua me dheun dhe u bë kallkan për të mos u shkrirë dhe harruar kurrë. Ky kallkan shërbeu për të ndezur gjakrat e rinisë, për të luftuar më me urrejtje kundër armikut.


Populli e përjetësoi këtë ngjarje në këngë:

.....

Kush osht ai n'ato llogore?
Rizvan Alla me sokore,
I ka bo njizet e katër vorre!
Me sokore boni xhak,
Katër vetë i ka vu nën bark!

Eshtrat e tij pushuan dhe u shkrinë në tokën e Zerqanit, që e deshi aq shume. Në tokën që lind dhe rrit aq breza e breza të pafund dhe që mban në damarët e saj gjakun e Rizvan trimit.

Ndërtimi i varrezave të të rënëve të viteve 1913-1920, do të ishte një nder i madh që u bëjmë sot veprës dhe heroizmit të këtyre martirëve



Të mos i harrojmë varret e të rënëve

Nga **DR.SHEFQET DOMI**

Ndërtimi i varrezave të të rënëve të viteve 1913-1920, do të ishte një nder i madh që u bëjmë sot veprës dhe heroizmit të këtyre martirëve që pse jo këto varreza të vizitoheshin jo vetëm nga vendas por dhe të huajt që vijnë për të parë bukuritë e rralla të Kalasë së Dodës.

Para disa javësh në sallën e muzeut historik Tiranë u mbajt një konferencë përkujtimore në kuadrin e 100 vjetorit të kryengritjes së përgjithshme të Dibrës kundër pushtuesve serb dhe eksodi i parë masiv dibranë, organizuar nga shoqata "Bashkësia dibrane" dhe "Unioni i krijuesve dibranë". Diçka e mirë që duhet përgëzuar për të tilla veprimtari.

Nga kumtesat e mbajtura u dhanë mjaft informacione me vlerë për sakrificat e popullit dibranë në mbrojtjen e trojeve shqiptare. Nuk mund të kalonin hordhitë gjakatare serbe në thellësi të tokave shqiptare pa lënë krahët e tyre në ndeshjen e parë në portat e Dibrës,Lumës dhe Shkodrës. Qindra burra, gra, fëmijë u kaluan para plumbave e bajonetave të gjakatarëve egërsira me fytyrë njeriu. Qindra u vranë, mijra bagëti u plaçitën. Britmat dhe oshëtima e fëmijëve të masakruar dridhen dhe malet.

Nuk ka laps që ta përshkruaj atë periudhë gjaku dhe eksodi biblik. Qindra burra u vranë në përleshje fyta fyt me serbët pushtues. Qindra të tjerë pleq dhe të rinj u masakruan ne grupe, të lidhur, të pa armatosur që i kapën në befasi. Këto viktima u varrosën në vende të ndryshme si në Ceren të Kalasë ku dhe u rrethuan me mure të përshtatshme, me shpresë se brezat pas tyre do të interesoheshin dhe do t'i kujtonin si martirë.

Po në fakt si qëndron e vërteta?

Është vërtet për të ardhur keq për brezat pas tyre dhe për të sotmit, për organet e pushtetit lokal, për vetë shtetin si dhe Kuvendin e Shqipërisë. Varret e të rënëve me hordhitë e huaja serbe nuk ruhen. Askush nuk e di nga familjarët se cili është varri i të afërmit të tyre. Në konferencën shkencore që u mbajt për të kujtuar 100 vjetorin e kryengritjes antiserbe pritej se do të ngrihej zëri i dikujt për ndërtimin e këtyre varreve të të rënëve. Ky zë nuk u dëgjua fare.

Në librin tim "Kalaja e Dodës apo Qafa e Bilbilit", botuar 2011 për varret e të rënëve kam bërë një sugjerim, që këto varre të rregullohen, të ngrihet dhe një obelisk dhe të jenë skalitur emrat e të rënëve. Unë kam qenë dhe jam shumë i interesuar që të rregullohen varret e të rënëve në luftën antiserbe në Ceren dhe Ploshtan. Ato e meritojnë një varr të mirë se me gjakun e tyre mburremi ne sot. Kam biseduar me kryetarin e komunës së Kalasë zotin Bajram Hima. Ai në fakt është treguar i gatshëm në parim por kërkonte fonde si dhe një projekt. Dhe unë shpreh bindjen time se asnjëherë nuk është vonë kur vendoset të bëhet diçka e mirë dhe e bukur për të rënët.

Bashkë me këtë shkrim sot po paraqes dhe projektin që në fakt na kërkoi kryetari i komunës, i cili është realizuar nga inxhinieri arkitekt Naltin Domi. Ky projekt mendoi se është më se i përshtatshëm për të rënët e vitit 1913, por dhe për ato që kanë rënë në vite ma vonë. Sigurisht, ndërtimi i këtyre varrezave kërkon edhe fonde, por shpreh bindjen se nuk duhen shumë para. Në bashkëpunim me shtetin duhet të kontribuojë domosdo dhe biznesi vendas.

Ndërtimi i varrezave të të rënëve të viteve 1913-1920, do të ishte një nder i madh që u bëjmë sot veprës dhe heroizmit të këtyre martirëve që pse jo këto varreza të vizitoheshin jo vetëm nga vendas por dhe të huajt që vijnë për të parë bukuritë e rralla të Kalasë së Dodës.

RrugaeArbërit.com

Skicë

Pse **heshtin** daullet, pse "**ngrinë**" dasmorët?

Nuk është baladë, është një rit afro shekullor...

Nga ABDURAHIM ASHIKU

Nga Ploshtani në Ceren rruga dhjetë herë zbret për të mbushur ujë bore në përrenjtë shkëmbejgrryes e dhjetë herë ngjitet për të kullotur sytë në pamjen që zhveshin bjeshkët pambarim dhe Korabi kreshtathinjur...

Këtyre dredhave rrugore, nën trysninë e asaj pamje që të ringjall, me atë ajër të pastër në mushkri, ecja një ditë shtatori të vitit 1983 hipur në një kalë dasme, ngjeshur pas samarit mbuluar me një lëkurë dashi tre vjet të pa qethur...

Në krye të karvanit, hipur në një kalë çil, një djalë i ri i shpaloste erës një flamur të kuq me shkabën e zezë dykrenore. Pas tij, mbi një kalë të bardhë, vinte nusja e pas saj tre kalorës. Dy daulle e cule, nga ato të Lumës, dridhnin tokën me gjëmimet e melodive dasmore...

Tek i ngjitesha termales së fundit, kur hapat u shtruan në rrugën që çante përmes një sheshi të madh, një heshtje varri na ngriu në vend...

Kalorësit u zbritën kuajve...

Lodërtarit i ngriu topuzi në dorë...

Kuajve, nga i pari tek i fundit, u ngriu hapi në ajër...

Njerëzve u ngriu vështrimi majtas...

Syri kishte ngrirë mbi një kodër që i qëndronte pamjes me kurorën e Korabit mbi krye si një shkëmb...

Mbi kodër një varrezë..

Gurët e varreve, ngrënë nga era, ngrica e myshku mërmërisnin në gjuhën e një kohe të largët...

Një çast dhe ngrirja u shkri. Karvani i dasmorëve nisi të lëvizë. Heshtjen në atë copë rrugë e griste vetëm valëvitja e flamurit dhe troku i kuajve. Njerëzit kishin përhumbë me vështrim majtas...

Kur rruga nisi të zbresë teposhtës së Cerenit, midis atyre shtëpive një mbi një e një pas një, tingujt e lodrës dhe cules, pasi zbritën për të marrë ujë Veleshice e fllad nga bjeshkët dhe pylli i Livadhit të Gjatë, jehuan luginës së Radomirës për tu ngjitur bjeshkëve e Kreshtave të bardha të Korabit që i qëndron Shqipërisë si zemra trupit. Gjëmuan daullet. Jehoi kënga e grave dhe vajzave që prisnin nusen. Krisën pushkët. Burrat, duke marrë ngrykë njeri tjetrin uleshin odave....

Në njërën prej odave ku isha ulur, siç është zakoni i Universitetit Populllor të Dibrës, biseda e parë nisi me historinë...

Në vjeshtë të vitit 1913, pas kryengritjes së njohur populllore të Dibrës kundër pushtuesit serb, në Ceren shkjau kishte vrarë 36 djem të rinj, kishte djegur të gjitha shtëpitë dhe kishte rrëmbyer më se njëzet mijë dele e kuaj...

Kaladodasit, në kujtim të tyre, në ditë dasmash, ndalonin për një çast frymëmarrjen e ngrinin hapin, pushonin këngën e këpusnin gjëmimin e daulleve...

Në ditë të zakonshme, në udhëtime të përditshme kalimtarët copën e rrugës përballë varreve e bëjnë duke heshtur me kokën kthyer djathtas apo majtas sipas drejtimit të rrugës që kanë marrë. Kodra quhet "Kodra e shahitëve" dhe varret quhen "Varret e Cerenit".

Në një bllok shënova, ashtu si më tha një mik studiues i historisë së zonës, emrat e 36 djemve dëshmorë. I shënova për t'i kontrolluar me faksimilen e një raporti që një i dërguar i Evropës i kishte bërë vendit të vet në udhëtimin e tij nëpër Dibër e Lumë, raport që ishte botuar në gazetën "Përlindja e Shqipërisë", organi i Qeverisë së Vlorës dalë nga 28 Nëntori i vitit të madh 1912.

Me ndonjë ndryshim të vogël që lidhej me përkthimin, emrat ishin po ata...

E nxora këtë fletë nga blloku i shënimeve që i ofron kujtdo Oda e Dibrës. E nxora për ta bashkuar me atë që sot ofron Oda e Kosovës, ajo Odë që po trondit botën me dhimbjen që përcjell, Odë përkohësisht e zhvendosur në kampe refugjatësh.

Historia e përcjellë nga Odat e Dibrës, Lumës e Kosovës, histori shekullore, tregon se kurrë serbi nuk bëhet mik. KURRË.

portret

Osman Miha, intelektuali reformator i minierave

Nga **MEVLUD BUCI**



Një jetë në minierë, gjithnjë i papërtuar si inxhinier, si studiues dhe organizator. Puna dhe urtësia, pasioni për profesionin dhe arti i drejtimit kanë bërë që Osman Miha të jetë krenar për gjurmët nëpër vite në minierën e Bulqizës. Cilido që e njeh këtë veteran të minierave mëson shumë nga thjeshtësia e korrektësia e tij. Janë malësorët fisnikë të Katundit të Vjetër, të Qafëmurrës, kolegët e ish-nxënësit e tij, të cilët ia dinë dhe lartësojnë vlerat dhe virtytet e çmuara. Kronika e një jete gjithmonë pranë njerëzve të galerive dhe të fshehtave të mëdha të tyre, dëshmon shumë. Inxhinier Osmani nuk flet vetë, por janë të tjerë kolegë e ish-nxënës të tij që flasin të, për punën e madhe studimore dhe voluminoze që ka bërë gjatë gjithë kësaj kohe.

Osman Miha u lind më 10 shkurt 1947 në Katund të Vjetër të Qafëmurrës. U dallua në të gjitha ciklet e arsimit në vendlindje si dhe më pas në teknikumin e minierave e gjeologjisë në Prrenjas. Në vitet 1967-1972 ishte një student i përkushtuar në fakultetin e gjeologji-miniera në Tiranë.

Osmani u rrit dhe u edukua i lidhur ngushtë me familjen, fisin, vëllazërinë. Është nip në fisin e njohur të Hasbajramit në Kacni, ku pikërisht në këtë familje patriotike më 1878 qëndroi tek kulla e tij Abdyl Frashërit. Në udhët e jetës së Osman Mihës mëson shumë se si e nisi udhën e jetës. Nga nxënës në vendlindje, student në Tiranë e më vonë inxhinier e kuadro në qytetin minator të Bulqizës, qytet ky që ende e mban lidhur shpirtërisht. Në vitet 1965-1967 shërben brigadier dhe më pas teknik miniere në Bulqizë. Në vitet 1972-1975 përgjegjës sektori dhe kryeinxhinier kantieri në ndërmarrjen e ndërtimit të minierave. Në vitet 1975-1990 drejtor i shkollës së mesme, në vitet 1990-1992 mësues në shkollën e mesme dhe në vitet 1993-1994 drejtor i ndërmarrjes së bukës në Bulqizë. Në vitet 1994-1997 del i papunë si rezultat i reformave. Në vitet 1997-1998 përgjegjës zone në Zona "D" dhe në vitet 1999-2000 kryespecialist i pagave dhe normave në minierën e Bulqizës. Në vitet 2002-2003 bashkëpunëtor shkencor në institutin e teknologjisë minerale.

Kudo punoi e drejtoi , ai ishte i përkushtuar si specialist dhe i lidhur fort me punën dhe njerëzit. Gjatë kohës që drejtoi shkollën e mesme në Bulqizë, e radhiti atë si një ndër shkollat më të mira profesionale në vend.

Osmani kërkonte në radhë të parë ndaj vetes pastaj u kërkonte dhe të tjerëve. Shkëlqeu edhe në mësimdhënie, pasi mënyra e komunikimit me nxënësit ishte ndryshe. Osmani kishte aftësi që lëndën e tij ta bënte më të lehtë dhe më të kuptuar nga nxënësit. Nuk kishte nxënës që nuk e përvetësonte shpejt lëndën që jepte Osmani në shkollën e Bulqizës.

Jo vetëm drejtues dhe administrator i mirë, por Osmani ishte i pasionuar pas shkencës. Sot kemi mjaft botime të tij tekste mësimore për shkollat profesionale si: "Makina minerare" 1978, "Transport minerare" 1979, "Makina transport miniere "1", "Makina transport miniere "2". Është edhe recensent në katër tekste mësimore për shkollat e mesme profesionale si: "Art miniere 1/A", "Art miniere2/B","Art miniere 3", "Teknikë sigurimi në minierë".

Osman Miha është intelektual me përvojë të gjatë në punën e minierave. ai ishte anëtar i grupit qendror të studimit pranë Ministrisë së Arsimit për planet, programet dhe tekstet mësimore të shkollave të mesme profesionale për periudhën 1976-1992. Në rrugën e tij të gjatë e të bukur si kërkues e studiues, inxhinier Osmani ka kryer edhe tre studime për pagat e punonjësve të minierave për vitet 1998-2000. Aftësitë tij kanë qenë vërtet të rralla e të veçanta në drejtim e menaxhim për punë kërkimore-shkencore, individuale dhe në grup, aftësitë komunikuese dhe organizative për të punuar në ekip me njësi administrative dhe njësi prodhuese. Sot, jo vetëm në Qafëmurrë, por kudo që e njohin nga afër, për inxhinier Osman Mihën flasin me respekt dhe mirënjohje. Viktor Hygo thotë: "Nëqoftëse do ta njohësh të vërtetën, vështroje atë përmes popullit". Kolegët, ish nxënësit, minatorët e të gjithë ato që e kanë njohur nga afër e kanë punuar bashkë me të në fronte të vështira siç ishte dhe mbetet miniera, krenohen sot me inxhinier Osmanin. E vërteta e tij është puna, kërkimet e shumta shkencore, forca intelektuale, vlerat e larta morale si njeri, reformator e kontribues i provave në frontin e nëntokës, për popullin,për punëtorët dhe për qytetin minator të Bulqizës.

Sot është në pension, por prapë punon menaxher e konsulent pranë një kompanie ndërtimi. Osman Miha ende vazhdon të merret me shkencë, pasioni i tij mbetet libri, por dhe teknologjia më e re e informacionit elektronik siç është internet. Ai merr informacione të bollshme, vjel si bleta nektarin dhe nesër ndoshta përsëri do të shikojmë botime të tjera, që domosdo do t'u nevojiten nxënësve, studentëve, pse jo dhe pedagogëve, por dhe atyre individëve që vazhdojnë të merren me shfrytëzimin e minierave tona.

Të paharruemit Aqif Bodi - Nga Ilir Spata

Fjalë që Ti s'i dëgjon më

Na ngrive lotët edhe fjalët!
(Kush tha se fjala nuk ngrin?)
Prapë paske ardhë tek vend' i punës?!
Mbështjellë kurmin me qefin!

Si mundesh vallë të rrish i shtrirë
Kur miq e shokë e shtrijnë një dorë?!
T' i shohësh, pse s' i hapën sytë?
Pse të ka ngrirë fytyra, borë?

Një nur i ftohtë tejpërtej
Të paska rà përmbi fytyrë!
Qerpikët mbyllur që t' i ngresh
Nuk mundesh dot se të kanë ngrirë!

Kalon karvani pa u sosun
Të ndahen sot për t' fundmen herë.
Mbërthyer t' ka kjo e flamosun
Ftohtësi e akullt trupin ther.

Të vijnë e ikin pa takuar!?
Të kalojnë dorën pa u a dhanë!?
Po fryma jote qenka shuar;
Mbërthyer ngërçi krahë e kambë?!

Eh! T' ishe Ti Ai i gjalli
Si mund të rrije pa një fjalë!?
Me kokën lart e drejt në sy
Prit e përcill aty në ballë!

Po rradhën sot e kanë të tjerë;
Ty s' të punon as kambë, as dorë.
Vijnë, e shikojnë të fundmen herë
Një dritë hane fytyrës, borë!

*
* *

U ndamë ndanë rruge, natë e drita,
Një nur fytyrës të kish rà.
" Tani do shkosh? Rruga e mbarë!"
Unë kokën ula, mos me qà.

E ndjeva, fundi ndoshta ish?
(Megjithëse fundin s' e din asnjë.)
Një brengë e fshehur mpirë të kish;
E fjala ngrirë, bashkë me të.

Pusho në paqe, o shok i mirë!
T' u bëftë dritë një gjithësi!
Me ne të rrije patëm dëshirë,
Po vdekje - zeza s' kursen njeri!

Do t' na mungosh në kryevendi,
Ashtu i hijshëm, fodull pak!
E malli grijë për fjalën tande
Të zgjedhur bukur, për merak!

Kur të na bjerë që të dëgjojmë
Një Bet'hoven apo Moxart;
Me një pikë lot ofshajmë malluar:
" Aqifi shumë i pat merak! "

Na preve fjalët, meke zanë!
(Kjo dhimbje e zezë, vetëm lotë?)
Ajo që prapa Ti ke lanë
Nga bredhim ne, shetit në Botë!

Me ne do jeshë në çdo bisedë
Me atë buzëqeshjen, kokën lart;
Do mbetet gota e pangritur,
E prapë do zihemi në banak.

Do të kujtojmë ku qemë bashkë,
Sa u përpoqëm për Partinë.
Një foto marrë në nëntëdhjetë e shtatën
Rrugës për Vlashaj mbi një brinjë.

*
* *

Do mbeten fjalë, vetëm fjalë
E një imazh drite si Ti.
Ne gënjejmë vehten se je gjallë
Me lotët ngrirë nëpër sy.

Ky lot i ngrimë, kjo komkë me fjalë;
Ja ç' na ka mbetun sot nga Ti!
Një " lamtumirë! " lotësh të valë
Po të përcjell në Përjetësi.

Për mua mbetun tek një rrugë,
N' një udhëkryq mbushun me drita.
Një përqafim si " Rrugë të mbarë! "
Ma i mbrami çast që vetë s' e dita?

Mallin do shuajmë me një gur,
Fotografinë e ngrirë mbi të.
Ti, buzëqeshur, s' do flasësh kurrë;
Dhe Ne, përlotun e të pa zë.

Mbi gurin shirat me rrëke
Do derdhen, shpërlajnë lotët tanë;
Po jo atë që prapa na lè,
Buzëqeshjen tande do ta lanë.

Ne, fjalë ngrimë nëpër buzë,
Mbështjellur komkë, shpërthyer lotë.
Ti, shtigje dritash Përjetësisë
Mes një mal dhimbjeje ke marrë sot.

Se fjala ngrin, si çast i mbramë,
Si vezullimet ku u ndamë bashkë?!
Ajo fjalë e mbrame, " Rrugë e mbarë! "
Që " Lamtumirë! " m' u duk se asht?

Dhe loti thyhet si kristali
Po mbeti varur ndën qerpikë?!
Me mallin, dhimbjen, sa vetë mali
Na zgjon mendimi se na ke ikë!

Pa rridh, kullo ti lot i valë!
Na zgjo nga ankthet, angushtia!
Do përvëlohemi për një fjalë;
Mbi gur, e ngrirë, fotografia.

Kto fjalë që Ti s' i dëgjon kurrë
Do të shëtisin anë e kand.
Do ta mbështjellin të varrit gur
Ta ngrohin pak imazhin tand.

Më kot ne presim ta ndigjojmë zanë?
Ai shqimët endet nëpër fllad.
Në ankthet që të qetë s' na lanë
Ti humb mes dritash, diku larg.


Na përvëlon, zgjuar, një mall;
Ndën dhé kërkon t' na fusë të gjallë.


M&B BOTIME JU FTON TË NA VIZITONI NË

Panairin e Librit "Tirana 2013"

Botime të reja nga akademik Kristo Frashëri







Botime të tjera të suksesshme nga autorë dibranë



Në ditët e panairit **Botimet M&B** do t'i gjeni me zbritje të çmimeve nga **20-50%.**
Na gjeni në **katin e parë të Pallatit të Kongreseve** nga data **13 deri 17 nëntor 2013**
00355 4 22 33 283 / 069 20 68 603 / mbbotime@gmail.com / www.mbbotime.com
Na ndiqni në Facebook: MB Botime & Studio Grafike

cyan magenta yellow black